

1 E mërkurë, 16 mars 2022

2 [Deklaratat përmbyllëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
7 të gjithë.

8 Sekretaria, të tregojë seancën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
10 është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër
11 Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kush është
13 sot zonja Bolici?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] E njëjta gjë nga ZPS-ja. Nuk kemi
15 stazhier që të jetë me ne sot.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Rees.

17 Z. REES: [Përkthim] Nuk ka ndryshim, i nderuar Gjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm një ndryshim. Z. Bernabeau
20 nuk është me ne.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që z.
22 Gucati dhe z. Haradinaj janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

23 Sot do të vazhdojmë me fjalët mbyllëse.

24 Para se t'ia jap fjalën z. Rees, dua të pyes nëse z.

25 Cadman mund të vlerësojë sesa kohë do të zgjasë deklarata e

1 tij përfundimtare. Nuk po mundohem t'ju kufizoj juve. Thjesht
2 dua të kem një vlerësim.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Besoj se do ta përfundojmë brenda
4 një sesioni, një seance. Në qoftë se shkojmë deri tek pushimi
5 i parë me z. Rees, jam i sigurt që do ta përfundoj në seancën
6 e dytë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Faleminderit që jeni kaq i efektshëm.

9 Znj. Bolici, në qoftë se Mbrojtja përfundon aq herët, a
10 dëshironi ta filloni përgjigjen tuaj menjëherë apo preferoni
11 të filloni nesër në mëngjes?

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne e kishim
13 planifikuar që të flisnim në bazë të afatit që ka treguar
14 Trupi Gjykses. Por në qoftë se Trupi Gjykses kërkon që ta
15 bëjmë sot, ne do të jemi të gatshëm ta bëjmë një gjë të tillë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Do të thoja thjesht përgatituni për një gjë të tillë.

18 Edhe një pyetje palës Mbrojtëse. A e kundërshtoni që
19 Paneli t'ju bëjë pyetje të dyve në të njëjtën kohë? Pra, që të
20 përfundoni ju dhe t'ju bëjmë pyetje të dyve dhe jo një nga
21 një?

22 Z. REES: [Përkthim] Dakord.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,
24 jeni dakord?

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam asnjë kundërshtim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees mund
2 të vazhdoni.

3 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të flas tani
4 lidhur me pikat e Aktakuzës. Dhe e di që në dosjen tonë
5 përfundimtare ne e kemi bërë këtë në hollësi, kemi folur mbi
6 elementet e tyre, nuk dua të përsëris atë që kemi në dosjen
7 tonë përfundimtare. Ka disa pjesë të dosjes të cilat unë do
8 t'i përmend, ndoshta për t'i ripërsëritur a për të shtuar
9 ndonjë gjë. Por në qoftë se nuk e kam përmendur ndonjëherë prej
10 tyre, do t'i kërkoja Trupit Gjykses që ta shqyrtojë në tërësi
11 këtë dosje përfundimtare.

12 Pika e tretë, që është në bazë të nenit 387. Titulli
13 është frikësim, titulli i kësaj Aktakuze, ndonëse vërejmë që
14 nuk është e paraqitur kjo si pjesë e nenit 387. Nuk është kjo
15 vepër penale atje pra dhe as në një kuptim më të përgjithshëm,
16 për shkak se në bazë të nenit 387 kjo vepër penale ndodh si
17 premtim, për shembull, i një dhurate.

18 Që frikësimi apo efektet e frikësimit, nuk janë -- nuk
19 mjaftojnë për t'u përmendur si pasojë apo edhe si synim sepse
20 kjo vepër penale sipas nenit 387, ka të bëjë me përdorim e
21 forcës apo ndonjë forme tjetër të detyrimit duke patur si
22 element që do të ketë një farë përfitimi apo dhurate.

23 Pra, janë dy elemente. E para është që një person të mos
24 lejohet që të bëjë një deklaratë apo të bëjë një deklaratë të
25 rreme apo të mos tregojë informacionin e saktë. Ky është

1 synimi. Dhe elementi i dytë kyç është që ka të bëjë me faktin
2 që të bëhet një deklaratë e rreme, të mos bëhet deklaratë apo
3 të mos jepet informacion i saktë, e cila dërgon në procedurën
4 penale, në ndikimin e procedimit penal, pra, në pengesën, që
5 është një veprë penale e veçantë sipas nenit 386 të Kodit
6 Penal të Kosovës të 2019.

7 Pra, veprë penale sipas 386 dhe 387 mund të bëhet përmes
8 përdorimit të forcës apo një formë të detyrimit apo përmes
9 premtimit të një dhurate apo të një ryshfeti. Si 387 edhe 386
10 mbulon frikësimin e dëshmitarit dhe të gjitha bëjnë fjalë për
11 frikën ndaj një dëshmitari që mund të shkaktojë dhe lëndime
12 trupore.

13 Pra, 386 dhe 36 [sipas përkthimit] kërkojnë provën e
14 pasojave që të bëhet një ndryshim midis dy këtyre veprave
15 penale që ndryshe nga 386, për shembull, veprë penale sipas
16 387 ku një personi i kërkohet që të mos japë një deklaratë, të
17 bëjë një deklaratë të rreme apo të mos përmendë informacionin
18 e duhur. Ka lidhjen e saj apo duhet parë në lidhje me nenin
19 386 që është ajo pjesa që i pararend veprës penale.

20 Dhe kjo nuk e ndryshon faktin e frikësimit i cili
21 mbulohet nga neni 386 gjatë të gjithë procedurës. Por 387, në
22 maksimumin e saj, ka të bëjë me rastet më serioze të cilat
23 rezultojnë në pengimin e procedurave penale.

24 Dhe Prokuroria ka mundur ta bëjë ngarkimin me veprën
25 penale në bazë të nenit 386 dhe nuk është kjo pjesë e procesit

1 të gjyqit apo e Trupit Gjykses për të korigjuar gabimet të
2 cilat kanë ndodhur gjatë procesit të ngarkimit të veprës
3 penale nga ana e Prokurorisë. Dhe, siç e tha z. Halling,
4 Prokuroria mund të përmendë dy vendimet e shkallës së parë në
5 të cilat fajësia është bërë në bazë të nenit 387 përpara një
6 veprë penale pararendëse sipas 386. Dhe kjo nuk është e
7 vërtetë. Pasi në të dy këto raste -- janë të dy raste të
8 vendimeve të shkallës së parë. Nuk ka patur argumentim. Nuk
9 janë të detyrueshëm për t'u zbatuar dhe as bindëse.

10 Më lejon të bëj dhe dy komente të tjera mbi synimin. 386
11 [sipas përkthimit] flet për një synim specifik, themi ne.
12 Ndërkohë që neni 21(3) i Kodit Penal të Kosovës të 2019 nuk e
13 bën një gjë të tillë. Dhe kur bëhet fjalë për këtë synim
14 kërkohet përdorimi i qëllimshëm i forcës apo i kanosjes
15 serioze, me synimin që të mos lejohet një person që të bëjë
16 një deklaratë apo të bëjë një deklaratë të rreme apo të mos
17 tregojë të vërtetën para një trupi policor, para policisë.

18 Dhe dëshmitë më të mira të një synimi janë përmes veprave
19 të një personi. Në këtë çështje nuk është paraqitur asnjë
20 provë që të tregojë që ndonjë person të jetë kanosur në mënyrë
21 të drejtpërdrejtë edhe kam folur gjatë ditës së djeshme mbi
22 këtë çështje dhe nuk dua ta përmend sërish. Komenti i vetëm i
23 pretenduar që ka bërë z. Gucati dhe ai nuk e ka pranuar, që të
24 ketë patur si synim që të shfrytëzonte forcën apo kanosjen me
25 qëllim që të mos lejonte përdorimin e -- që mos lejonte

1 dhënien e një deklaratë, deklaratën e rreme apo deklaratën,
2 informacionin e plotë ndaj policisë. Nuk ekziston. I vetmi
3 koment që ka bërë Gucati, sipas dosjes së Prokurorisë, siç e
4 thonë ata, është komenti frikësues që thuhet që ai ka bërë në
5 lidhje me një dëshmitar, që është nën poshtëshënimin 586 të
6 paragrafit 197 të dosjes së tyre. Ky koment, në fakt, nuk e -
7 është shumë larg të provuarit tej çdo dyshimi të dyshuar që e
8 ka patur synim nga ana e Gucatit.

9 Znj. Sekretare, ky koment ndodhet në provën materiale P9-
10 ET, faqja 8 deri në 14.

11 Rreshti 22 deri në 29, tregon gazetarin në mes të
12 diskutimit me z. Gucati ku thotë fjalët që:

13 "Për shkak se ka emra... emra të cilët mund të dalin, e
14 shumë gjëra mund të ndodhin?"

15 Z. Gucati tha:

16 "Mund të ndodhin..."

17 Ndonëse, siç mund t'ju kujtohet nga vetë filmimi,
18 pavarësisht se këtu me shkrim duket se janë pyetje-përgjigje,
19 pyetje-përgjigje, në atë kohë, në fakt, gjatë diskutimit të
20 gjithë kanë folur në të njëjtën kohë.

21 Dhe gazetari i thotë:

22 "Kush do të marrë përgjegjësinë?"

23 U thotë:

24 "Ne... emrat...ne nuk i kemi nxjerrë këto emra, ato të
25 cilët i kanë nxjerrë nga ku? ... ne nuk e dimë - po ky

1 material na ardhur në Organizatën e Veteranëve. Ne nuk kemi
2 bërë asgjë. Ne nuk punojmë për Gjykatën Speciale”.

3 Pra, edhe siç e tha Prokuroria, pranimi se mund të
4 ndodhin gjëra nuk është -- as nuk i afrohet provimit të faktit
5 që z. Gucati ka patur një synim specifik. Dhe është një
6 shkëmbim që është zhvilluar në kontekstin, që ju kam treguar,
7 në të cilin z. Gucati në mënyrë të përsëritur ka thënë që
8 emrat e dëshmitarëve apo të personave privatë nuk duhet të
9 bëhen publik. Dhe mund t’ju kujtohet shpjegimi që ai ka dhënë
10 gjatë dëshmisë së tij, kur gazetari dhe ai po flisnin në të
11 njëjtën kohë dhe nuk është krejtësisht e qartë se çfarë ka
12 ndodhur. Dhe atij nuk i kujtohej. Dhe, sigurisht, që nuk ka
13 patur synime me qëllim të keq. Ajo që donte të ngrinte është
14 shqetësimi që dokumente kishin ardhur në zyrën e tij, kush i
15 kishte nxjerrë. Nuk donte që të dëmtohej asnjë person, diçka
16 të cilën e ka thënë në vazhdimësi.

17 Synimi i deklaruar i z. Gucati ka qenë që të ekspozojë
18 bashkëpunimin që ka ekzistuar mes Zyrës së Prokurorit të
19 Specializuar dhe Serbisë. Dhe këtë e kemi diskutuar gjatë
20 ditës së djeshme. Dhe gjatë gjithë kohës së Aktakuzës, ai ka
21 hedhur poshtë në mënyrë specifike të gjitha akuzat që synimi i
22 tij ka qenë për të frikësuar dëshmitarët dhe e ka përshkruar
23 atë si një klishe dhe një pretendim të pabazë. Të nderuar
24 Gjykatës, referenca për këtë ndodhet në provën material P59-
25 ET.

1 Z. Haradinaj, në praninë e z. Gucati në P35-ET, në
2 konferencën e tretë të shtypit, ka thënë që:

3 "Dua ta përsëris që synimi ynë nuk është për t'u mbuluar
4 krimet, në qoftë se kanë ekzistuar këto krime, apo për të
5 mbrojtur ndokënd që është kriminel".

6 Në dëshminë e tij, z. Gucati, në transkriptin në faqen
7 2372 tha:

8 "Jo, unë asnjëherë nuk kam menduar që po kërcënoja ndonjë
9 dëshmitar të vetëm. Nuk e kam bërë asnjëherë në jetën time.
10 Hysni Gucati asnjëherë nuk ka kërcënuar askënd".

11 Në kundërshtim me atë që sugjerohet në paragrafin 212 të
12 dosjes përfundimtare të Prokurorisë, z. Gucati nuk ka thënë
13 asnjëherë apo nuk ka sugjeruar asnjëherë që donte të dënonte
14 apo të ndëshkonte ato që kanë bashkëpunuar me TFHS-në. Nuk ka
15 pasur referenca për armiq të Kosovës, serbë famëkeq, zyrtarë
16 famëkeq serbë, të cilët kanë qenë në -- të cilët janë
17 përmendur nga shtypi si pjesëmarrës në masakra në Kosovë, këto
18 referenca shpjegohen për shkak se këta janë armiq të Kosovës,
19 jo sepse ata janë dëshmitarë por për shkak se ata kanë
20 bashkëpunuar me ZPS-në.

21 I nderuari Gjykatësi Gaynor kërkoi sqarim nga z. Gucati
22 në faqen 2437 të transkriptit.

23 Në rreshtin 15, i nderuar Gjykatës pyet:

24 "Nga ajo që thatë nuk del konkluzioni që dëshmitar që
25 bashkëpunojnë me ZPS-në që bashkëpunon me Serbinë është

1 dëshmitar i cili po bashkëpunon me armikun? Kështu e shihni
2 ju?"

3 "Jo. Ajo që po them, i nderuar Gjykatës, është që duke ju
4 referuar atyre që kanë qenë kundërshtarët tanë të cilët janë
5 të njohur. Unë përmenda emrin këtu".

6 Dhe do të shihni që janë bërë pyetje pak më herët lidhur
7 me një emër.

8 "Unë nuk e kam shfrytëzuar këtë për të gjithë
9 dëshmitarët, e kisha fjalën vetëm për këtë dëshmitar.
10 Dëshmitar, emrin e të cilit e përmenda..."

11 Dhe kjo është përmendur më herët, jo gjatë periudhës së
12 Aktakuzës.

13 "Ky person, emrin e të cilit e përmenda dhe unë po ju
14 referohem vetëm këtyre dëshmitarëve".

15 Dhe znj. Bolici kishte bërë pyetje lidhur me këtë pikë.

16 Në 2354, faqen e transkriptit, pra.

17 Në rreshtin 11, konteksti i këtij shkëmbimi është që znj.
18 Bolici kishte pyetur lidhur me provën materiale P40, e cila
19 ishte një intervistë e regjistruar e z. Gucati e vitit 2018,
20 përpara, pra, ajo periudhë para Aktakuzës kur kishte bërë
21 komente të ngjashme lidhur me armikun. Znj. Bolici pyeti dhe
22 ajo po citon nga transkripti në P40:

23 "I kanë sjellë disa dëshmitarë të cilët i quajmë
24 bashkëpunëtorë dhe disa dëshmitarë të cilët nuk kanë qenë në
25 Kosovë fare. Dhe prandaj besoj që kjo Gjykatë do të dështojë".

1 Ky është një citim i z. Gucati në vitin 2018.

2 "Pyetja ime është" tha ajo, në fund të faqes, "apo thoni
3 që në vitin 2018 që dëshmitarët e ZPS-së janë armiq dhe
4 bashkëpunëtorë?"

5 z. Gucati u përgjigj:

6 "Ne të gjithë e dimë që Serbia është armiku ynë dhe ju
7 keni bashkëpunuar me kriminelë serbë dhe me disa që janë të
8 shoqëruar me to. Kjo është e vërtetë. Unë e kam fjalën për
9 armiqtë e vendit tonë, armiq shekullor të cilët e kanë
10 pushtuar Kosovën për 100 vite dhe kanë bërë masakra në
11 Kosovë".

12 Znj. Bolici tha në rreshtin 6:

13 "Është e saktë, z. Gucati, që ju po i quani njerëzit të
14 cilët kanë dhënë dëshmi para kësaj Gjykate si armiq?"

15 Përgjigja e tij e z. Gucati ishte:

16 "Njerëzit janë real, nuk do i quaj armiq. Unë i quaj
17 armiq ata të cilët i kam protestuar kundër bombardimit të
18 Serbisë nga NATO-ja. Ato janë armiq. Ata të cilët kanë
19 protestuar në vitin 1999 kur NATO-ja po bënte sulme ajrore
20 kundër Serbisë, për mua, ata janë armiq janë kundër vendit tim
21 dhe kundër vendit tim".

22 Pra, një çështje të cilën z. Gucati e përmendi aty dhe e
23 ka bërë gjatë gjithë kohës së tij, që mund të jesh armik i
24 Kosovës dhe të jesh dëshmitar dhe kemi parë shembuj. Por kjo
25 nuk do të thotë që çdo dëshmitar është edhe armik.

1 Siç e thashë më herët, frikësimi apo efekti si pasojë,
2 apo si synim nuk mjafton.

3 Pranimi, siç ka bërë z. Gucati, në transkriptin në faqen
4 2265, rreshti 12 deri në 13. Ju lutemi, zvogëlojeni pak. Kam
5 bërë një gabim me referencën, por besoj që të nderuar Gjykatës
6 e mbani mend këtë, sepse është një pjesë të cilës i ka
7 kushtuar shumë rëndësi ZPS-ja.

8 Ajo çfarë thotë z. Gucati është që:

9 "Në qoftë se një emër është nxjerrë nga unë, nga kryesia
10 e OVL-së së UÇK-së, sigurisht, që atëherë mund të kishim
11 dëmtuar në një farë mënyre dëshmitarët".

12 Megjithatë, nuk po them që ne e kemi bërë këtë gjë.

13 Por nga ana tjetër, njohuria që "mund të kesh dëmtuar një
14 prej dëshmitarëve", nuk është e mjaftueshme. Nuk është e
15 mjaftueshme dhe nuk është në përputhje me atë çfarë kërkohet
16 sipas nenit 387 dhe nuk është as e drejtë që të injorohet atë
17 çfarë thotë z. Gucati në pjesën më poshtë:

18 "Pra, ne nuk kemi nxjerrë emra të tillë, nuk e kemi
19 nxjerrë këtë gjë. Kështu që nuk ka asnjë arsye që ata të jenë
20 dëmtuar".

21 Pra, duhet që të ekzistojë nxitja për të bërë deklaratë
22 të rreme ose për të dhënë informacione të pavërteta, pra, të
23 organeve policore, gjë e cila nuk është e pranishme këtu.

24 Pra, nuk ka provë të drejtpërdrejtë as të një kanosje
25 serioze apo as ndonjë synim specifik. Rregulli 143 i

1 Rregullores së DHSK-së flet për kanosjet serioze dhe synim
2 specifik. Dhe sipas këtij rregulli thuhet që standardi i
3 provës përtej dyshimit të arsyeshëm vërtetohet vetëm në qoftë
4 se prova çon në këtë përfundim. Në qoftë se prova në vetvete
5 çon në një tjetër përfundim, atëherë i takon që prova përtej
6 dyshimit të arsyeshëm nuk është e vërtetuar.

7 Ndërkohë Prokuroria ka një tjetër referencë sa i takon
8 synimit. Dhe sipas ZPS-së, pra, kjo kanosje duhet që të lidhet
9 me atë që ka dhënë informacionin. Ndërkohë që ky nuk është
10 qëndrimi ynë sepse ne e sugjerojmë dhe e mendojmë që ky është
11 një informacion alternativë i pabazuar. Ne mendojmë që një
12 përfundim i arsyeshëm, pra, duhet që të përcaktohet në varësi
13 të synimit dhe siç e ka thënë dëshmitari në mënyrë të
14 vazhdueshme, qëllimi kryesor ka qenë që të ekspozonte gamën
15 ose madhësinë e bashkëpunimit ndërmjet ZPS-së dhe Serbisë.

16 Siç kemi parashtruar dhe në dosjen përfundimtare të
17 gjykimit, lidhur me pikën 3 i akuzuari duhet që të shpallet i
18 pafajshëm.

19 Sa i takon pikës 4, hakmarrja, neni 3881 sërish e bën të
20 qartë që kjo është një veper penale, e cila ka të bëjë me një
21 synim konkret. Dhe synimi këtu është që të hakmerresh për
22 ofrimin e informacionit të vërtetë. Ne parashtrojmë që sërish
23 kjo është një veper, e cila kërkon pasojë, kërkon po ashtu
24 edhe provë të pasojave dhe të dëmtimeve të cilat janë
25 shkaktuar, përfshirë këtu edhe ndërhyrjen e punësimit të

1 rregullt me një person, duke e bërë të qartë kështu që dëmtimi
2 në vetvete nuk është vetëm i përqendruar tek dëmtimi fizik.
3 Por mund të jetë gjithashtu edhe dëmtim financiar ose ekonomik
4 pra. Mund të jetë ndërhyrje me punësimin e ligjshëm ose me
5 mënyrën e ligjshme të të jetuarit. Kështu që, për arsye të
6 cilat i shpjeguar dje, ne nuk kemi pasur dëshmi të pranuar
7 nga ky Trup Gjykues që tregojnë që i akuzuari ka shkaktuar
8 ndonjë dëmtim real. Por nga ana tjetër Prokuroria në
9 paragrafin e vet, në dosjen përfundimtare, në paragrafin 222
10 thotë që i akuzuari ka shkaktuar frikë ose ka çuar në humbjen
11 e besimit të dëshmitarëve.

12 Sa i takon synimit specifik, pra, synimi duhet që të jetë
13 i tillë që të shkaktojë dëmtim dhe që të çojë në hakmarrje
14 ndaj këtij personi për dhënien e informacionit të vërtetë. Në
15 qoftë se informacioni është i rremë ose në qoftë se kryesi
16 beson se informacioni është i rremë, atëherë nuk kemi të bëjmë
17 me një situatë ku është kryer një vepër penale. Kjo është ajo
18 çfarë parashikohet në nenin 388, pika 1, pra, ky është një nen
19 i cili nuk ka të bëjë me informacionin fals apo me
20 informacionin i cili nuk është i vërtetë.

21 Pra, nuk mjafton që i pandehuri mendoj që informacioni i
22 dhënë nga dëshmitari mund të ketë qenë i vërtetë, ashtu siç
23 pretendon Prokuroria në paragrafin 225 të dosjes përfundimtare
24 të gjykimit. Dhe z. Gucati nuk e ka vendosur synimin e vet më
25 larg sesa kaq. Pra, që informacioni mund të ketë qenë i

1 vërtetë. Dhe nuk mjafton që vepra në vetvete të ketë synim
2 konkret të drejtpërdrejtë.

3 Prokuroria kërkohet, që të paktën, të provojë përtej
4 besimit të arsyeshëm që kryesi ka dhënë informacion i cili
5 është i vërtetë. Pra, sa i takon synimit që paktën Prokuroria
6 duhet të vërtetojë këtë gjë. Duhet të jetë provimi nga
7 Prokuroria përtej dyshimit të arsyeshëm që informacioni që ka
8 dhënë dëshmitari që pretendohet që të jetë dëmtuar të ketë
9 qenë i vërtetë. Gjë e cila nuk ka ndodhur në kuadrin e këtij
10 gjykimi.

11 Prokuroria e vendos synimin e z. Gucati në një nivel më
12 të lartë sesa kaq, sepse, sigurisht, pjesa dërrmuese e
13 dëshmisë është që z. Gucati, sigurisht, është skeptik sa i
14 takon pretendimeve të sjelljes kriminale gjatë luftës nga ana
15 e atyre të cilët kanë mbrojtur Kosovën nga sulmi.

16 Sigurisht që z. Gucati ka thënë që nuk ka asnjë lloj
17 problemi që të thuhet e vërteta, kështu që në paragrafin 21 të
18 provës materiale 1D3-ET, z. Gucati ka thënë që:

19 "Unë nuk kam asnjë problem me persona që i thonë të
20 vërtetën ZPS-së. Në qoftë se një person është keqtrajtuar nga
21 një anëtar i UÇK-së dhe ka folur me ZPS-në, nuk kam problem me
22 këtë. Por, në qoftë se një person flet me ZPS-në dhe i ka
23 dhënë një dëshmi false, si pjesë e përpjekjeve të tyre për t'u
24 zhvendosur me banim nga ZPS-ja, unë besoj që kjo mund të ketë
25 ndodhur dhe si rezultat, ky person është gënjeshtar".

1 Dhe, në përputhje me parashikimin e nenit 388(1), kjo nuk
2 do të thotë që besoj që personi X mund të ketë dhënë
3 informacion të vërtetë, pra, që mund të ketë dhënë informacion
4 të pavërtetë.

5 Z. Gucati, siç e pamë edhe dje, ka bërë thirrje që të
6 gjitha krimet të gjykohen, të hetohen. Sugjerimi nga ZPS-ja që
7 prezumimet nga pjesa e Mbrojtjes lidhur me interesin publik
8 presupozojnë që informacioni në vetvete duhet të jetë i
9 vërtetë. Pra, ky është një prezumim të cilin e jep Prokuroria
10 në paragrafin 225 të dosjes përfundimtare të gjykimit.

11 Pra, kuptimi i Prokurorisë lidhur me atë që Mbrojtja
12 thotë është e vërtetë, është që Mbrojtja thotë që ajo çfarë
13 është e vërtetë është masa ose gama e natyrës së bashkëpunimit
14 ndërmjet ZPS-së dhe Serbisë.

15 Ne nuk themi që është e vërtetë, le të themi, pjesa e
16 përmbajtjes së ndonjë llogarie dhe të ndonjë deklaratë
17 dëshmitari. Për shembull, sa i takon veprës së parashikuar nën
18 pikën 4 të Aktakuzës, hakmarrjes, ne themi, parashtrimi ynë
19 është që nuk ka prova të drejtpërdrejta që është shkaktuar
20 dëmtim dhe nuk ka pranim të synimit konkret të z. Gucati. Dhe
21 sërish, në përputhje me rregullin 143 të Rregullores së DHSK-
22 së kjo zbatohet si sa i takon dëmtimit por gjithashtu edhe
23 synimit konkret specifik që duhet të ketë shkaktuar i
24 pandehuri. Dhe, në qoftë se provat lejojnë një tjetër
25 përfundim që të arrihet, atëherë nuk kemi të bëjmë me vërtetim

1 nga Prokuroria ose me përmbushje të parakushteve të cilat kanë
2 të bëjnë me dyshimin e arsyeshëm.

3 Pra, Prokuroria nuk ka vërtetuar që veprimet e të
4 akuzuarit janë drejtuar për të bindur ca persona që të mos
5 bëjnë fare deklarata për DHSK-në dhe për të dhënë informacione
6 apo hetime në të ardhmen.

7 Pra, ne mendojmë, që përfundimi që mund të nxirret është
8 ndryshe nga ky që sapo u tha dhe siç e thamë, në mënyrë të
9 përsëritur, synimi konkret i personit, pra, i të akuzuarit,
10 ishte thjeshtë për të ekspozuar nivelin e bashkëpunimit
11 ndërmjet ZPS-së edhe Serbisë dhe ZPS-ja, siç e thotë i
12 akuzuari, është e njëanshme.

13 Kur i marrim të dyja së bashku pikën 3 dhe 4 dhe kur
14 marrim parasysh synimet konkrete të tyre, duam t'i kërkojmë
15 Trupit Gjykues të mbajnë parasysh se ajo çfarë ka bërë z.
16 Gucati dhe çfarë ka thënë z. Gucati, siç është pranuar dhe nga
17 ZPS-ja, e ka bërë për publikun. E ka bërë gjithashtu edhe në
18 sy jo vetëm të publikut, po gjithashtu edhe të ZPS-së. Siç
19 thuhet edhe nga komentet që ai ka bërë nga 2018, atë qëndrim
20 ai e ka shprehur edhe goxha kohë më përpara dhe nuk mund të
21 qëndrojnë akuzat për aq kohë sa ai nuk ka kryer veprat e
22 frikësimit dhe të hakmarrjes atëherë. Fakti që ai ka bërë atë
23 çfarë ka bërë, që ka thënë ato çfarë ka thënë, në mënyrë të
24 hapur, në sy të publikut, në sytë e ZPS-së, cenon dhe rrëzon
25 sugjerimet që ai ka pasur synime të tilla të liga.

1 Më lejoni tani që t'i kthehem pikës 1 të Aktakuzës. I kam
2 marrë sipas këtij rendi, sepse kam përshtypjen që ky është
3 rendi që i ka trajtuar pikat e Aktakuzës ZPS-ja. Është vepra
4 penale pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave
5 zyrtare. Ne parashtrojmë që qëllimi kryesor i nenit 401 është
6 pengimi i personit zyrtar në kryerjen e veprave zyrtare dhe ne
7 mbështetemi në këtë qasje tonën edhe nga vendimi i Gjykatës së
8 Apelit në çështjen M.I e të tjerë përpara Gjykatës së Apelit
9 të Kosovës me referencë PAKR 513/2013 në seksionin 6.3.

10 Kërcënimi ose kanosja e rëndë, në kuadrin e 401, sipas
11 parashtrimit tonë do të thotë kanosje serioze dhe përdorimit
12 të forcës për qëllime të këtij neni, të nenit 401 pra. Kjo
13 është në përputhje me formulimin dhe me qëllimin e nenit 401,
14 paragrafi 1, siç përshkruhet edhe nga Gjykata e Apelit të
15 Kosovës në çështjen M.I dhe të tjerë, domethënë, që vepra
16 kërkon përdorim e forcës ose kanosjen serioze kundër personave
17 zyrtarë. Ndërkohë, elementi rëndues sipas nenit 401(5) kërkon
18 që kanosja serioze ose forca të mund të ushtrohet ndaj një
19 personi zyrtar, ndërkohë që ata ushtrojnë detyrat e tyre
20 zyrtare. Dhe është e qartë që në këtë çështje, duhet që ZPS-ja
21 të provojë që është përdorur forca apo kanosja serioze dhe
22 forca apo kanosja serioze kanë çuar në pengimin e personave
23 zyrtarë për kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

24 Në dosjen përfundimtare të çështjes, neve japim dhe
25 mbështetjen tonë dhe nga pikëpamja akademike lidhur me këtë

1 element, lidhur me pikën 1 të Aktakuzës dhe që kjo është në
2 përputhje me Kodin Penal të Kosovës.

3 Kërcënimi ose kanosja në vetvete ose përdorimi i forcës,
4 siç kërkohet nga neni, që të jetë në të njëjtën ose të ndodhë
5 në të njëjtën kohë me pengimin e kryerjes së detyrave zyrtare
6 duhet të bëhet përmes përdorimit të menjëhershëm të forcës.
7 Sërish duam t'i tërheqim vëmendjen Trupit Gjykues në
8 paragrafin ose në seksionin 6.3, në qoftë se nuk gabohet, në
9 mbështetje të këtij argumenti edhe duam që sërish t'ju
10 tërheqim vëmendjen të shikoni vendimin e Gjykatës së Apelit të
11 Kosovës në çështjen M.I dhe të tjerë.

12 Në çështjen në fjalë, nuk ka të dhëna që ka nxitje për
13 përdorim force apo kanosje serioze ndaj personave zyrtarë në
14 kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, pra, nuk kemi as përdorim
15 force apo asnjë lloj përdorimi kanosjeje tjetër për këtë
16 arsye. Nuk ka asnjë provë që thotë [se] është nxitur ose ka
17 pasur përpjekje, ka pasur orvatje nga i akuzuari që të përdorë
18 kërcënimin apo kanosjen apo forcën për sa i takon
19 dëshmitarëve.

20 Lidhur me synimin, elementi kryesor këtu është ose
21 dëshira për të penguar një person zyrtar përmes përdorimit të
22 forcës dhe kanosjes serioze ose vetëdijesisë që një zyrtar do
23 të pengohet nga përdorimi i forcës ose kërcënimi serioz. Nuk
24 ka asnjë synim për pengimin e punës së ZPS-së, siç
25 parashtrohet nga ZPS-ja, në paragrafin 193 të dosjes së tyre

1 përfundimtare, kjo nuk mjafton. Kjo, në vetvete, nuk formon
2 fare asnjë pjesë të përbërjes së veprës penale siç
3 parashikohet në nenin 401, paragrafi 1. Pra, synimi për
4 pengimin e kryerjes së detyrave zyrtare nuk mjafton.

5 Nuk kemi po ashtu asnjë provë të pranueshme sa i takon
6 pengimit të punës së ZPS-së. Çfarë detyrash zyrtare nuk ka
7 qenë në gjendje që të përmbushë ZPS-ja si rezultat i veprimeve
8 të z. Gucati? Për shembull, nuk kemi asnjë provë sa i takon
9 pengimit të kontrollit, sekuestrimit. Nuk kemi gjithashtu
10 asnjë lloj pengimi, ndonjë provë që e dëshmon pengimin e
11 arrestimit.

12 Nuk kemi dëgjuar asnjë dëshmi të pranueshme nga kjo
13 Gjykatë e cila ka të bëjë me pengimin e punës së Prokurorisë
14 nga veprimet e të akuzuarit. Siç e parashtrova dhe dje, nuk
15 kemi të dhëna për ndonjë hetim konkret apo ndjekje penale të
16 ZPS-së që është tjetërsuar se ka pasur, ka vuajtur pasoja si
17 rezultat i veprimeve të të akuzuarit. Kemi vetëm thjesht
18 deklaratën e z. Jukiç që pretendon për pengim të detyrave. Dhe
19 lidhur me pikën 1 të Aktakuzës, parashtrimi ynë është që i
20 akuzuari duhet të shpallet i pafajshëm.

21 Pika 2 ka të bëjë me pengimin e personave zyrtarë në
22 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të veprimit të përbashkët
23 të një grupi. Pra, kemi të bëjmë me parashikimin e nenit
24 401(2) dhe ky veprim i përbashkët, ne parashtrojmë, se lidhet
25 me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze që parashikohet në

1 nenin 401(1).

2 Pra, siç bie dakord edhe ZPS-ja, aktivitetet paqësore dhe
3 të ligjshme janë përtej fushës së veprimit të kësaj dispozite.
4 Duhet të vendosen ca kufij sa i takon përcaktimit dhe
5 përkufizimit të aktiviteteve të ligjshme dhe të paqshme. Dhe
6 sipas nesh, këto kufij janë të përcaktuar me saktësi nën nenin
7 401. Dhe ato përjashtojnë përdorimin e forcës dhe të kanosjes
8 serioze.

9 Neve parashtrojmë që nuk ka të dhëna, nuk ka prova sa i
10 takon kryerjes së krimit që parashikohet në nenin 401,
11 paragrafi 1.

12 Dhe rezulton që çfarëdo lloj roli ka luajtur z. Gucati me
13 kolegë të tjerë në OVL-në e UÇK-së, se nuk mund të arrihet në
14 përfundimin që ata kanë kryer veprën e parashikuar në nenin
15 401(1) dhe 401(2) dhe nuk e kanë kryer veprën në paragrafin 2
16 vetëm thjesht përmes veprimit të ndërsjellët, pra, veprimit të
17 përbashkët të një grupi.

18 Kështu që, siç kemi deklaruar dhe në dosjen
19 përfundimtare, i akuzuari duhet të shpallet i pafajshëm edhe
20 lidhur me pikën 2.

21 Tani mbeten pikat 5 dhe 6. Këto janë vepra penale të
22 shkeljes së fshehtësisë së procedurës sipas neneve 392(1) dhe
23 (2). Të dyja kërkojnë që nxjerrjet apo zbulimet të
24 informacionit të jenë të paautorizuara.

25 Në qoftë se do të kishte bazë ligjore për nxjerrjen e

1 informacionit, çdo informacion që nxirret nuk do të përbënte
2 vepër penale. Dhe mund të japim një shembull në rast
3 domosdoshmërie, për shembull, jepet ky shembull në komentarin
4 e Kodit Penal nga z. Saliu dhe të tjerët.

5 Nxjerrja e informacionit konfidencial kur është në
6 interes publik, kur ky interes është më i madh sesa interesi i
7 individit, duhet të jetë bazë ligjore sipas nenit 22 dhe 40 të
8 Kushtetutës së Kosovës. Dhe ju, të nderuar Gjykatës, i dini
9 këto, i keni këto nene para vetes dhe nuk do t'i përsëris.

10 Ne e përmendim, gjithashtu, nenin 204 të Kodit penal të
11 Kosovës të 2019 sepse përcakton se çfarë është interesi publik
12 dhe është një përkufizim i përgjithshëm dhe është një
13 përkufizim krejt i pakundërshtueshëm dhe ZPS-ja e pranon këtë;
14 pra, interesi publik qëndron në atë që duhet të mbrohet
15 mirëqenia dhe e mira e publikut të gjerë. Ndërsa, neni 200,
16 pika 4, specifikon disa tipe të informacionit konfidencial
17 nxjerrja e të cilëve do të ishte në interesin publik, këto i
18 përmendi z. Halling të hënën, por nuk janë të kufizuara, ky
19 nen nuk e kufizon fushëveprimin e tyre. Këto janë shembuj se
20 kur nxjerrja është në interesin publik, por ky nen nuk kufizon
21 nxjerrjet të cilat janë në interesin publik vetëm në ato raste
22 që janë përmendur aty.

23 Ligji nuk mund të ndihmojë nxjerrjen e informacionit që
24 është në interesin publik. Do të ishte absurde që të bëhej e
25 kundërta apo të thuhej se e kundërta është e vërtetë.

1 Ligji mund të ndalojë nxjerrjen e informacionit i cili --
2 nuk mund të ndalojë nxjerrjen e informacionit i cili është në
3 interesin publik.

4 Fjalët që nuk duhet të nxirren, sipas nenit 392(1), duhet
5 të interpretohen në këtë rast se ligji nuk interpretohet në
6 një mënyrë që pranon se ligji nuk mund të ndalojë zbulimin e
7 informacionit që është në interes të publikut të zbulohet ose
8 të nxirret.

9 Po kështu themi, që Prokuroria duhet të provojë se çdo
10 deklaratë nga një gjykatë apo autoritet kompetent që
11 informacioni është sekret, që është pika në të cilën bazohet
12 pika 5 e Aktakuzës.

13 Sipas kësaj analize, pozicioni i vërtetë dhe i drejtë që
14 duhet të merret është që interesi publik, ne nuk e ngremë si
15 Mbrojtje ndaj veprave penale, por ne themi që është pjesë
16 përbërëse e detyrimeve të Prokurorisë, që në pikat 5 dhe 6, të
17 vërtetojë që informacioni që është nxjerrë ishte i
18 paautorizuar dhe ishte i paligjshëm. Prokuroria duhet të
19 provojë, përtej dyshimit të arsyeshëm, se nxjerrja e këtyre
20 informacioneve nuk ishte në interesin publik.

21 Ju, të nderuar Gjykatës, në një fazë më të hershme gjatë
22 konferencës përgatitore për Mbrojtjen, në 3 dhjetor 2021, ju
23 pranuan se çështja e interesit publik do të ngrihej në lidhje
24 me bashkëpunimin me Serbinë, midis Serbisë dhe TFHS-së dhe
25 ZPS-së, nëse do të kishte veprime të parregullta që janë kryer

1 aty, kjo do të ndikonte në paanshmërinë dhe integritetin e
2 hetimeve të TFHS-së dhe të ZPS-së. Dhe kjo reflekton
3 shqetësimin e z. Gucati, e kemi parë dhe dje, që ZPS-ja, për
4 shkak të mungesës së kompetencave që ka jashtë Kosovës dhe që
5 nuk ka kompetenca në Serbi, që është shteti që ka kryer një
6 luftë agresive në Kosovë në 1998 deri 2000, që është periudha
7 kohore që është në juridiksionin e kësaj Gjykate, pra, i takon
8 -- kjo e vendos ZPS-në në një rrezik të ndërhyrjes dhe
9 manipulimit në duart e autoriteteve serbe.

10 Ajo që pranuat ju, të nderuar Gjykatës, që provat për
11 veprime të parregullta të cilat do të ndikonin në paanshmërinë
12 e veprimeve dhe hetime të ZPS-së dhe integritetin e tyre,
13 është një shqetësim legjitim i z. Gucati, por ne nuk kemi
14 mundur ta shtjellojmë atë në këtë gjykim. Dhe Prokuroria nuk
15 mund të thotë se e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm
16 se materialet në dosjet 1, 2 dhe 3 nuk përmbajnë asnjë provë
17 të parregullsisive të cilat do të ndikonin në hetimet e TFHS-së
18 dhe ZPS-së dhe në integritetin dhe paanshmërinë e tyre sepse
19 ata nuk dhënë asnjë provë, nuk kanë treguar asnjë provë, të
20 nderuar Gjykatës.

21 Ne nuk kemi mundur ta shtjellojmë këtë çështje sepse nuk
22 na është dhënë përmbajtja e plotë e atyre dosjeve dhe
23 Prokuroria nuk ka mundur të vërtetojë përtej dyshimit të
24 arsyeshëm që nuk ka prova të veprimeve të parregullta në këtë
25 drejtim. Ata do të mund ta bënim këtë vetëm në qoftë se do

1 t'ju tregonin juve, të nderuar Gjykatës, përmbajtjen e
2 ndërveprimeve që kanë bërë ata. Dhe jo vetëm kërkesat për
3 asistencë që i kanë drejtuar autoriteteve serbe, por që ju të
4 shikonit edhe përmbajtjen e këtyre ndërveprimeve dhe si kanë
5 reaguara ata ndaj kërkesave, çfarë përgjigje kanë dhënë dhe si
6 e kanë bërë këtë. Kjo do të ishte e vetmja mënyrë që
7 Prokuroria të provonte përtej dyshimit të arsyeshëm se në atë
8 dosje nuk ka pasur asgjë që të ndikonte në pavarësinë dhe
9 integritetin e hetimeve të tyre.

10 Ajo që kishte shqyrtuar znj. Pumper, ishte thjesht parja
11 nëse kishte emra aty dhe sesi mund -- por nuk kishte asgjë në
12 lidhje me mënyrën sesi mund të ndikonte kjo në pavarësinë
13 paanësinë dhe integritetin e hetimeve të Prokurorisë. Pra,
14 dëshmia e saj nuk ndihmon aspak në këtë drejtim.

15 Ne kemi përmendur ligjin për klasifikimin e informacionit
16 dhe verifikimit të sigurisë ligji 3L178 i 1 korrikut 2010. Dhe
17 çështja që ngremë ne është që ajo që thuhet aty në ligjin për
18 klasifikimin e informacionit dhe verifikimeve të sigurisë
19 është thjesht reflektim i asaj që kërkon kushtetuta; pra, që
20 të gjitha autoritetet publike, gjykatat, t'i kushtojnë
21 vëmendje të rëndësishme të drejtave, kufizimeve që vendosen,
22 natyrës dhe shkallës së kufizimeve, duke pasur parasysh që
23 këto kufizime të mos shkelin të drejtat themelore dhe
24 interesat e Kosovës si një shoqëri demokratike.

25 Kështu, për shembull, në qoftë se do të vendosej ndonjë

1 kufizim mbi të drejtën për qasje apo për të nxjerrë një
2 informacion, i cili të është bërë i ditur, në qoftë se do të
3 vendosej kufizim për të fshehur një sjellje të paligjshme apo
4 abuzim të autoritetit apo gabim administrativ apo për të
5 moslejuar që të turpërohet dikush një person, organizatë apo
6 për të parandaluar apo penguar apo vonuar nxjerrjen e
7 informacionit, kur, faktikisht, nuk ka konsiderata të tjera
8 sigurie të cilat janë në pyetje, atëherë ZPS-ja, patjetër,
9 duhet [të] pajtohet se ky kufizim është i paligjshëm, sipas
10 termave të ligjit L3178 [sipas përkthimit] qoftë në qoftë se
11 ai zbatohet apo jo. Këto duhet patjetër të pajtohen se çdo
12 kufizim mbi zbulimin e informacionit për të fshehur sjelljen e
13 tyre, gabimet e tyre, për të parandaluar që ata të turpërohen
14 apo për të vonuar nxjerrjen e informacionit, kjo do të ishte e
15 paligjshme.

16 Pra, përsëri, në mungesë të provave për sa i përket
17 përmbajtjes së paketave 1, 2 dhe 3 në plotësinë e tyre dhe pa
18 ndihmën e znj. Pumper që të na thoshte më shumë për
19 përmbajtjen e këtyre paketave, pra, për shembull, çfarë
20 veprimesh kanë marrë ZPS-ja dhe çfarë përgjigjesh kanë marrë
21 nga autoritetet serbe, duke mos e bërë këtë, Prokuroria nuk ka
22 provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se kufizimet që kanë
23 vendosur ata ishin të ligjshme.

24 Shqyrtimi që i bëri paketave znj. Pumper ishte një hedhje
25 sy tek ato dokumente. Unë nuk e them këtë për të treguar

1 ndonjë mungesë respekti ndaj saj, por ajo aq e kishte
2 udhëzimin për të bërë. Asaj nuk iu kërkua që të verifikonte
3 autenticitetin e dokumenteve. Dhe, në qoftë se ato nuk do të
4 ishin autentike, atëherë nuk ishte në pyetje konfidencialiteti
5 i tyre se pse dokumentet false nuk mund të jenë konfidenciale.
6 Por, ndërkohë që i pa dokumentet, ajo vërtetoi që ato ishin të
7 pranishme në bazën e të dhënave të Prokurorisë. Pra, sipas
8 dëshmisë së saj, vërtetësia ose autenticiteti i tyre u provua
9 por kur u pyet se kur e bëri, kur e përfundoi këtë detyrë dhe
10 ajo u përgjigj që:

11 "Nuk e kam përfunduar deri më sot këtë detyrë. Nuk i kam
12 kontrolluar të gjitha një për një nëse janë autentike apo jo".

13 Ajo nuk mori parasysh -- dhe kjo përgjigje e saj jepet në
14 faqen e transkriptit T1069. Më falni, T1059.

15 Këtu shohim shkëmbimin, duke filluar nga rreshti 8 e më
16 poshtë, që ajo në shqyrtimin e dokumenteve nuk e pa -- kur pa
17 fjalën "konfidenciale" në dokument nëse kishte autoritet të
18 posaçëm për klasifikimin e dokumentit si konfidencial. Pra,
19 ajo nuk e shqyrtoi këtë aspekt, pra, atë procesin e
20 klasifikimit që mund të çonte në shënimin e një dokumenti si
21 konfidencial dhe nëse kjo ishte e ligjshme apo jo. Dhe nuk
22 shqyrtoi nëse shënimi si konfidencial ishte i nevojshëm apo
23 jo.

24 Dhe këto ju, të nderuar Gjykatës, duhet t'i shqyrtoni
25 vetë, t'i shikoni vetë të gjitha këto aspekte, por këtë ja

1 pyetën znj. Pumper dhe ka shumë faqe të dosjeve të Prokurorisë
2 që ne nuk i kemi parë dhe nuk e dimë se cilat faqe nuk i ka
3 parë znj. Pumper sepse ajo nuk i shqyrtoi. Ajo nuk e shqyrtoi
4 në asnjë moment nëse klasifikimi si konfidencial ishte i
5 nevojshëm. Dhe nëse duhej të imponohej konfidencialitet kur
6 ishte i panevojshëm. Po kështu, nuk ka pasur asnjë -- ajo nuk
7 shqyrtoi nëse ka pasur ndonjë sugjerim apo ka ndonjë provë që
8 klasifikimi që ishte përdorur, ishte përdorur për të fshehur
9 gjëra dhe për të dhe ishte i paligjshëm. Po kështu, ai [sipas
10 përkthimit] nuk shqyrtoi se për sa kohë ishin konfidenciale
11 këto dokumente apo ishin ndërmarrë këto hapa për të
12 deklasifikuar apo riklasifikuar këto informacione që kishin
13 marrë nga të TFHS-së të Serbisë e tjerë.

14 Ajo vetë nuk ishte në gjendje të klasifikonte dokumentet
15 si konfidenciale.

16 Pra, të nderuar Gjykatës, në rreshtin 19, ju i nderuar
17 Gjykatës i thatë që ose më mirë më thatë mua që ndoshta mund
18 ta pyesni dëshmitaren nëse është brenda autoritetit të saj,
19 kompetencave të saj që të marri vendim nëse është apo s'është
20 konfidenciale. Dhe ajo në përgjigjen e saj tha që nuk ishte
21 kompetencë e saj. Në rreshtin 8:

22 "... a keni ju kompetencën për të klasifikuar dokumentet
23 si konfidenciale?"

24 Përgjigja:

25 "Jo".

1 Pra, bazuar në vetë fjalët e saj, ne nuk mund të
2 mbështetemi tek fjalët e znj. Pumper, domethënë, nuk mund të
3 mbështetemi tek ajo që thotë znj. Pumper sepse ajo nuk kishte
4 kompetencat për të bërë vlerësime të konfidencialitetit.

5 Po është interesante, se ajo tha edhe që nuk e dinte se
6 kush brenda ZPS-së kishte kompetencat për të vendosur për
7 konfidencialitetin e dokumenteve. Kjo është në T1070. Dhe tha
8 që nuk kishte dijeni për procesin; kjo është në rreshtat 11
9 deri në 20. Pra, rreshti 11 deri në 20 edhe pyetja është:

10 "A mund t'ju pyes për procesin e caktimit të
11 konfidencialitetit?"

12 Dhe ajo tha:

13 "Kush e ka kompetencën t'i bërë këto klasifikime?"

14 Dhe ajo u përgjigj.

15 "Nuk e di ..."

16 Po kështu nuk kishte dijeni për procesin, përpara sesa të
17 caktohej konfidencialiteti i një dokumenti. Kjo është në
18 T1071.

19 Në rreshtin 11. U pyet:

20 "Nëse kishte një proces specifik me anë të cilit bëhej
21 vlerësimi i domosdoshmërisë së përcaktimit të
22 konfidencialitetit?"

23 Dhe në rreshtin 19, ajo përgjigjet:

24 "Unë nuk jam e përfshirë në këtë proces. Nuk kam dijeni
25 për të".

1 Dhe ajo nuk kishte parë asnjë dokument ku të paraqiteshin
2 arsyet se pse bëhej një dokument konfidencial dhe e pranoi se
3 jo të gjitha informacionet që ishin në ato paketa ishin
4 konfidenciale, mund të ishin konfidenciale. Këtë e bëri në
5 faqen e transkriptit T1075, rreshti 10. Ndoshta është një
6 shembull që është përsëritur shumë herë, por e ilustron mirë
7 këtë pikë.

8 "... adresa e TFHS-së, ku ishte bazuar..."

9 Pra, informacioni që ishte në atë dokument, ajo tha, që
10 ishte konfidencial, por faktikisht ajo ishte e bërë publike.
11 Po kështu emaili për të kontaktuar TFHS-në, po kështu dihej
12 publikisht. Edhe informacionet e tjera, si për shembull,
13 adresa e internetit e TFHS-së.

14 Të gjitha këto nuk ishin konfidenciale, megjithëse ishin
15 në paketa.

16 Ajo nuk bëri asnjë kontroll për të verifikuar statusin
17 publik të një dëshmitari apo emrave të tjerë të cilët
18 përmbaheshin në këto dokumente. Pra, asnjë kontroll të vetëm
19 mbi këtë çështje. Në faqen 1321 e tha këtë, të nderuar
20 Gjykatës.

21 Dhe nuk mund të ndodhë që të gjithë dokumentet e ZPS-së
22 të jenë konfidenciale apo që i gjithë informacioni i
23 dokumenteve të ZPS-së të jetë konfidencial dhe se nuk kanë
24 nevojë për të parë hollësitë e të gjitha dokumenteve. Kjo nuk
25 mund të ndodhë me dokumentet e ZPS-së, pasi siç e diskutuam

1 dje, sigurisht, që ka material që është konfidencial dhe jo
2 konfidencial brenda çdo dokumenti apo një grup dokumentesh të
3 cilat mund të përshkruhen si konfidenciale.

4 Ndryshimin apo dallimin e bëri z. Berisha dhe e pamë nga
5 botimi i dokumenteve këtë gjë. Z. Berisha nuk ka konsumuar
6 vepër penale duke nxjerrë informacionin e këtyre paketave. Dhe
7 me këtë ka rënë dakord ZPS-ja dhe, ne kështu, kemi rënë dakord
8 gjithashtu.

9 Letrat që i kemi lexuar, ato që i keni parë ju, të
10 nderuar Gjykatës, ato që janë dhënë nuk janë shënuar si
11 konfidenciale. E pamë këtë gjatë ditës së djeshme, në P93,
12 provën materiale P93. Nuk do t'i përmendim emrat.

13 Sekretaria, të nxjerrë në ekran materialin P93.

14 Dokumenti në fund të paragrafit të parë ka dy emra. Po,
15 vetë letra, nuk është shënuar si konfidenciale. Ajo bën,
16 referohet, bën dallimin midis një liste dëshmitarësh të cilët
17 janë konfidencialë, por vetë kjo letër që ka dy emra në
18 paragrafin 1, nuk është konfidenciale.

19 Të shohim tani shkurtimisht P94.

20 Edhe kjo është kërkesë për koordinim, kërkesa numër 30.
21 Ta zvogëlojmë që ta shohim të gjithë faqen në këtë dokument.
22 Dhe mund të shohim që kjo nuk është letër e shënuar si
23 konfidenciale.

24 Të shohim tani P95. Proven materiale P95.

25 Edhe kjo është një letër e 1 korrikut 2014, që është nga

1 kryeprokurori, i dërgohet zyrës së prokurorit të krimeve të
2 luftës dhe i dërgohet kryetarit të këtij -- kryeprokurorit dhe
3 kjo është një kërkesë për të mbledhur informacion lidhur me
4 një person, emri i të cilit përmendet aty.

5 Ky nuk është një emër i përmendur nga z. Gucati apo në
6 praninë e tij. Të paktën deri në kohën e gjyqit kur është
7 pyetur për këtë çështje. Por ky ishte një dokument i botuar
8 nga shtypi dhe nuk ka dyshim, kjo ka ndodhur për shkak se ky
9 dokument nuk është i shënuar si konfidencial.

10 Të shohim tani P96.

11 E pamë këtë dokument gjatë ditës së djeshme, 11 qershor
12 2012, kërkesën për koordinim 112. E pamë dje këtë. Është
13 botuar nga z. Berisha. Nuk është shënuar si konfidencial.

14 P97.

15 Është kërkesa për koordinim numër 41.

16 Në fund të paragrafit të parë, përmendet një emër.

17 Ta zvogëlojmë që ta shohim të tërë dokumentin dhe këtu
18 shikohet që është edhe ky një dokument i cili nuk është
19 shënuar si konfidencial.

20 Tani të shohim provën materiale 1231-ET që është e lidhur
21 me -- që është kjo letër. Pasi këtu e kemi në serbisht dhe nuk
22 e kemi të përkthyer, pavarësisht se është një dokument i TFHS-
23 së. Është një kërkesë e përgatitur nga TFHS-ja në serbisht.
24 Kjo letër është një klip i një video të cilin e kemi parë
25 është P123, është kemi transkriptin e kësaj video të botuar

1 nga Kohavizion dhe këtu bëhet fjalë.

2 "Gjykata e Specializuar" thotë "ka bashkëpunuar me
3 përgjegjës të masakrës së Mejës".

4 Dhe tregon vrasjen e grave dhe të vajzave të vrara në Pejë.
5 Aty përmendet -- dhe më pas përmendet që fëmijët janë vrarë nga
6 mosha një-një vjeç e gjysmë. Është, përmendet emri i një ish-
7 komandanti të milicisë në [REDAKTUAR] dhe më pas kërkesa e
8 koordinimit kundër UÇK-së sipas gazetarit.

9 Dhe e pamë këtë dokument, ishte kërkesa e koordinimit
10 numër 41, e pamë atë të shfaqur në televizion. Dhe përfundimi
11 i kësaj videoje dhe video e kishte të shënuar që vinte nga
12 gazeta *NewBorn*, por përfundimi ishte që ky personi përgjegjës
13 për masakrën e Mejës, për vrasjen 372 civilëve shqiptarë,
14 duhet të ishte në burg, në vend që të bashkëpunonte me
15 Gjykatën e Specializuar.

16 Edhe ky ishte një dokument të cilin e ka bërë dallimin
17 Berisha, është një dokument i cili është botuar nga gazeta
18 *NewBorn* dhe nuk është shënuar si konfidencial.

19 Nga paketa 2, Trupi Gjykses ka parë 6 faqe.

20 Të shohim provën P104. Në faqen 615.

21 Është një provë materiale mjaft e gjerësishme, por ZPS-ja
22 e ka bërë të qartë që vetëm gjashtë faqe janë me vlerë. Në
23 fillim të faqes 615 nga 937 faqe të tëra.

24 Në krye të kësaj faqeje vendosni numrin. Aty ku thotë
25 600, sekretaria të vendosë 615.

1 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Fatkeqësisht kompjuteri
2 është ngrirë.

3 Z. REES: [Përkthim] Pra, faqja 615.

4 Kërkesë për koordinim numër 61. Kjo ka disa redakte të
5 numrit të lëndës. Dhe dy redakte, dy data të shtatorit 2014
6 të cilat shënojnë periudhën kur është bërë kërkesa, që ka të
7 bëjë kërkesa për koordinim.

8 Por edhe këtu bëhet ndryshimi midis listës së
9 dëshmitarëve, që është shtojcë dhe është konfidenciale, po
10 letra vetë nuk është shënuar si konfidenciale.

11 Në faqen tjetër 616 është kopja në serbisht e të njëjtës
12 letër apo e njëjta letër në gjuhën serbe. Dhe pastaj të
13 shkojmë në faqen 617, këtu shikohet kërkesa për koordinim
14 numër 74. Nuk është shënuar si konfidenciale, pavarësisht se
15 në fund të faqes në serbisht, mendoj që i referohet një liste
16 dëshmitarësh të bashkëngjitur e cila është konfidenciale por
17 jo vetë letra.

18 Në faqen 618. Kjo është një letër që ka të bëjë me
19 koordinimin për sigurinë logjistike. Shohim emrin e personit
20 të cilit i është dërguar kjo letër dhe emri që ka dalë edhe në
21 rreshtin e parë, të paragrafit të parë, përmendëm gjatë dje
22 pasi këto ishin -- kopje të kësaj letre janë gjetur në paketën
23 1, si dhe në 2.

24 Dhe pavarësisht se kjo letër fletë mbi konfidencialitetin
25 e hetimit, vetë letra nuk është shënuar si konfidenciale. Dhe

1 përmendet konfidencialiteti i hetimit i cili ka numër
2 reference në krye të faqes dhe ky numër nuk është i fshirë.
3 Pra, ajo që po thoja, të nderuar Gjykatës, që do ta shihni
4 është që është përmendur konfidencialiteti i hetimit. Nuk e
5 dimë pse. Mirëpo letra vetë nuk është e shënuar si e tillë, si
6 konfidenciale. Dhe më pas dy faqet e fundit 619 dhe 620, është
7 letër në serbisht. Nuk është e shënuar si konfidenciale.

8 Znj. Pumper e pranoi, kur dha dëshminë e saj, se shumica
9 e këtyre letrave, e kësaj korrespondence mes ZPS-së apo TFHS-
10 së dhe autoriteteve serbe edhe letra, pra, të cilat
11 demonstrojnë hapësirën e bashkëpunimit apo gjerësinë e
12 bashkëpunimit midis ZPS-së dhe TFHS-së dhe Serbisë nuk janë
13 shënuar si konfidenciale. Janë këto letra, synimi i të cilave,
14 sipas asaj që ka thënë z. Gucati, janë këto letra të cilat
15 demonstrojnë dhe sipas Gucatit mënyrën dhe gjerësinë e
16 bashkëpunimit, shkallën e bashkëpunimit midis ZPS-së dhe TFHS-
17 së dhe Serbisë dhe ato donte t'i nxirrte dhe shtypi i ka
18 botuar ato për këto arsye.

19 Se pasi ato nuk ishin shënuar si konfidenciale, siç i kam
20 thënë më parë, nuk mund -- dhe e kemi parë këtë nga shembujt e
21 z. Berisha, që jo të gjitha dokumentet e ZPS-së janë
22 konfidenciale dhe informacioni i tyre të jetë konfidencial.
23 Duhet t'i shqyrtojmë këto hollësi këtu. Pasi gjatë këtij gjyqi
24 për shkak të vendimit të ZPS-së, ne kemi qenë në gjendje që
25 t'i shqyrtojmë ato në hollësi të mëtejshme. Dhe Prokuroria nuk

1 ka arritur në gjendje që të arrijë të kalojë pragun minimal
2 penal dhe barrën e provës, të provojë barrën e provës.

3 ZPS-ja përmend nenin 62 të ligjit i cili ka të bëjë me
4 një palë të tretë e cila mund të kërkojë qasje për
5 dokumentacion të cilin nuk e ka.

6 Neni 392 i Kodit Penal të 2019-s të Kosovës në të cilin
7 janë të bazuar pikat 5 dhe 6 të Aktakuzës. Nuk mund të flasim
8 për nxjerrje të informacionit i cili nuk është dhënë gjatë
9 procedurave zyrtare.

10 Për sa i përket nenit 62 pra, faktit nëse një palë e
11 tretë ka qasje ndaj materialeve, kjo nuk mbështet argumentin e
12 ZPS-së që të gjitha dokumentet kanë një mbulesë
13 konfidencialiteti pa shtuar asgjë tjetër. E thashë këtë pasi
14 konfidencialiteti dhe mbrojtja që i jepet një personi i jepet
15 nga zyra -- nga Dhomat e Specializuara dhe këtu nuk mbështetet
16 argumenti i ZPS-së që konfidencialiteti të jetë një mbulesë e
17 tërësishme pa dhënë hollësi të mëtejshme.

18 Ne në dosjen tonë përfundimtare kemi bërë analizën e
19 pikave 5 dhe 6 dhe ne sugjerojmë që në të dy këto pika --
20 duhet pafajësia -- duhet të jetë konkluzioni.

21 E vetmja gjë që do të shtoja është që Zyra e Prokurorit
22 të Specializuar është përqendruar, siç e thonë në paragrafin
23 252 të dosjes së tyre, në informacion i cili ka të bëjë me
24 hetimet dhe procedurat penale të ZPS-së, të TFHS-së dhe ato
25 thonë që informacioni i cili ka të bëjë me këto tematika, në

1 bazë të ligjit, nuk duhet të nxirret.

2 Mirëpo, ne argumentojmë edhe njëherë, siç argumenton edhe
3 ZPS-ja, që në këtë mënyrë krijohet një provë e re, e cila nuk
4 gjen -- një formulim i ri i cili nuk është pjesë e nenit 392.
5 Dhe fushëveprimi i tij nuk përfshin këtë përshkrim të ZPS-së
6 për informacion i cili i përket hetimeve apo procedurave
7 konfidenciale të tyre.

8 Dhe në bazë të nenit 6, ne i kemi bërë parashtrimet tona
9 në dosjen tonë përfundimtare, të nderuar Gjykatës, do t'ju
10 kërkoja që të tregonit kujdes ndaj gjuhës statutores mbi të
11 cilën janë bazuar përbërësit e pikës 5 dhe 6 të Aktakuzës dhe
12 jo testit alternativ të ZPS-së, që ka krijuar ZPS-ja.

13 Për shembull, për sa i përket pikës 6, ZPS-ja
14 përqendrohet në përkufizimin e tyre se kush është dëshmitar.
15 Ata thonë që dëshmitari është një person, i cili mund të ketë
16 patur informacion lidhur me një krim brenda juridiksionit të
17 DHSK-së. Ose ka gjasa që kjo mund ta cilësojë një person si
18 dëshmitar apo dëshmitar potencial. Nëse e ka bërë një gjë të
19 tillë nuk ka rëndësi, por ajo që po diskutojmë ne për pikën 6
20 është nëse një person gëzon mbrojtje brenda procedurave penale
21 apo është pjesë e një programi të veçantë të Mbrojtjes.

22 Siç e thashë dje, secili prej nesh këtu në këtë sallë i
23 përmbushim kushtet e dëshmitarit apo dëshmitarit potencial,
24 sipas përkufizimit të ZPS-së, por asnjëri prej nesh nuk jemi
25 persona të mbrojtur në bazë të procedurave penale apo pjesë e

1 një programi të veçantë mbrojtje në bazë të nenit 392(2).

2 Po eci më tutje pasi unë ju thashë dje se sa kohë do të
3 doja të cilën e kam kaluar. Do përfundoj sa më shpejt që të
4 jetë e mundur. Po do ju kërkoja ju, të nderuar Gjykatës, që
5 t'i shikonit më me kujdes të gjitha parashtrimet tona mbi
6 pikën 5 dhe 6 siç i kemi paraqitur në dosjen tonë.

7 Tani do të merrem me nja dy çështje shumë të shkurtra.

8 Unë shpresoj t'i bie shkurt, megjithëse nuk dua të them
9 që nuk janë më pak të rëndësishme.

10 Kemi ngritur gabimet në ligj pasi kjo është mbrojtje
11 sipas nenit 26 të Kodit Penal të Kosovës dhe ne e themi që
12 është e qartë nga provat, nga dëshmitë e paraqitura dje, për
13 sa i përket mënyrës që e ka kuptuar Gucati ligjin dhe kjo
14 është arsyeja përse ne e kemi justifikuar këtë përmes
15 përdorimit nga të tjerët, përfshirë edhe këshillat ligjore.

16 Në qoftë se ne jemi gabim, kur themi që sjellja e tij
17 ishte e ligjshme dhe ju mendoni ndryshe, të nderuar Gjykatës,
18 pra, në qoftë se ju mendoni që ai, që sjellja e tij ka qenë e
19 paligjshme, ne në fakt nuk varemi, nuk jemi bazuar mbi faktin
20 që mendimi i tij apo kuptimi i tij ka qenë i paligjshëm. Ne,
21 në fakt, jemi këtu të bazuar mbi nenin 26 të Kodit Penal të
22 Kosovës.

23 ZPS-ja thotë se kjo mbrojtje -- ose nuk është se është
24 mbrojtje si e tillë. Po është arsyeja për përjashtim nga
25 përgjegjësia penale, siç parashikohet nga Kodi Penal. Pra,

1 ZPS-ja thotë që nuk është e disponueshme sepse është
2 inkorporuar në mënyrë konkrete në regjimin që zbatohet nga kjo
3 Gjykatë. Në parashtrimet tona, me respekt, kjo nuk është e
4 saktë është e gabuar, sepse neni 12 i Ligjit i kërkon Dhomave
5 të Specializuara që të zbatojë ligjet penale materiale të
6 Kosovës me përjashtim të rasteve kur ato bien ndesh me të
7 drejtën zakonore ndërkombëtare. Dhe në rastin në fjalë ne po
8 flasim për çështje të cilat janë çështje të Kosovës dhe ligji
9 kosovar është i zbatueshëm, nuk kemi të bëjmë me ligj
10 ndërkombëtar dhe si rezultat Dhomat e Specializuara të
11 Kosovës, konkretisht mbështetur në nenin 26 të Kodit Penal të
12 Kosovës, por edhe të gjitha dispozitat e tjera të këtij kodi
13 dhe ligjet materiale të Kosovës dhe posaçërisht, neni 12 që të
14 zbatojnë këtë legjislacion.

15 Duam të parashtrojmë më tej lidhur me paragrafin 1 të
16 nenit 26. Që formulimi ose fjalët e nenit 26, pika 1, që
17 personat të cilët në mënyrë të arsyeshme nuk e kanë ditur ose
18 nuk mund të dinin që veprimet e tyre janë të ndaluara dhe mbi
19 të cilat nuk zbatohet përgjegjësia penale. Dhe fjalët nuk
20 kërkojnë, sipas paragrafit 26(1), që të aplikohen për arsye të
21 justifikuara. Domethënë formulimi në vetvete në këtë nen
22 është, absolutisht, i qartë. Domethënë ideja është që sipas
23 këtij neni është e nevojshme që personi të mos ketë pasur
24 dijeni që veprimet e veta ishin të ndaluara.

25 Dhe, në qoftë se ka arsye të justifikueshme për këtë gjë,

1 atëherë personi është objekt i nenit 26(1).

2 Gjithashtu, diskutova dhe dje, sa i takon zbatimit të
3 dispozitave të nenit 26 dhe zbatimit të tij, dispozitave të
4 tij.

5 Më tej, dua që në mbështetje të parashtrimit sot dhe dje,
6 në mbështetje po ashtu dhe të çështjes që ne kemi parashtruar
7 dhe në dosjen paraprake.

8 Dhe kemi thënë në disa detaje, jo vetëm në dosjen e
9 gjykimit, po gjithashtu edhe në fazat e mëtejshme, që
10 parashtrimet e hollësishme janë të rëndësishme sa i takon
11 nxitjes ose shtytjes për kryerjen e veprës. Nuk dua që të
12 futem shumë në hollësi lidhur me këto pika por do të doja t'i
13 kërkoja Trupit Gjykses që t'i shikojë me kujdes të gjitha këto
14 parashtrime.

15 Pa diskutim që ishte çudi, surprizë për mua, të dëgjoja
16 sugjerimin që u shpалos të hënën, që kjo është një çështje e
17 cila ka dalë kohët e fundit. Ne e kemi ngritur këtë çështje që
18 në konferencën e parë për ecurinë e çështjes, e kemi ngritur
19 këtë përpara që për Gjykatësin e Procedurës Paraprake dhe
20 është një element i cili është përsëritur në mënyrë të
21 vazhdueshme në konferencat për ecurinë e çështjes, në
22 konferencat për përgatitjen e Mbrojtjes dhe siç e dini, ka
23 pasur diskutime të shumta të cilat kanë pasur të bëjnë me
24 nxjerrjen e dokumenteve. Dhe më duhet të them që ky është një
25 element, të cilin ne e kemi ngritur që prej fillimit.

1 Ne parashtrojmë që kemi prova të qarta, që kemi nxitje
2 për shtytje në krim, e kemi thënë këtë që në fillim. Kemi
3 prova të qarta të nxitjes ose shtytjes në kryerjen e veprës që
4 lidhen me mënyrën sesi kanë përfunduar dokumentet në OVL-në e
5 UÇK-së. Siç është shprehur edhe në rastin e parë dhe është
6 implikuar gjithashtu edhe në rastet e tjera për të nxitur që
7 këto dokumente të mund t'i jepeshin medias. Ky është element i
8 shtytjes në veprën penale.

9 E vetmja çështje është ajo e cila ka të bëjë me shtytjen
10 e policisë, pra, në qoftë se një nëpunës apo disa nëpunës të
11 ZPS-së kanë qenë të përfshirë në këtë vepër apo në këto
12 veprime të cilat ne pretendojmë që çojnë në shtytje në krim.
13 Ne mendojmë që këto janë çështje që duhen gjykuar nga ju të
14 nderuar Gjykatës, *prima facie* dhe duhet të gjykohet gjithashtu
15 në qoftë se ka pasur një person ose disa persona të ZPS-së të
16 përfshirë në këtë element.

17 Materiali që, sipas ZPS-së, pretendohet që të jetë në
18 paketat 1, 2 dhe 3 është thënë gjithashtu që ka qenë në
19 kontrollin e ZPS-së përpara se dokumentet të përfundonin në
20 OVL-në e UÇK-së, në veçanti, lidhur me dokumentin 3 dhe me
21 ç' duket ka qenë edhe në kontrollin e lidërsipit ose të
22 udhëheqësisë së ZPS-së. Kam dhënë referenca lidhur me këto në
23 parashtrimin e dosjes përfundimtare.

24 Pohimi që është dhënë në paragrafin 303 të dosjes së ZPS-
25 së, që jo të gjitha faqet kanë qenë në zotërim të ZPS-së,

1 sërish kanë të bëjnë me këtë aspekt të çështjes. Dhe ky është
2 një pohim i cili nuk mbështetet në asnjë dëshmi. Pra, nuk ka
3 dhënë asnjë dëshmitar i Prokurorisë dëshmi lidhur me këtë. Po
4 janë thjesht prezumime të cilat janë ngritur nga ZPS-ja.

5 Çfarë ka thënë znj. Pumper, në rreshtat T1028, dokumenti
6 T1028, rreshti 4 dhe dokumenti T1029, rreshti 2, është më mirë
7 ndoshta që të shikojmë dokumentet në vend që unë të perifrazoj
8 apo të përmbledh se çfarë ka thënë znj. Pumper.

9 Ajo thotë:

10 "Ka pasur një dokument që nuk ka qenë i vendosur në bazën
11 e të dhënave në ZyLAB".

12 Ky është rreshti 5.

13 "A do të thotë kjo që është dokument fals?"

14 Dhe përgjigja që jep kjo është që:

15 "Nuk e di në qoftë se është i vërtetë apo jo dokumenti".

16 "Dhe kjo ka ndodhur për shkak se ZPS-ja nuk hedh në
17 sistemin e vet çdo dokument që ka në zotërimin e vet?"

18 Dhe përgjigja është që:

19 "Nuk e konfirmoj këtë gjë, nuk po them që nuk e kemi
20 pasur në zotërim këtë dokument. Thjesht po them që nuk e kemi
21 hedhur në bazën e të dhënave".

22 Pyetja pastaj është kjo:

23 "Po e vërtetë. Kjo do të thotë që ju e keni zotëruar më
24 përpara këtë dokument por e keni tani, po ndoshta nuk e keni
25 pasur atëherë?"

1 Përgjigja është:

2 "Nuk mund ta gjeja në bazën e të dhënave. Do sugjeroja që
3 mbase nuk e kemi pasur por është -- mund të ketë pasur edhe
4 ndonjë problem teknik në sistem".

5 "Dhe në qoftë se, domethënë, a do të thotë kjo që në
6 qoftë se një dokument nuk gjendet në ZyLAB, i takon që nuk e
7 keni as në sisteme të tjera?"

8 Përgjigja është:

9 "Po, kjo është e saktë".

10 Në fakt bëhet fjalë edhe për një dokument të ngjashëm që
11 ajo mund të gjente referencën në bazën e të dhënave ZyLAB.

12 Pra, ajo nuk ka dëshmuar që jo të gjithë fletët, të
13 gjithë dokumentet nuk kanë qenë në zotërim të ZPS-së, siç ka
14 pretenduar dikush tjetër. Dhe ka pasur një numër të vogël të
15 dokumenteve. Megjithatë znj. Pumper, nuk mund të përjashtonte
16 që, pavarësisht që nuk gjendeshin në sistem, këto dokumente
17 ishin në zotërim të ZPS-së. Mbase ishin në zotërim të ZPS-së
18 po nuk ishin hedhur në sistemin ZyLAB.

19 Znj. Pumper na tha se pasi, fillimisht, nuk e dinte që
20 kujt i ishte kërkuar që të bënte koordinimin e hetimeve në
21 OVL-në e UÇK-së. Ajo mori, dha dëshmitë dhe mendoi domethënë
22 që bëri që pyeti dhe mori vesh që ishte Prokurori,
23 Zëvendësprokurori i Përgjithshëm që ishin përgjegjës për
24 hetimin.

25 Pra, duket sikur kemi një lloj kundërshtie këtu. Diçka e

1 cila nuk mund të shpjegohet. E kam fjalën këtu për krahasimin
2 ndërmjet dëshmisë së dhënë nga z. Moberg dhe ai na tha që atij
3 i ishin kërkuar, domethënë, njësisë së tij i ishte dashur pesë
4 ditë që të bënte telefonatat dhe po ashtu, ne mbështetemi në
5 dëshminë e tij dhe ai thotë, po ashtu, që një oficer ose disa
6 oficerë ishin përfshirë në këtë çështje, pasi bëhej fjalë për
7 një çështje emergjence. Pra, sërish, kemi informacionin që
8 Prokurori i Specializuar dhe Zëvendësprokurori i Specializuar
9 kanë koordinuar këtë hetim dhe kjo sipas z. Jukiç, sipas
10 dëshmisë së tij të dhënë në Gjykatë, pra, Njësia e Sigurisë së
11 Dëshmitarit, nuk ishte se ishte e lidhur me këtë. Pra, pak
12 diskutim ka pasur më datën 7 dhe më datën 16 shtator, ata nuk
13 ndërmorën ndonjë veprim më datën 7, as më datën 16. Dhe
14 ndërkohë kanë pritur që të vijohet me arrestimin pastaj të z.
15 Gucati dhe z. Haradinaj deri në momentin që u prodhua lista me
16 emrat e dëshmitarëve nga z. [REDAKTUAR].

17 Pavarësisht nivelit të tillë të lartë të mbikëqyrjes dhe
18 koordinimit ndërmjet znj. Pumper dhe pavarësisht që ishte e
19 qartë nga të gjithë në konferencat për shtyp dhe besoj që do
20 të ketë qenë e qartë dhe për ZPS-në, se kishte mundësi që të
21 përfundonin dhe paketa të tjera në OVL-në e UÇK-së. Pas
22 paketës së parë dhe të dytës nuk është bërë asnjë orvatje për
23 të parandaluar fizikisht dërgimin e materialeve të tjera tek
24 OVL-ja. Domethënë, në qoftë se ZPS-ja nuk do të dëshironte që
25 të dërgoheshin paketa ose dokumente të tjera do të kishte qenë

1 shumë e thjeshtë që të ndalohej ky proces. Për shembull, një
2 ndër taktikat do ishte që vendoseshin në hyrje të OVL-së së
3 UÇK-së persona që të bënin vrojtimin dhe kështu përfundimi që
4 mund të arrihet është që ZPS-ja dëshironte që të dërgoheshin
5 paketa të tjera me informacione.

6 Pra, siç e thashë, ne vazhdojmë që të mbështetemi tek
7 dëshmitë dhe dokumentet të cilat janë dërguar në OVL-në e UÇK-
8 së brenda natës, domethënë, pas dërgimit të paketës së parë
9 dhe të dytë dhe mbështetemi gjithashtu edhe te dëshmia e
10 mungesës së urgjencës. Element të cilin unë e trajtova dhe
11 dje. Çelë Gashi, z. Gucati, z. Haradinaj, të gjithë kishin
12 nënkuptuar që ZPS -- oficerët ose nëpunësit e ZPS-së ishin të
13 kënaqur që të prisnin. Pra, ndërkohë z. Moberg, po ashtu, i
14 ngatërroi datat dhe kemi gjithashtu mungesë konsistence nga
15 ZPS-ja në dëshminë e z. Jukiç edhe z. Moberg.

16 Në mënyrë të pashpjegueshme, ZPS-ja refuzoi që të
17 thërriste të vetmin nëpunës të ZPS-së që mund të thoshte
18 aktualisht se çfarë kishte ndodhur në vizitat e dyta dhe të
19 treta. Dhe nuk është e diskutueshme, mendojmë neve, që nuk
20 kishte fare urgjencë nga ana e ZPS-së në lidhje me paketën e
21 parë dhe paketën e dytë. Këtë gjë e tha dhe vetë z. Jukiç.
22 Ndërkohë që nuk ka pasur orvatje për të ndaluar më tej ardhjen
23 e paketave të tjera. Ka pasur dëshmi nga nëpunësit e OVL-së së
24 UÇK-së që, në fakt, ato kanë qenë nën mbikëqyrje.

25 Dhe znj. Pumper konfirmoi në dëshminë e saj dhe duke iu

1 referuar gjithashtu dosjes përfundimtare --

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees, e
3 kuptoj, e kuptoj kufizimin që keni po në qoftë se doni të
4 vazhdoni më tej mund të bëjmë pushimin.

5 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni të përfundoj
6 dhe pastaj bëjmë pushimin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe sa kohë
8 mendoni se ju duhet?

9 Z. REES: [Përkthim] Mendoj që deri në orën 11.15.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
11 çaktivizuar].

12 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit. Ju jam shumë
13 mirënjohës.

14 Pra, ne i jemi referuar referencës së dukshme të
15 produktit të brendshëm të punës. Produkti i brendshëm i punës
16 që ka përfunduar në OVL-në e UÇK-së në një dokument që, në
17 fakt, ka përfunduar atje vetëm 13 ditë pasi është hartuar.
18 Është sërish një dokument i cili është përgatitur nga një
19 nëpunës i ZPS-ja dhe ZPS-ja refuzoi që të thërriste këtu si
20 dëshmitar të vetmin nëpunës të saj që mund të na kishte thënë
21 neve se çfarë kishte ndodhur në vizitën e dytë dhe të tretë.
22 Mbase Trupi Gjykses duhet të kishte dashur ose mund të kishte
23 dashur që të ndihmohej nga ky person dhe dëshmia e tij.

24 Ne mbështetemi tek fakti që dokumentacioni i cili është
25 botuar nga shtypi, ZPS-ja nuk ka treguar interes ose shumë pak

1 interes nga marrja e këtij informacioni nga të akuzuarit. Ne e
2 dimë që z. Berisha dhe kolegët e tij ende kanë kopje të këtyre
3 dokumenteve. I kemi pyetur për këtë. Dimë që ka kopje të
4 dokumentacionit që janë edhe ende të botuar në internet. Nuk
5 kanë kërkuar që të hiqen këto informacione apo nuk kanë
6 dërguar asnjë lloj urdhri ZPS-ja apo kërkesë tek faqet e
7 internetit për të hequr këtë informacion. Ata kanë shprehur
8 pak interes apo aspak interes apo pak ose aspak shqetësim për
9 ta analizuar në qoftë se ky material që i është vënë në
10 dispozicion OVL-së së UÇK-së dhe pastaj shtypit. Dhe ne nuk
11 kemi parë absolutisht asnjë lloj hollësie për të bërë një lloj
12 vlerësimi në qoftë se ZPS-ja ka bërë ndonjë përpjekje apo jo.

13 Po ashtu, ne na është thënë që janë bërë disa hetime
14 brenda për brenda ZPS-së për të parë se cilat janë rrethanat
15 në të cilat materialet e paketës 3 janë marrë prej saj. Ky
16 raport për të cilin ka folur ZPS-ja dhe që është pjesërisht
17 ofruar si prova, thotë që, organi që ka hartuar raportin nuk
18 mund të përjashtonte mundësinë që dikush nga ZPS-ja të mund të
19 ketë rrjedhur informacionin te palë të treta.

20 Pra, nuk mund të ofroheshin prova pozitive për këtë
21 element. Por sërish ZPS-ja nuk mundi të sillte prova pozitive
22 për të demonstruar, për të dëshmuar në një mënyrë ose në një
23 tjetër sesi ndodhi që ky informacion doli nga zyrat e ZPS-së.
24 Në raportin që është parashtruar, ne nuk gjejmë asnjë lloj
25 prove për asgjë. Sigurisht që ZPS-ja nuk mund të përjashtonte

1 atë çfarë është përfundimi i dukshëm, duke pasur parasysh
2 natyrën e dokumentit dhe qasjen e tij, pra, nuk përjashtojmë
3 dot mundësinë që dikush nga ZPS-ja, që kishte qasje në këtë
4 dokument, të mund t'ia ketë dhënë në mënyrë të qëllimshme një
5 pale të jashtme atë. Dhe shkalla e hetimit e kryer nga ky
6 organ është e paqartë, megjithatë pa diskutim që nuk ishte e
7 qartë, domethënë, që nuk ishte e plotë dhe nuk ishte e
8 thelluar. Dhe, për shembull, nga dëshmitarët që kanë ardhur,
9 askush prej tyre nuk është kontaktuar nga një organ i tillë,
10 nga organi, pra, që ka hartuar raportin.

11 Z. Jukiç, i cili është drejtuesi i ekipit të Njësisë së
12 Sigurisë së Dëshmitarëve, ky organ nuk ka folur me të apo nuk
13 është se i ka bërë ndonjë pyetje atij. Nuk është marrë në
14 intervistim. Nuk është kërkuar që të shikohet në kompjuterin e
15 tij, në emailt e tij apo në dokumente të tjera digjitale të
16 cilat ai na ka thënë që i ka mbajtur jashtë sistemit të ZPS-së
17 apo, le të themi, në ato USB-të që ka përdorur për të ruajtur
18 materialet, siç na tregoi gjatë dëshmisë së tij. Ata nuk kanë
19 kërkuar as telefonin e tij, as komunikimet që ka realizuar ai.

20 Dhe znj. Pumper, po ashtu nuk është kontaktuar fare. Ata
21 nuk është se kanë kërkuar fare që të shikojnë emailt e saj,
22 kompjuterin e saj, shkëmbimet e saj dhe nuk i është kërkuar
23 asgjë për arsye të këtij ushtrimi.

24 Kështu që, mbase, nuk është habi që ata nuk gjetën ndonjë
25 të dhënë pozitive, ndonjë të dhënë që të dëshmonte sesi

1 dokumentet kanë rrjedhur nga zyrat e ZPS-së dhe nuk
2 përjashtohet mundësia që dikush nga ZPS-ja t'ia ketë dhënë
3 informacionin një pale të jashtme.

4 Ka pasur dëshmi, që i ka dëgjuar edhe Trupi Gjykues, që
5 implikonte dhe emrin e një nëpunësi të ZPS-së. Dëshmia që dha
6 z. Jukiç dhe në fakt, ky është i vetmi element, e vetmja
7 provë. Z. Jukiç u pyet kur u thërrit për të dhënë dëshmi
8 përsëri:

9 "A keni dijeni se më 28 shtator një dëshmitar i
10 implikuar, një zyrtar i ZPS-së..."

11 Dhe u tha emri.

12 "... si burim i dokumenteve zyrtare?"

13 Dhe Jukiç tha që e kishte parë atë notë zyrtare.

14 Pra, këto janë provat.

15 Mund të ketë dokumente të tjera mund t'i ketë parë Trupi
16 Gjykues. Mund të ketë prova të tjera të cilat janë për
17 dokumentet që ju janë nxjerrë, por këto nuk janë shënuar në
18 procesverbalin e gjykimit dhe në provat. Dhe, faktikisht,
19 provat janë që një zyrtar i ZPS-së, i cili u përmend me emër,
20 dhe që znj. Pumper e pranoi që ishte në Hagë në kohën kur ajo
21 po jepte dëshmi, ky person mund të ishte thirrur për të dhënë
22 dëshmi nga ZPS-ja.

23 Ne, në dosjen tonë përfundimtare, themi që ky është
24 motivi për të shtytur për të kryer vepër penale z. Haradinaj
25 dhe z. Gucati dhe mendoj që ky është një motiv i qartë që

1 kishin ata për ta bërë këtë.

2 E themi këtë në këto rrethana se mbi bazën e provave që
3 ka Trupi Gjykues para vetes, nuk është i pamundur si
4 pretendim. Dhe në qoftë se bëhet një pretendim për shtytje për
5 kryerje të veprës penale nga organet e ligjit, i takon
6 Prokurorisë që të vërtetojë se nuk ka pasur nxitje nga policia
7 apo nga organet zyrtare. Ata vetëm kanë ndenjur dhe nuk kanë
8 provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se nuk ka pasur nxitje
9 nga organet policore. Dhe kjo është shkelje e nenit 6 të
10 Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe z. Halling
11 tha që ky nen nuk zbatohet në këtë rast, po faktikisht ai
12 zbatohet në këtë rast. Dhe shkelja e nenit 6, sipas
13 jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
14 duhet të ketë masë ligjore për të vënë drejtësinë dhe masa
15 ligjore që propozojmë ne është që ZPS-ja të pranojë që të
16 ndalohet ky gjykim, të pushohet ky gjykim.

17 Për këto arsye ne kërkojmë, ashtu siç kemi thënë edhe në
18 dosjen përfundimtare, që të gjitha vendimet të jenë për
19 vendime pafajësie ose përndryshe që procedura gjyqësore të
20 pushohet për arsye të -- në bazë të nenit 6 të konventës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 z. Rees.

23 Do të bëjmë pushim tani. Dhe pastaj mbas pushimit z.
24 Cadman do të paraqesë për z. Haradinaj.

25 --- Pauza fillon në orën 11.13

1 --- Seanca rifillon në orën 11.45

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,
3 keni fjalën.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

5 Unë paraqitem këtu në emër të z. Haradinaj. Ai është
6 akuzuar me 6 pika në aktakuzë për pretendime për vepra penale
7 kundër administrimit të drejtësisë.

8 Z. Haradinaj është paraburgosur për 18 muaj. Është
9 kritikuar sepse ka thënë atë që beson dhe atë që konsideron se
10 është e vërtetë, kur Prokuroria mendon sigurisht të kundërtën.

11 Ne themi që ka mungesë të plotë provash për t'i vërtetuar
12 këto pretendime kundër tij.

13 Ne themi që ka pasur të meta në nxjerrjen e dokumenteve
14 që do të thotë që z. Haradinaj dhe unë si avokat i tij, nuk
15 kam pasur dokumentet që duhen dhe pavarësisht nga ajo që thotë
16 Prokuroria, ato përbëjnë bazën e dënimit për të. Unë nuk
17 tërhiqem nga deklarimi i këtyre. E kam për detyrë për ta bërë
18 këtë. Duke pasur parasysh këtë mungesë të dhënies së
19 dokumenteve, kjo përbën një çështje, një defekt për sa i
20 përket gjykimit të drejtë, ndër të tjera. Sepse ai nuk ka
21 pasur mundësinë e duhur, ne nuk kemi pasur mundësinë e duhur
22 për të bërë kundërpyetjet që duhen.

23 Unë nuk do t'i përsëris të gjitha gjërat që kam thënë në
24 dosjen përfundimtare, por do të them shkurtimisht disa gjëra
25 më kryesore, të cilat duhet të parashtrohen patjetër. Ju keni

1 dëgjuar parashtrime nga mbrojtja elementët e krimeve, format e
2 përgjegjesisë penale. Të gjitha këto nuk do t'i trajtoj në
3 hollësi, por do t'i përgjigjem në fund çfarëdo pyetjesh që
4 mund të keni ju si Trup Gjykues.

5 Po kështu keni dëgjuar parashtrimet e gjerësishme të z.
6 Rees në emër të z. Gucati dhe që unë i miratoj plotësisht që
7 zbatohen edhe për z. Haradinaj. Unë nuk do t'i përsëris ato.
8 Sigurisht ju thatë në fillim të këtyre seancave që nuk ka
9 nevojë të përsëris ato që tha z. Rees.

10 Unë e pranoj që, ashtu siç tha dhe z. Rees, ai është
11 përfaqësues i z. Gucati, unë jam përfaqësues i z. Haradinaj,
12 por ka plot gjëra për sa i përket ligjit dhe provave, të cilat
13 janë njësoj të zbatueshme për të dy të akuzuarit.

14 Unë do t'i ndaj parashtrimet e mia në 4 pjesë kryesore.
15 Në pjesën e parë do të bëj disa vërejtje për provat, të cilat
16 ne themi janë me defekte. Në pjesën e dytë do të diskutoj
17 çështjen, provat e Prokurorisë. Në pjesën e tretë do të
18 trajtoj disa prej aspekteve të mbrojtjes që kemi parashtruar
19 ne. Dhe në pjesën e katërt do të përpiqem t'i përgjigjem disa
20 parashtrimeve të Prokurorisë.

21 Përpara se të fillojmë me themelin e parashtrimeve të
22 mija, desha të bëj disa vërejtje fillestare.

23 Së pari, që në fillim z. Rees tha që ky është një rast
24 kur Prokuroria duhet të vërtetojë përtej dyshimit të
25 arsyeshëm. Edhe unë e ngre këtë pikë, pra kjo barrë i takon

1 Prokurorisë. Kjo është një çështje ku Prokuroria nuk mund t'i
2 referohet provave, ngjarjeve dhe pastaj të mohojë aspekte të
3 ligjit. Dhe këtu në rastin e z. Haradinaj, apo të ndonjë të
4 akuzuari tjetër, nuk i takon atyre që të vërtetojnë pavarësinë
5 e tyre. I takon Prokurorisë që duhet të vërtetojë të gjitha
6 pikat e aktakuzës. Dhe kjo është një përgjegjësi shumë
7 serioze.

8 Unë nuk i kam të vëna dëgjueset, në qoftë se bëhet
9 kërkesë për t'u ngadalësuar, ju lutem më thoni.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm një
11 sqarim. Duhej t'ju thosha këtë përpara. Do t'ju jepet një orë
12 e gjysmë e plotë deri në pushimin e drekës për të parashtruar
13 pikëpamjet tuaja.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Sigurisht, Trupi Gjykses i ka
15 parasysh këto detyrime të Prokurorisë, por janë pika të
16 rëndësishme që duhet t'i ngre në mënyrë që të jenë parasysh
17 kur të vendosni për këtë çështje. Unë kam besim të plotë, siç
18 ka dhe z. Haradinaj, që Trupi Gjykses do të zbatojë parimet
19 bazë që zbatohen për provat dhe do t'i trajtojë ato në mënyrë
20 të drejtë dhe të barabartë, pavarësisht nga ato që thotë
21 Prokuroria në parashtrimet e veta.

22 Dhe në deklaratën e vet mbyllëse, Prokuroria pati një
23 qasje shumë agresive duke kritikuar dosjen përfundimtare të
24 Haradinaj dhe të Gucatit dhe unë do t'i përgjigjem disa
25 komenteve specifike të ZPS-së në parashtrimet e miya.

1 Unë i jam përgjigjur atyre në dosjen time, por dua të
2 them diçka. Unë e pranoj hapur që, në dosjen tonë përmenden 3
3 herë dokumente që nuk janë pranuar si prova, e njëjta gjë ka
4 qenë e vërtetë edhe për Prokurorinë. Ata i janë referuar
5 raporteve për shembull në shtyp, të cilat nuk janë futur si
6 prova materiale.

7 Unë nuk do ta zgjas shumë me këtë pikë, por desha të them
8 që megjithëse ZPS-ja e kritikon mbrojtjen, ata vetë nuk janë
9 të shfajësuar nga ajo që bëjnë vetë. Trupi Gjykses do ta ketë
10 parasysh kur të shohë provat me kujdes, siç e di që do ta
11 bëni, do t'i keni parasysh këto.

12 Së treti, sipas ligjit, Mbrojtja e Haradinajt ka dorëzuar
13 një parashtrim, siç e kam parathënë edhe më përpara, për sa i
14 përket elementëve të krimeve dhe për format e përgjegjësisë
15 penale.

16 Ne mbështetemi tek ky dokument si pjesë e argumentimeve
17 tona ligjore në lidhje me dosjen përfundimtare. Po kështu
18 themi që, ne si Mbrojtje jemi të qëndrimit se mbrojtjet tona
19 janë substanciale në raport me ligjin. Në qofte se ka dallime
20 midis dy pozicioneve të mbrojtjeve, që unë them që nuk ka, ne
21 jemi të të njëjtit mendim me atë që paraqiti z. Gucati. Dhe
22 pastaj mendimi jonë të merret si mendim alternativ.

23 Së katërti. Për sa i përket kontekstit dhe rëndësisë së
24 kësaj çështje, duhet të themi këtë: Pavarësisht nga
25 perceptimet gjatë gjithë këtij gjykimi, Gjykata përfaqëson

1 popullin e Kosovës dhe të gjitha viktimat. Dhe Trupi Gjykses
2 duhet ta ketë parasysh këtë.

3 Unë nuk munda që të bëj parashtrimet fillestare në emër
4 të z. Haradinaj për shkak se isha i sëmurë. Por, në atë
5 deklaratë hyrëse u tha që, në gjykatat që gjykojnë çështje --
6 zakonisht gjykatat gjykojnë çështje, por nganjëherë janë
7 çështjet që gjykojnë gjykatat dhe ne mendojmë që ky është
8 rasti në këtë gjykatë. Është një përgjegjësi e madhe që i
9 takon z. Rees, më takon mua, i takon edhe Trupit Gjykses.

10 Ne parashtrojmë se kjo çështje ka të bëjë shumë më tepër
11 se sa me fatin e dy peronave që janë këtu duke u gjykuar. Kjo
12 ka pasoja gjithëpërfshirëse që shtrihen jashtë mureve të kësaj
13 Gjykate. Ne kemi dëgjuar nga Prokuroria për rëndësinë e këtij
14 institucioni, se si duhet të mbrohen individët, kanë folur për
15 drejtësinë edhe shtetin ligjor. Ne kemi dëgjuar që kjo bëhet e
16 gjitha për viktimat e luftës së Kosovës.

17 Sigurisht, Prokuroria ka të drejtë për këto pika. Por,
18 këtu qartësisht mungon gjykimi apo ndjekja penale e agresorëve
19 serb. Dhe kjo çështje është për të ardhmen e Kosovës dhe
20 popullin e Kosovës. Është çështje për drejtësinë dhe kur të
21 mohohet drejtësia, i mohohet drejtësia edhe mijëra viktimave
22 të këtij agresioni.

23 Ky institucion ka juridiksion mbi të gjitha krimet e
24 kryera në konflikt nga të gjithë palët, nga të gjithë kryesit.
25 Megjithatë, kjo Gjykatë tani ka çështje gjyqësore vetëm për

1 një palë të caktuar. Nuk e them këtë si deklaratë politike.
2 Nuk ka të bëjë me luftën e drejtë apo për pandëshkueshmerinë.
3 Është deklaratë e faktit, faktike që u konfirmua edhe nga
4 Prokuroria.

5 Në qofte se dikush meriton drejtësi dhe të gjithë
6 meritojnë drejtësi, Prokuroria e ka pranuar përmes znj.
7 Pumper, duhet pranuar që nuk janë ndjekur penalisht këtu
8 kryesit serb. Kjo do të thotë që nuk ka hetime në vijimësi për
9 masakrat e shumta të kryera nga serbët e Kosovës, forcat
10 ushtarake dhe paramilitare, disa prej tyre janë edhe në
11 njoftimet e kuqe, siç quhen, të Interpolit. Disa prej tyre
12 madje janë edhe krenarë që e pranojnë që janë shtytës të këtij
13 procesi këtu. Unë nuk do të përmend emrat e tyre, por gjatë
14 këtij gjykimi kemi dëgjuar se kush janë ata. Dje z. Rees na i
15 dha këto emra.

16 Ju mund të mendoni që kjo nuk ka lidhje me këto
17 procedura, siç e tha Prokuroria. Z. Haradinaj mendon se kjo
18 është drejtpërsëdrejti, bile është qendrore për mbrojtjen e
19 tij. Sepse ai akuzohet që ka minuar procesin e drejtësisë, ka
20 kërkuar që të rrëzojë institucionet. Kjo nuk pranohet,
21 sigurisht, nga ana e jonë.

22 Z. Haradinaj është shprehur qartë se, të gjithë që kanë
23 kryer krime në Kosovë duhet të ndiqen penalisht dhe të
24 përballen me drejtësinë kushdo që të jenë, qoftë UÇK, zyrtarë
25 serb, serb të Kosovës apo çfarëdo qytetar tjetër apo etnie

1 tjetër që jeton në Kosovë. Ai tha që, askush nuk duhet të
2 mbrohet nga drejtësia.

3 Kur ai u bë nënkryetar, bashkë me z. Gucati si kryetar të
4 OVL UÇK-së, ai e bëri një gjë shumë të qartë: Ata persona që
5 thirreshin nga ZPS-ja duhet të bashkëpunonin. Kjo ndryshoi
6 pozicionin e mëparshëm që kishte pasur OVL-ja. Ata duhen të
7 bashkëpunojnë sepse s'kanë asgjë për të fshehur dhe asgjë për
8 të pasur frikë. Këtë ka thënë ai në dëshminë e tij. Çështja
9 është që ata duhet të jenë krenarë dhe t'i përgjigjen të
10 gjitha akuzave që iu paraqiten.

11 Kur z. Haradinaj bëri një fushatë, që e përmendi ZPS-ja,
12 ku mblodhi 150 mijë nënshkrime, kjo nuk ishte për të minuar
13 procesin e drejtësisë dhe të vërtetën, apo për të minuar
14 pajtimin. Ai bëri një peticion për t'ia paraqitur Kuvendit për
15 ta amenduar ligjin për Dhomat e Specializuara. Kur foli kundër
16 Dhomave të Specializuara në shtator të 2020-s, përsëri edhe
17 kjo nuk ishte për të penguar proceset. Këto ishin hapa për të
18 siguruar që Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja të zbatonin
19 drejtësinë në mënyrë të barabartë dhe të mos ishte një proces
20 që ai e konsideron përzgjedhës dhe diskriminues.

21 Z. Haradinaj ia ka dedikuar jetën e tij pavarësisë dhe
22 integritetit fizik të Kosovës. Ai dhe veprimet e tij duhet të
23 shihen përmes kësaj thjerrëze agresioni, agresion të cilin ai
24 e ka përjetuar. Ka një përgjegjësi shumë të madhe ky Trup
25 Gjykues që të vendosi drejtësinë në këtë proces dhe procesi

1 nuk ka të bëjë me rishkrimin e historisë, por duhet të vendosi
2 drejtësinë. Dhe këtë kërkon z. Haradinaj.

3 Në këtë rast të gjitha dokumentet që thuhet që janë
4 nxjerrë, besohet që kanë dalë nga ZPS-ja. Z. Haradinaj nuk i
5 ka marrë këto materiale, çështje të cilën e ka konfirmuar
6 haptazi Prokurori i Specializuar. Në fjalën hyrëse Prokuroria
7 tha që, z. Haradinaj nuk është përgjegjës për nxjerrjen apo
8 për vjedhjen e këtyre dokumenteve.

9 Prokuroria e ka lejuar që të nxirren këto dokumente dhe
10 deri në këtë ditë nuk dihet se si ka ndodhur kjo. Duhet pyetur
11 se përse.

12 Prokuroria të tërë çështjen e bazon në atë që ne e quajmë
13 prova të dorës së tretë, prova apo dëshmi mbi të cilat
14 dëshmitarët nuk kanë pasur njohuri të drejtpërdrejtë. Ne themi
15 që transparenca e tyre nuk është e besueshme, është një
16 çështje e cila nuk duhet të kishte arritur deri në këtë pikë.

17 Ai ka kaluar një vit e gjysmë në burg përpara se të
18 arrinte në këtë fazë. Ai ka pranuar që e ka kritikuar Zyrën e
19 Prokurorit të Specializuar, duke kritikuar qasjen e saj të
20 mjegullt ndaj sistemit të drejtësisë. Ai ka kritikuar atë që
21 ai mendon një qasje monoetnike dhe diskriminuese ndaj
22 drejtësisë. Dhe ka të drejtë të plotë që t'i përmbahet këtij
23 qëndrimi, siç e ka konfirmuar edhe Zyra e Prokurorit të
24 Specializuar.

25 Para shtatorit 2020, asnjë anëtar i Zyrës së Prokurorit

1 të Specializuar apo i Dhomave të Specializuara nuk ka kërkuar
2 që këto shqetësime t'i diskutojnë me z. Haradinaj apo me
3 ndonjë anëtar tjetër të OVL UÇK-së. Po e theksoj edhe një
4 herë, ai ka të drejtë absolute që t'i përmbahet këtij
5 qëndrimi. Kjo është një shprehje e të drejtave themeltare dhe
6 lirive themeltare që gëzon çdo qytetar i Kosovës.

7 Ai akuzohet se ka nxjerrë, ka kërcënuar, ka frikësuar apo
8 ka kërkuar që të hakmerrej kundra disa individëve të caktuar.
9 Siç kemi dëgjuar gjatë një dite e gjysmë tashmë, nuk ka pasur
10 kanosje dhe pengim, nuk ka pasur ndërhyrje, nuk ka pasur as
11 hakmarrje. Nuk duhet harruar që në asnjë fazë Prokuroria nuk
12 ka identifikuar asnjë dëshmitar i cili të jetë frikësuar apo
13 kërcënuar si rezultat i veprimeve të z. Haradinaj, apo të
14 bashkëakuzuarit, z. Gucati.

15 ZPS-ja nuk ka identifikuar se kundër kujt është hakmarrë
16 dhe akuzat i ka bërë në terma të përgjithshme. Shkurtimisht,
17 ne i përmbahemi qëndrimit që ZPS-ja nuk është në gjendje që të
18 provojë asnjëherë nga pikat e aktakuzës.

19 Z. Haradinaj, dhe do të flas më gjatë mbas pak për këtë
20 çështje, ka argumentuar se të gjitha veprimet për të cilat
21 akuzohet se i ka ndërmarrë, janë çështje të interesit publik
22 ndërkombëtar. Në këtë rast, ndryshe nga ajo që u përpoq që të
23 argumentojë z. Halling, interesi publik është në favor të z.
24 Haradinaj, në mënyrë shumë të qartë.

25 Gjatë ditës së shkuar keni dëgjuar gjerësisht nga z. Rees

1 se cilat janë dëshmitë e kësaj çështje. Dosja jonë
2 përfundimtare e diskuton këtë në hollësi. Siç e thashë në
3 fillim, unë nuk dua të përmend dëshmitë që janë përmendur deri
4 më tani, apo që t'i diskutojmë këto prova në hollësi të
5 mëtejshme. Unë e miratoj tërësisht atë që ka paraqitur gjatë
6 një dite e gjysmë në vazhdimësi z. Rees.

7 Megjithatë dua të përmend disa nga këto çështje mbi
8 dëshmitë që janë paraqitur këtu para Trupit Gjykses.

9 E para që dua të diskutoj ishte mbi standardet hetuese
10 dhe zinxhirin ruajtës, çështje të cilat për sa na përkon neve,
11 janë shumë të rëndësishme, qendrore, në fakt, për
12 kredibilitetin e çështjes që ka paraqitur ZPS-ja.

13 Së pari, z. Bob Reid dha dëshminë e tij si ekspert lidhur
14 me autenticitetin e Paketave 1 dhe 3 [sipas përkthimit]. Nuk
15 ka nevojë që të përkujtoj Trupin Gjykses që nuk është hedhur
16 poshtë fakti që ai është ekspert i kësaj fushe për më shumë se
17 3 dekada në vendin e tij dhe nivelin ndërkombëtar. Ai dha
18 dëshmi që shënimet e dërgesave për sa i përket operacioneve në
19 datën 8 dhe 17 që kishte parë, sipas mendimit të tij nuk ishin
20 bazë për konfiskim. Nuk dua që ta vendosim në ekran, por
21 referenca gjendet në dëshminë e tij më datën 24 janar, në
22 faqen e transkriptit 3249, rreshti 1 deri në 6.

23 Ai tha në mënyrë të posaçme dhe po citoj nga rreshti 6
24 deri 11 i të njëjtës faqe:

25 "Në mungesë të një inventari, nuk dihet se çfarë

1 dokumentesh janë konfiskuar. Në fakt nuk dihet se sa faqe janë
2 konfiskuar dhe nuk dihet se çka ndodhur me to, ku janë dërguar
3 apo gjëra të kësaj natyre".

4 Ai përdori frazën që shënimi i dërgesës "duket si një
5 faturë".

6 Më pas, ai foli mbi parimin e zinxhirit të ruajtjes së
7 dokumenteve, që gjendet në faqen 3223 të transkriptit,
8 rreshtat 9 deri në 12. Ai përshkroi këtë parim të zinxhirit të
9 ruajtjes kur tha që, ky zinxhir është i thjeshtë. Në momentin
10 që ju keni dokumentin, duhet të dini se ku ndodhet ky
11 dokument, 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, edhe kur është në
12 njësinë e dëshmive tuaja.

13 Dhe më pas ai shpjegoi se çfarë ndodh kur nuk ruhet ky
14 zinxhir. Ai tha që, në qoftë se ndodh një gjë e tillë, atëherë
15 mund t'ju kundërshtojnë lehtësisht. Dhe pastaj e rëndësishme
16 është që kur shkoni para një trupi gjykues, që është dhe
17 arsyeja pse konfiskoni dokumente, atëherë vihen pikëpyetje të
18 mëdha mbi integritetin e dokumenteve të konfiskuara. Ai tha:

19 "Po t'i ndiqni këto udhëzime të zinxhirit të ruajtjes"
20 dhe e pranoi "ndoshta përsëri mund t'ju kundërshtojë pala
21 mbrojtëse, por jeni në gjendje që të mbroni integritetin e
22 dokumentacionit".

23 Po t'i hedhim një sy Paketës 1, dëgjuam nga Daniel
24 Moberg, zyrtar i ZPS-së mbi çështjet e sigurisë, kur ai
25 shpjegoi se si i kishte konfiskuar dokumentet më datën 8

1 shtator. Ai konfirmoi që, pasi ishin marrë dhe ishin dërguar
2 në zyrat e ZPS në Prishtinë, ku ai tha ishin skanuar për t'u
3 dërguar drejtpërsëdrejti në Hagë. Ai nuk ishte në gjendje të
4 thoshte se kur u konfiskuan këto dokumente, ato ishin vendosur
5 në një qese të provave materiale, të dyllosur dhe të firmosur
6 nga pjesëmarrësit dhe që të jetë bërë inventar në atë kohë.
7 Dhe procesverbali i konfiskimit të dokumenteve në datën 8
8 shtator është i rëndësishëm, pasi siç mund ta mbani mend, pasi
9 është parë shënimi i dorëzimit, në fakt ai ka të bëjë me një
10 pjesë të dokumenteve të printuara. Dokumente të cilët i ishin
11 dërguar OVL UÇK-së. Ai nuk ka informacion mbi faqet, sa e
12 madhe ishte kjo paketë, çfarë përmbahej atje dhe nuk përmendet
13 nëse ka pasur një qese të provave materiale.

14 E njëjta gjë ka ndodhur edhe me Paketën 2 të konfiskuar
15 në datën 17 shtator. Dokumente të dërguara tek OVL-ja nga një
16 burrë i panjohur më datë 16 shtator.

17 Dhe referenca për këtë paketë është P00055 dhe për 8
18 shtatorin është P0092 [sipas përkthimit].

19 Daniel Moberg tha po kështu që ishte i pranishëm edhe në
20 datën 17 dhe 22 shtator, por nuk ishte në gjendje t'i mbante
21 mend saktësisht të dy këto ngjarje. Dokumenti i dorëzimit të
22 17 shtatorit nuk ka shpjegim mbi përmbajtjen e dosjes, nuk
23 specifikohet numri i dokumenteve, lloji i dokumenteve apo nuk
24 ka ndonjë numër të qeses së provave materiale.

25 Për sa i përket Paketës 3, përmbledhja që ka dhënë z.

1 Moberg për sa i përket konfiskimit të Paketës 2, ka vlerë edhe
2 për Paketën 3. As urdhri i Prokurorit të Specializuar i 22
3 shtatorit dhe as pranimi i urdhrin të konfiskimit të së
4 njëjtës datë, procesverbali i dokumenteve të konfiskuara apo
5 të paraqitura. Asnjë prej këtyre dokumenteve nuk janë vendosur
6 në një qese provash, apo në çfarë qese provash të jenë futur
7 këto dokumente.

8 Po kaloj tani tek dëshmia që ka dhënë znj. Anna Myers.
9 Ajo e dha dëshminë në datën 21 janar. Edhe ajo është eksperte
10 e fushës, eksperte e njohur në fushën e sinjalizuesve dhe të
11 interesit publik. Kredencialet e saj janë pranuar nga Trupi
12 Gjykues dhe nga ZPS-ja.

13 Në dëshminë e saj, ajo përmendi përkufizimin që ka bërë
14 z. David Kay, ish-reporteri i Kombeve të Bashkuara. Dhe ajo u
15 korrigjua lidhur me deklaratën e saj lidhur me përkufizimin e
16 njëres prej çështjeve nga ZPS-ja, që në fakt ishte një gabim
17 shtypi që nuk ka ndikuar mbi dëshminë e saj në tërësi.

18 Një nga çështjet që ka diskutuar znj. Myers ishte nëse
19 mund të quhesh sinjalizues në qofte se nuk je i punësuar diku.
20 Ajo tha që në qoftë se informacioni vjen nga një punëdhënës
21 dhe ky informacion i është dhënë një pale të tretë, atëherë je
22 sinjalizues përmes një tjetri. Ajo konfirmoi që, sinjalizuesi
23 përmes një pale tjetër eksiton edhe në qoftë se një punëdhënës
24 i një autoriteti të prokurorisë, i ka nxjerrë informacion një
25 pale të tretë dhe kjo palë e tretë i ka nxjerrë këto

1 dokumente. Dhe sipas mendimit tonë z. Haradinaj duhet të
2 klasifikohet apo të quhet se është sinjalizues përmes një pale
3 tjetër, për çështjen në fjalë, për këtë çështje.

4 Tani dua të përqendrohem te dëshmia që ka dhënë vetë z.
5 Haradinaj. Pranohet ajo që tha z. Rees është që z. Haradinaj
6 ka nxjerrë disa dokumente për interesin publik dhe ai e ka
7 bërë në mënyrë të efektshme dhe kontrastin mes trajtimit të z.
8 Berisha dhe pavarësisht se të njëjtën gjë vlerëson edhe për z.
9 Haradinaj. Mund t'ju kujtohet që z. Rees tha në mënyrë të
10 hollësishme që fakti që z. Berisha ja kishte dhënë materialin
11 një numri gazetarësh të tjerë, 4 gazetarëve dhe redaktuesit të
12 tij në pjesën e punës, është në fakt një çështje themeltare
13 për këtë rast, pra fakti që z. Berisha është trajtuar ndryshe
14 nga z. Haradinaj dhe nga z. Gucati.

15 Unë dua të miratoj këto dhe atë që ka thënë z. Rees, por
16 nuk dua ta përmend. Por dua në këtë mënyrë të përmend një fakt
17 tjetër që ka dalë përmes dëshmisë gojore që ka dhënë z.
18 Haradinaj.

19 Së pari, arsyet pse ka vepruar siç veproi në atë kohë. Ju
20 e mbani mend që e ka bërë të qartë që, veprimet e tij ishin të
21 diktuara nga interesi publik dhe ai e ka shpjeguar se cili
22 ishte ky interes publik. Deklarata e tij nuk ka pasur asnjë
23 paqartësi. Ai e ka përsëritur gjatë dëshmisë së tij shumë herë
24 këtë qëndrim. Ai tha që po vepronte në interesin publik dhe
25 për hir të transparencës.

1 Që z. Haradinaj ishte në favor të drejtësisë për të tërë
2 është e qartë. Këtë e ka përsëritur vazhdimisht gjatë të
3 gjithë dëshmisë së tij.

4 U pyet nëse ishte kundër Dhomave të Specializuara dhe aty
5 ju kujtohet që në një pikë të caktuar ai bëri një dallim midis
6 ekzistencës së Dhomave të Specializuara dhe politikës së
7 Prokurorit të Specializuar.

8 Pavarësisht seancës së pyetjeve që i janë bërë, ai tha se
9 nuk ishte kundër Dhomave të Specializuara, që nuk ishte në
10 favor të mbylljes së tyre dhe të gjitha shqetësimet e tij për
11 sa i përket Dhomave të Specializuara që rezultuan në
12 petitionin e dërguar në Parlament, janë shpjeguar si pjesë e
13 amendamentit pasi ai argumentoi që ky institucion, kryesisht
14 Prokuroria e Specializuar, duhej të vepronte në bazë të ligjit
15 dhe në parimin e drejtësisë së barabartë për të gjithë.

16 A ka nxjerrë z. Haradinaj emra të dëshmitarëve. Ai e ka
17 bërë të qartë në dëshminë e tij që nuk e ka bërë një gjë të
18 tillë dhe nuk dua të përsëris këtu parashtrimet që ka bërë z.
19 Rees për sa i përket dallimit në këtë fjalë, por është e qartë
20 që kjo ka vlerë edhe për dëshminë që ka dhënë z. Haradinaj. Ai
21 përmendi emrat e nxjerrë që ishin të zyrtarëve të njohur
22 publikë dhe tha që emrat nuk duhen të bëhen publikë. Këto janë
23 çështje tërësisht jetësore, pasi ato në një mënyrë i japin
24 formë të gjithë dëshmisë që ka dhënë z. Haradinaj.

25 Siç do ta shpjegoj për më tepër në pjesën e katërt,

1 realiteti i asaj që ka dhënë z. Haradinaj, ishte thelbësisht i
2 ndryshëm nga ajo që ka thënë ZPS-ja. Edhe një herë e përsëris,
3 nuk është se z. Haradinaj është kundër drejtësisë. Nuk është
4 se ai ishte i vendosur për ta minuar këtë institucion dhe nuk
5 është e vërtetë që ai ka përmendur emrat e dëshmitarëve të
6 mbrojtur. Në fakt ai ka qenë i kujdesshëm dhe i ndërgjegjshëm
7 për atë që ka bërë. Gjatë gjithë kohës ai ka vepruar, siç e ka
8 thënë në fjalën e tij, në interesin e publikut dhe ka besuar
9 që kjo ishte rruga e drejtë që duhej ndjekur. Ai ka vepruar në
10 mënyrë krejtësisht të hapur dhe çdo gjë që ka bërë, e ka bërë
11 në publik.

12 Siç e tha z. Rees në fillim të deklaratës së tij
13 mbyllëse, unë do ta inkurajoja Trupin Gjykses që të ketë të
14 njëjtën qasje, që t'i trajtojë të tërë provat në tërësinë e
15 tyre dhe jo në copëza të përzgjedhura.

16 Për sa i përket dëshmisë që ka paraqitur Prokuroria. Këtë
17 e kemi trajtuar në dosjen tonë përfundimtare dhe e ka bërë në
18 mënyrë shumë të hollësishme z. Rees gjatë ditës së djeshme dhe
19 pjesërisht gjatë ditës së sotme. Siç e thashë edhe më përpara,
20 nuk dua të përsëris gjërat që janë thënë, por gjithsesi dua që
21 të sjell në vëmendjen tuaj disa konstatime të përgjithshme
22 lidhur me provat që janë parashtruar.

23 Gjithashtu do të bëj komentin e përgjithshëm që kjo
24 çështje është e spikatur nga mungesa e nëpunësve të ZPS-së që
25 kanë luajtur rol të drejtpërdrejtë në të tria operacionet e

1 sekuestrimit si dhe në diskutimet që kanë ndodhur në kuadër të
2 çështjes.

3 Megjithatë, duke trajtuar pikë së pari z. Moberg. Siç e
4 bëri të qartë gjatë ndërveprimeve në të cilat ka marrë pjesë
5 një oficer i mëparshëm, që në dëshminë e tij u përmend si
6 dëshmitari X i cili ka qenë i pranishëm, ka qenë përgjegjës
7 për sekuestrimin dhe fliste shqip, z. Moberg na tha në dëshmi
8 përpara Gjykatës që ai nuk ishte në gjendje që të kuptonte se
9 cili ishte diskutimi, sepse nuk kishte pasur përkthim të
10 disponueshëm në gjuhën shqipe për të. Besoj se e mbani mend që
11 ai e kishte të vështirë që të bënte dallimin ndërmjet
12 ngjarjeve që kishin ndodhur në datën 17 dhe 22 shtator. Dhe në
13 përgjithësi ai ishte, ose u duk si një dëshmitar i konfuzuar.
14 Megjithatë, pavarësisht kësaj ai ishte i qartë lidhur me një
15 pikë dhe e kam fjalën këtu për përdorimin e qeseve të provave
16 materiale dhe zinxhirin e ruajtjes.

17 Z. Berisha. Z. Berisha është një gazetar i cili ka botuar
18 dokumente, që sipas tij, ishin në interes të publikut dhe
19 gjatë botimit të këtyre materialeve ai ka të njëjtin *actus*
20 *reus* dhe *mens rea* siç edhe z. Haradinaj dhe në fakt nuk u
21 kritikua fare nga ZPS-ja. Përkundrazi, u mbështet nga ZPS-ja.
22 Ai e bëri të qartë që veprimet e veta nuk përlligjnin ndjekjen
23 penale. Sigurisht kjo është një arsye për shqetësim.

24 Znj. Zdenka Pumper. Në mënyrë të ngjashme siç edhe z.
25 Jukiç, në rastin e saj nuk u dhanë prova se si incidenti në

1 diskutim ka penguar ushtrimin e detyrës zyrtare apo ka penguar
2 kryerjen e fakteve dhe detyrave të tjera. Në fakt, znj. Pumper
3 konfirmoi që ajo ishte e angazhuar në hetimet e tilla dhe në
4 rastin konkret ajo kishte vetëm rolin e kufizuar të marrjes së
5 dokumenteve, pra ishte e përfshirë vetëm në procesin e marrjes
6 së dokumenteve.

7 Dëshmia e saj, siç e kemi dëgjuar dhe pak më parë nga z.
8 Rees, kishte plot pranime të cilat flisnin që nuk ishin bërë
9 kontrole sa i takon informacionit, në qoftë se ky informacion
10 kishte të bënte me persona që ishin të pranishëm në fushën
11 publike dhe në qoftë se këto dokumentacione ishin sekuestruar
12 nga ZPS-ja. Ajo dukej sikur sugjeronte që procesi i
13 vlerësimit, sa i takon vartësisë së dokumenteve siç e tha edhe
14 z. Rees, kishte filluar por kishte përfunduar përpara se sa të
15 ishte plotësuar, të kishte qenë i plotë.

16 Në dosjen tonë ne merremi me detaje të dhëna nga z.
17 Jukiç. Dhe parashtrojmë që e gjithë dëshmia e tij nuk ka
18 besueshmëri, pra dëshmisë së tij i mungon besueshmëria.
19 Gjithashtu duam të sjellim në vëmendjen tuaj keqkuptimin e
20 zyrës së ZPS-së në Prishtinë. Dhe ajo çfarë unë nuk kuptoj nga
21 ZPS-ja ishte që nuk kishte ZPS-ja zyrë në Prishtinë, një zyrë
22 të përhershme në Prishtinë. Dhe nuk është e qartë se pse ai do
23 të bënte një gabim të tillë në dëshminë e tij dhe ne
24 parashtrojmë që dëshmia e tij nuk është e besueshme.

25 Z. Rees ka parashtruar më tej përmes shumë provave dhe

1 unë nuk dua që t'i cek edhe një herë këto prova, por thjesht
2 plotësisht mbështes atë çfarë ka thënë z. Rees dje.

3 Lidhur me çështjen e Prokurorisë, nuk ka shumë që unë
4 mund të them përveç asaj çfarë kam parashtruar në dosjen
5 përfundimtare të gjykimit. Siç e dini të nderuar Gjykatës,
6 thelbi i çështjes së Prokurorisë është që dokumentacioni
7 konfidencial përfundoi në zyrat e OVL UÇK-së, që ky material
8 pas tre konferencave për shtyp iu vu në dispozicion anëtarëve
9 të medias dhe se kjo nxjerrje dhe kjo sjellje prej të
10 akuzuarve çon në legjitimimin e 6 pikave të aktakuzës.

11 Siç e kam thënë dhe më parë dhe siç është bërë e qartë
12 dhe nga z. Rees, Prokuroria ka barrën e provës, të provimit të
13 secilës prej pikave dhe të secilit prej elementëve të veprave
14 penale të akuzuar dhe këtë gjë duhet ta bëjë përtej dyshimit
15 të arsyeshëm.

16 Duke tërhequr vëmendjen e Gjykatës, në përmbledhje për
17 pikat e mëposhtme. Në qoftë se do shikojmë pikat 1 dhe 2
18 mbështetur në aktakuzë, nuk ka prova të përdorimit të forcës
19 apo të kanosjes serioze. Nuk ka as ankesa të zyrtarëve publikë
20 që kanë të bëjnë me këto akte. ZPS-ja të hënën e kritikoi
21 Mbrojtjen e z. Haradinaj dhe tha që parashtrimi i saj ishte
22 përzgjedhës. Në fakt, është e vërtetë që nuk ka prova të cilat
23 flasin për kanosjen serioze apo për përdorimin e forcës ndaj
24 zyrtarëve në ushtrimin dhe kryerjen e detyrave të tyre
25 zyrtare. Dhe këtë në fakt e kemi parashtruar dhe në dosjen

1 përfundimtare të gjykimit.

2 Sa i takon pikës 3. Nuk ka prova as për veprime, për
3 përdorim force dhe kanosje serioze ndaj zyrtarëve publik.

4 Pika 4. Nuk ka asnjë bazë që tregon probleme apo nuk
5 tregon hakmarrje nga ana e z. Haradinaj, siç pretendohet nga
6 Prokuroria. Jo vetëm kaq, por një pjesë e rëndësishme e kësaj
7 veprë është që çdo informacion që është ofruar, është
8 identifikuar duke ofruar informacion të vërtetë lidhur me
9 kryerjen e mundur të një krimi. Z. Rees na dha shpjegime
10 lidhur me këtë pikë. Nuk është identifikuar asnjë dëshmitar në
11 këto procese gjyqësore që është provuar që ka dhënë dëshmi të
12 vërteta përpara Gjykatës, në këtë çështje.

13 Lidhur me pikën 5. Nuk ka absolutisht asnjë provë që
14 vërteton që dokumentet ishin të fshehta, ishin sekrete. Z.
15 Rees e tha sot paradite që këto dokumente të bëra publike nga
16 gazetarët, ishin dokumente në të cilat nuk kishte asnjë shënim
17 që ishin dokumente konfidenciale. Ne parashtrojmë se është e
18 pamjaftueshme dhe është në veçanti shumë problematike për
19 Mbrojtjen që ajo nuk i ka parë këto dokumente.

20 Lidhur me pikën 6. Një element shumë i rëndësishëm i
21 veprës është që një person ishte në atë kohë në mbrojtje.
22 Ndërkohë që nuk është parashtuar asnjë provë e cila e
23 përmbush këtë element. Sa i takon synimit, përderisa z.
24 Haradinaj gjithmonë ka vepruar në interes të publikut, nuk
25 mund të thuhet që ai kishte synimin për të kryer të gjitha

1 këto vepra.

2 Ju kërkoj ndjesë sepse kam veshur kostum, kam edhe
3 pelerinën e mbrojtjes dhe ndoshta nuk ishte veshja e duhur për
4 sot. Kam pak nevojë për hidratim.

5 Një prej elementëve kryesor të çështjes së Mbrojtjes
6 është elementi i standardeve hetimore dhe hetimi në vetvete ka
7 mangësi të mëdha.

8 Duke parë pikësëpari rrjedhjen e informacionit. ZPS-ja në
9 mënyrë të vazhdueshme ka thënë që, si procesi në të cilin
10 dokumentet kanë përfunduar në zyrat e OVL UÇK-së ashtu dhe
11 mënyra e marrjes së tyre, nuk janë me rëndësi. Ne themi që kjo
12 është absolutisht shumë e rëndësishme dhe është një ndër
13 elementët bazë apo themelorë të kësaj çështje.

14 Lidhur me faktin që ZPS-ja ka sugjeruar se këto
15 pretendime janë bërë në një fazë të vonshme, thjesht sa për të
16 konfirmuar siç ka konfirmuar dhe z. Rees lidhur me një tjetër
17 çështje, me çështjen që ka të bëjë me shtytjen në veprën
18 penale, dua të them që ky është një element thelbësor të cilin
19 ne e kemi nxjerrë në pah, e kemi bërë të ditur që në fillim.

20 Më tej, dhe disi habitshëm, ZPS-ja gjithashtu ka kërkuar
21 që të mbajë pozicionin që hetimet në rrethanat përtej
22 rrjedhjes së informacionit dhe hetimet që kanë të bëjnë me
23 sjelljen e pretenduar të z. Haradinaj, nuk janë të
24 rëndësishme. Sërish hetimet ose mungesa e hetimeve të cilat
25 janë ndërmarrë nga ZPS-ja, janë të lidhura me aktakuzën dhe

1 janë të lidhura gjithashtu dhe me akuzat për të cilat akuzohet
2 z. Haradinaj.

3 Duke trajtuar rrjedhën e informacionit në vetvete dhe nuk
4 dua që ta kaloj dhe një herë materialin që përmendi z. Rees
5 sot në mëngjes, gjithsesi dua të them që ZPS-ja në të gjithë
6 këto procedura ka refuzuar që të nxjerrë detajet e hetimit të
7 vet që kanë të bëjnë me rrjedhjen e informacionit. Dhe këtu
8 përfshihen kërkesat e vazhdueshme që i janë drejtuar Trupit
9 Gjykues dhe fakti që ne nuk kemi dëgjuar asnjë person që të
10 dëshmojë lidhur me këto rrjedhje dhe kush është përgjegjës për
11 to. ZPS-ja ka akuzuar në veçanti Mbrojtjen e z. Haradinaj që
12 kërkon që të rikontestojë çështje të cilat janë ngritur gjatë
13 procedurave dhe që janë rrëzuar nga Trupi Gjykues. Ato janë
14 ngritur si çështje të cilat janë aspekte themelore të kësaj
15 çështje, janë aspekte themelore të cilat kanë të bëjnë me
16 gjykimin e arsyeshëm dhe procesin gjyqësor të drejtë për z.
17 Haradinaj.

18 Ajo çfarë është e qartë është se: Pas rrjedhjes së
19 informacionit, ZPS-ja nuk ka ndërmarrë asnjë hap të kuptimtë
20 parandalues dhe me sa dimë ne, nuk ka bërë asnjë lloj
21 mbikëqyrje, pavarësisht që ishte e qartë që mund të ndodhte
22 një dërgesë e dytë dhe një dërgesë e tretë në zyrat e OVL UÇK-
23 së. Besoj se i mbani mend dëshmitë që persona ose personat
24 misteriozë i kishin materialet duke e bërë të qartë që do të
25 ktheheshin me më shumë materiale të tjera. Siç e tha më

1 përpara z. Rees, znj. Pumper ka thënë që sipas mendimit të saj
2 do të kishte qenë një strategji e mirë që të sigurohej
3 mbikëqyrja e ambienteve. Por se kjo nuk kishte qenë
4 vendimmarrja e saj.

5 Përsëri duket, siç edhe më lart, që nuk ishte ndërmarrë
6 asnjë hap në mënyrë që të zbulohet se kush kishte qenë shoferi
7 i makinës së përdorur. Nuk ishin ndërmarrë hapa për të
8 siguruar dhe për të sekuestruar shumë regjistrime, incizime të
9 cilat ishin bërë nga kamerat në zonën përreth. Këto çështje
10 unë i kam ngritur edhe me znj. Pumper gjatë marrjes së saj në
11 pyetje prej Mbrojtjes, që ka shumë prona në anën tjetër të
12 rrugës nga OVL UÇK-ja dhe e pyeta atë nëse ishin bërë kërkesa
13 që të sigurohej incizimi në video nga këto objekte ose në
14 qoftë se ishte pyetur ndonjë dëshmitar lidhur me lënien e
15 dokumenteve në OVL e UÇK-së. Dhe përgjigja për këto pyetje
16 ishte, "jo".

17 Në mënyrë të tejskajshme, duke mos marrë në pyetje as
18 personat që kishin qenë të pranishëm në OVL e UÇK-së në kohën
19 e kryerjes së dorëzimit të materialeve. Në asnjë moment.
20 Kështu që bëhet legjitime pyetja se, pse nuk është ndërmarrë
21 asnjë hap nga ZPS-ja lidhur me këto elementë. Duket ekstrem që
22 ajo çfarë ka bërë ZPS-ja është që të ndalojë Mbrojtjen nga
23 hetimet dhe gjithashtu është tregues, sipas mendimit tonë të
24 paktën, që kemi të bëjmë me një situatë të dështimit të plotë
25 hetimor të ZPS-së në të gjithë këtë proces.

1 Ajo çfarë ia vlen që të shqyrtohet gjithsesi është
2 mungesa e plotë e respektimit të standardeve hetimore në të
3 gjithë procesin e ZPS-së, që përbëjnë dhe bazën e kësaj
4 çështje dhe ky element ka marrë edhe më shumë rëndësi në
5 kuadrin e pyetjes së Gjyqtarit Gaynor që ka të bëjë me
6 parashikimet e Rregullës 39(4).

7 Ajo çfarë ne kuptojmë, që duket sikur ngre Gjykatësi
8 Gaynor, është që nuk është bërë asnjë inventar siç kërkohet
9 nga ky rregull i rregullores. Dhe madje ky është një pozicion
10 që dhe vetë z. Halling duket sikur e pranon, nga mënyra se si
11 i është përgjigjur pyetjes.

12 Pra, jo vetëm që nuk është bërë asnjë lloj inventari në
13 atë kohë, e kam fjalën këtu për kohën e sekuestrimit, por nuk
14 është bërë inventar as më vonë dhe nuk është bërë asnjë lloj
15 konfirmimi i tij as me të pandehurit, as me persona të tjerë
16 që janë pjesë e OVL UÇK-së. Siç e rikujtoni, z. Rees tha që
17 duhet që të ishin dhënë arsyet në qoftë se nuk ishin pasur
18 arsye që pse të bëhej një inventar në atë kohë dhe këtë gjë
19 duhet ta kishin bërë nga ZPS-ja. Ne parashtrojmë që nuk ka një
20 arsye se pse të mos ishte përgatitur një inventar në atë kohë.
21 Dhe përsëri, deri në masën sa i takon kundërshtimit që ka ZPS-
22 ja për kohën e ngritjes së një shqetësimi të tillë, së pari
23 duam që të parashtrojmë që kjo është një temë apo element
24 qendror i Mbrojtjes së z. Haradinaj që në fillim të këtij
25 procesi. Por, edhe anëtarët e Trupit Gjykses kanë të drejtën e

1 diskrecionit që të ngrenë pika të reja, në qoftë se këto pika
2 janë pjesë e juridiksionit në vetvete.

3 Ndërkohë, rregulla 39(4) thjesht reflekton standardet
4 ndërkombëtare për hetimet dhe Gjykatësit kanë juridiksionin e
5 vet për sa i takon përjashtimit të provave që mbështeten në
6 mosrealizimin e parimit themelor që ka të bëjë me zinxhirin e
7 ruajtjes dhe ne e kemi pretenduar këtë gjë që prej fillimit.
8 Ne mbajmë pozicionin që elementi i zinxhirit të ruajtjes është
9 një element shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i çdo
10 çështjeje të Prokurorisë. Prokuroria ka dhënë prova që kanë të
11 bëjnë me sekuestrimin e të tri paketave, në procesin e
12 transferimit të këtyre provave në ZPS në Hagë dhe procesit të
13 verifikimit që ka bërë znj. Pumper. Por, çfarë nuk ka bërë
14 ZPS-ja është dokumentacion që mbështetet nga dëshmi që
15 vërtetojnë që ka pasur një zinxhir të plotë të pathyer, të
16 paprekshëm të ruajtjes së dokumentacioneve. Ne mendojmë se ky
17 është një element shumë i rëndësishëm, është një problem
18 thelbësor në çështjen e tyre.

19 Ishte e qartë që ZPS-së iu desh që të kërkonte dëshmitarë
20 shtesë dhe në këtë moment ata vendosën që të paraqesin z.
21 Moberg, i cili nuk i mbante mend mirë ngjarjet siç kishin
22 ndodhur, që nuk është hetues dhe që në fakt nuk ishte nëpunësi
23 që kishte realizuar sekuestrimet e dokumenteve nga Paketa 2
24 dhe nga Paketa 3.

25 Sa i takon dokumentacionit në Paketën 1, dokumentet e

1 marra nga kjo paketë, neve parashtrojmë që sekuestrimi ishte i
2 paplotë. I vetmi informacion që ne kemi është që dokumentet i
3 janë dërguar OVL UÇK-së dhe kemi një përshkrim të një grupi
4 dokumentesh të cilat janë printuar.

5 Për këtë mund të shohim provën materiale P3336 [sipas
6 përkthimit] dhe është dëshmia e znj. Pumper më 20 tetor, faqja
7 e transkriptit T1052, rreshtat 17 deri 23.

8 Përsëri, dokumenti i fletëdorëzimit nuk përmban asnjë
9 informacion për numrin e faqeve, sa e madhe ishte pakoja e
10 dokumenteve apo se çfarë përmbajtje kishin ato dhe nuk
11 përmendet asnjë gjë në lidhje me qesen e provave. Dhe nuk
12 është paraqitur si provë asnjë qese për mbajtjen e provave.
13 Nuk është e qartë se për çfarë kohe, kush i ka pasur në
14 ruajtje dokumentet pasi i kanë marrë nga zyra e OVL UÇK-së dhe
15 i kanë çuar në zyrën e ZPS-së në Prishtinë dhe pastaj në Hagë.

16 Përsëri, edhe për Paketën e dytë zinxhiri i mbajtjes në
17 ruajtje është përsëri i mangët, nuk kemi një inventar të
18 dokumenteve që janë konfiskuar.

19 Paketa e tretë. Nuk ka prova për sa i përket Paketës së
20 tretë që të jenë marrë dokumentet dhe të jenë futur në qese
21 provash dhe të jenë vulosur. Nuk është regjistruar, nuk ka një
22 dokumentacion se çfarë provash janë vendosur ku dhe kur. Pra,
23 nga pikëpamja hetimore, kjo është e mangët.

24 Pra, zinxhiri i ruajtjes së dokumenteve është i mangët.
25 Inventari nuk u bë. Nuk mund të themi me siguri se çfarë

1 dokumentesh janë marrë, çfarë është marrë dhe është dërguar në
2 zyrën e ZPS-së. Nuk dimë se sa persona i kanë parë dokumentet
3 që janë konfiskuar. Nuk e dimë nëse janë bërë kopje të
4 dokumenteve që mbaheshin nga ZPS-ja, sepse nuk është bërë
5 krahasim i të dyjave. Dhe nuk mund të jemi të sigurt nëse janë
6 vendosur në qese provash, janë vulosur ato qese provash dhe në
7 qoftë se po, kur.

8 Trupit Gjykues i kërkohet nga Prokuroria që të pranojë
9 një pozicion mbi bazën e asaj që thjesht e ka thënë
10 Prokuroria, jo sepse ka prova për mbështetjen e asaj që thotë
11 Prokuroria. Kjo, me respekt, nuk është aspak e mjaftueshme për
12 të vërtetuar që nuk është ndërhyrë në provat, për të shmangur
13 dyshimin e arsyeshëm.

14 Pra, e tërë çështja e ZPS-së është kaq e mangët sa që
15 duhet të hidhet poshtë.

16 Interesi publik ka qenë një tipar kryesor i Mbrojtjes së
17 Haradinajt dhe të Guçatit që nga fillimi i këtyre procedurave.
18 Bazuar në prova, ka qenë gjithmonë e qartë që z. Haradinaj ka
19 vepruar gjithmonë në interes të publikut dhe kjo ka qenë forca
20 shtytëse e veprimeve të tij. Unë kam dhënë disa nga provat
21 kyçe që kanë të bëjnë me interesin publik gjatë këtij gjykimi,
22 që janë paraqitur edhe në dosjen tonë përfundimtare. Dhe
23 sidomos nën dritën e parashtrimeve të gjerësishme të z. Rees
24 gjatë një dite e gjysmë të kaluar, do të them që kur të
25 shqyrtohet tërësia e provave, që siç e dimë do ta bëjë Trupi

1 Gjykues, është e qartë që z. Haradinaj ka vepruar gjithmonë në
2 interesin publik dhe ky ka qenë parimi që e ka udhëzuar atë
3 tërë kohën. Është e qartë që ai veproi në një mënyrë që është
4 e krahasueshme, madje edhe më pak se sa z. Berisha dhe nuk e
5 kuptojmë se pse është z. Haradinaj këtu sot dhe z. Gucati, pse
6 janë ata të dy këtu sot. Kjo nuk është një çështje ku z.
7 Haradinaj ka bërë veprime për ta rrëzuar këtë institucion, siç
8 thotë Prokuroria. Kjo është e gabuar dhe ne e mohojmë
9 fuqimisht po kështu. Siç kemi dëgjuar në lidhje me z. Berisha,
10 është e qartë që ka pasur një interes të fuqishëm publik për
11 nxjerrjen e këtyre dokumenteve. Kjo në vetvete është e
12 mjaftueshme për ta hedhur poshtë pretendimin e tyre dhe duhet
13 të çojë në përfundim të këtij gjykimi, me kaq të mbyllet.

14 Ne dëgjuam sot në mëngjes dhe do ta përmend shumë
15 shkurtimisht, nenin 200(2) dhe 200(4) të Kodit Penal të
16 Kosovës.

17 Referenca e parë. Një person nuk ka përgjegjësi penale në
18 qoftë se ai nxjerr informacion konfidencial në interesin
19 publik, në qoftë se ky interes është më i madh se interesat e
20 mosnxjerrjes së informacionit konfidencial.

21 Përkufizimi i interesit publik është në paragrafin 4 të
22 këtij neni që do të thotë, është në të mirë të publikut të
23 gjerë dhe ky interes i publikut të gjerë e tejkalon, është më
24 i madh se sa interesi individual.

25 Dhe nxjerrja e informacionit konfidencial është në

1 interes publik në qoftë se ka të bëjë me plane, përgatitje dhe
2 kryerjen e krimeve kundër rendit kushtetues të Kosovës dhe
3 integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Si dhe
4 krime të tjera që shkaktojnë lëndimin trupor të një personi
5 tjetër.

6 Koncepti që, nxjerrja e dokumenteve konfidenciale është
7 në interesin publik, është më e rëndësishme se interesi i
8 mosnxjerrjes, mund të gjendet edhe në nenin 22 të Kushtetutës
9 dhe aty jepet një listë e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe
10 instrumenteve ndërkombëtare që garantohen në kushtetutë.

11 Neni 40 i Kushtetutës përmend të drejtën e shprehjes së
12 lirë, shprehjen e mendimeve dhe për marrjen e informacioneve
13 pa pengesë, pa u penguar.

14 Mund t'i kthehem interesit publik pas pushimit të drekës.

15 Shtytja për kryerjen e veprës penale është ngritur si
16 aspekt i Mbrojtjes që në fillim të këtyre procedurave
17 gjyqësore. Aty ku vendoset shtytja apo nxitja, ajo çon, ashtu
18 siç e identifikoi Gjykatësi Mettraux, mund të çojë në një
19 ndalim të përhershëm të procedurave. Kuptohet që në
20 juridiksione të ndryshme, ky mjet ligjor zbatohet në mënyra të
21 ndryshme. Por kur ndodh një shkelje e nenit 6 [sipas
22 përkthimit] të KEDNJ-së, kur merren prova përmes nxitjes dhe
23 kur i akuzuari nuk është në gjendje të ngrejë një çështje
24 gjatë gjykimit. Pra, kjo është shkelje. Ne themi që nuk ka
25 ndryshim midis pozicionit material të Mbrojtjes siç është

1 sugjeruar më herët dhe ne si palë, palët faktikisht, po themi
2 të njëjtën gjë.

3 Unë po them tani këtu për lehtësi, që ne pajtohemi me atë
4 çka tha z. Rees në lidhje me shtytjen për kryerje të veprës
5 penale dhe atë që kemi në dosjen tonë përfundimtare.
6 Megjithatë, ne kemi argumentin që aspekti procedural i
7 shtytjes për kryerje të veprës penale apo nxitjes nga policia,
8 është shkelur sepse Mbrojtja e Haradinajt nuk është lejuar që
9 të ngrejë këtë argument.

10 Për sa i përket anës substantivë materiale, unë
11 kundërshtoj pretendimin e z. Halling që këtu po ngatërrohen
12 aspektet e çështjes, por miratoj dhe pajtohem me atë që tha z.
13 Rees.

14 Në përputhje me çështjen Edwards dhe Lewis ndaj
15 Mbretërisë së Bashkuar, këtë e kemi dorëzuar si rast precedent
16 F00404. Pra, në qoftë se Trupi Gjykses ka parë dokumentacion
17 të caktuar, i njëjti dokumentacion duhet t'i tregohet edhe
18 Mbrojtjes, në mënyrë që të jetë në përputhje me nenin 6 të
19 KEDNJ-së.

20 Ne nuk e kemi të qartë se çfarë ka parë Trupi Gjykses në
21 këtë rast, por ne kemi kërkuar nxjerrjen e këtyre materialeve
22 mbi këto baza, në mënyrë që të parashtronim argumentin tonë në
23 lidhje me shtytje për kryerje të veprës penale. Z. Rees ka
24 folur gjatë e gjerë për këtë. Ne i përmbahemi pozicionit që
25 kemi trajtuar në dosjen tonë përfundimtare dhe nuk do ta

1 trajtojmë më tej këtë çështje.

2 Për sa i përket gabimit ligjor. Dje, z. Rees tregoi
3 prova të ndryshme nga konferencat e shtypit që tregojnë që, si
4 z. Gucati dhe z. Haradinaj besonin që po vepronin në përputhje
5 me ligjin. Mbrojtja e mbështet këtë argument. Dhe kjo ka qenë
6 vazhdimisht tema apo filli që e ka përshkruar dëshminë që dha
7 z. Haradinaj edhe deklarata e tij që, ai ka vepruar në mënyrë
8 të ligjshme dhe këtë besonte.

9 Ndoshta mbas pushimit të drekës mund t'ju jap edhe
10 referencat ku z. Haradinaj ka paraqitur pozicionin e vet, por
11 në këtë fazë i kërkoj Trupit Gjykues që të lexojë të gjithë
12 tërësinë e dëshmive dhe deklaratave të z. Haradinaj, që jam i
13 bindur që do ta bëni, që të shikoni në mënyrë të qartë se mbi
14 çfarë bazash po vepronte ai.

15 Të nderuar Gjykatës, e shikoj se sa është ora dhe do të
16 mundohem që të flas sa më shkurt që të jetë e mundur. Por ka
17 disa gjëra që duhet t'i them, dua t'i trajtoj pavarësisht se
18 janë në dosjen përfundimtare.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ne do
20 të vazhdojmë deri në orën 13.15. Desha t'ju kujtoj këtë.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, 13.15.

22 Për të parë ekzagjerimet që bën Prokuroria. Nuk dua t'i
23 trajtoj këto karakterizimet e këqija apo ekzagjerimet e
24 Prokurorisë. Është shumë e rëndësishme që Trupi Gjykues të
25 shohë provat në tërësi. Dhe është e rëndësishme që unë të bëj

1 disa vërejte në lidhje me ato që ka thënë Prokuroria, sepse
2 janë paraqitje të padrejta dhe të pasakta të asaj që ka thënë
3 z. Haradinaj. Kjo listë nuk është shteruese, por dua të them
4 disa nga më kryesoret.

5 Në paragrafin 1 në dosjen e Prokurorisë thuhet që:

6 "Pretendimet faktuale mbi të cilat janë bazuar akuzat,
7 nuk janë kundërshtuar sepse janë të pakundërshtueshme".

8 Kjo është e gabuar. Ndonëse z. Haradinaj nuk e ka
9 kundërshtuar atë që ka ndodhur në ato tre konferencat për
10 shtyp, arsyet bazë janë kundërshtuar. Po kështu Mbrojtja nuk
11 ka pasur qasje në të tre paketat për t'i shqyrtuar dhe është
12 krejt e papërshtatshme që të thuash që këto fakte nuk janë
13 kundërshtuar.

14 Mbrojtja nuk ka pasur mundësi të kundërshtojë pjesët
15 kryesore të provave. ZPS-ja po kështu në paragrafin 9 thotë
16 që:

17 "Vendimi i fajësisë nuk duhet të bazohet vetëm dhe në
18 mënyrë vendimtare në deklaratat e dëshmitarit të cilët
19 Mbrojtja nuk ka pasur mundësi t'i pyes".

20 ZPS-ja kërkon të krijojë një përshtypje se nuk ka asgjë
21 gabim me këto procedura gjyqësore dhe se ka vepruar në bazë të
22 një balancimi. Ne themi që kjo është shumë e pavërtetë. ZPS-ja
23 ka vazhduar të veprojë duke e ditur se provat kryesore nuk i
24 janë dhënë Mbrojtjes dhe çdo vendim fajësie duhet të bazohet
25 mbi dëshmi të dorës së dytë dhe të tretë. Sepse Mbrojtja nuk

1 ka pasur mundësi të bëj pyetje dhe nuk ka pasur mundësi t'i
2 shikojë dokumentet mbi të cilat bazohet Prokuroria.

3 Paragrafi 21:

4 "Që nga krijimi i DHSK-së, OVL UÇK-ja e ka kundërshtuar
5 DHSK-në dhe mandatin e saj dhe ata kanë dashur t'i japin fund
6 mandatit apo ta amendojnë mandatin e DHSK-së dhe ZPS-së".

7 Këto janë në paragrafin 176, 179 dhe 180 të dosjes së
8 tyre.

9 Përsëri, kjo është keq =përfaqësim i pozicionit të z.
10 Haradinaj. Ai kishte shqetësime për ZPS-në dhe mënyrën se si
11 vepronte ajo dhe mendonte që këto nxjerrje të këtyre
12 materialeve ishin në interes të publikut. Ai e ka thënë disa
13 herë gjatë dëshmisë së tij që ai është në favor të drejtësisë
14 dhe ai po kërkon që ky proces të bëhet i drejtë dhe që
15 drejtësia të vendoset në mënyrë të barabartë. Në faqen e
16 transkriptit 2844 të 12 janarit, rreshtat 19 deri në 25; në
17 faqen 2865, rreshtat 11 deri në 17; në faqen 2874, rreshtat 12
18 deri në 17, e bëjnë më se të qartë këtë pozicion të tij.

19 Në momente të ndryshme në dosjen përfundimtare të ZPS-së,
20 në paragrafët 29, 56, 59 dhe 68, ZPS-ja përpiket të thotë se
21 z. Haradinaj i ka parë dokumentet për kohë të gjatë, bile edhe
22 i ka studiuar. Kjo nuk pranohet nga ne dhe është në
23 kundërshtim me atë që dëshmoi z. Haradinaj gjatë gjykimit.
24 Këto janë në faqen e transkriptit T3003, rreshtat 12 deri në
25 21; 3004, rreshtat 6 deri në 13.

1 Ai dëshmoi se nuk flet anglisht, nuk lexon anglisht dhe
2 vetëm thjesht i ka hedhur një sy dokumenteve. ZPS-ja përpigjet
3 të krijojë përshtypjen se ai u kujdes që t'i shikonte këto
4 dokumente në hollësi. Dhe përsëri kjo është e gabuar dhe
5 çorientuese.

6 Në paragrafin 71, ZPS-ja mundohet të thotë që hapat
7 hetimore që ka marrë ajo nuk kanë defekte. Ky është një
8 ekzagjerim duke pasur parasysh atë që është parë këtu gjatë
9 gjykimit dhe asaj që shihet në dosjen përfundimtare.

10 Ne konsiderojmë që standardet e zbatuara ishin të dobëta
11 dhe të pamjaftueshme.

12 Po kështu, z. Haradinaj e tha shumë qartë se ZPS-ja nuk u
13 kujdes fare për dokumentet e veta, nuk erdhi për t'i marrë dhe
14 kur i morën, i morën pa iu kushtuar atyre rëndësinë e duhur.
15 Kjo është në faqen e transkriptit 2783 [sipas përkthimit],
16 rreshtat 3 deri në 15; 2790, rreshti 4 deri në 8.

17 Dhe z. Haradinaj kërkoi që të mbrohej apo të ruhej
18 ndërtesa në mënyrë që të identifikohet se cili person po vinte
19 për t'i sjellë ato dokumente. Këto janë në faqen e
20 transkriptit 2773, rreshti 8 deri në 16.

21 Në dosjen e saj përfundimtare, po i hedh një sy
22 paragrafit 87, ZPS-ja përpigjet ta paraqesë z. Haradinaj si një
23 person i cili dëshiron të sulmojë viktimat duke përdorur fjalë
24 si, "spiun". Gjykata nuk duhet ta pranojë këtë parashtrim të
25 ZPS-së dhe t'i shohë gjërat në kontekstin e plotë, pasi z.

1 Haradinaj në dëshminë e tij ka qenë i qartë kur ka thënë që
2 nuk duhen përmendur emra. Ato që ka përmendur, i referohem
3 dallimit që bëri z. Rees midis emrave publikë dhe emrave
4 privat[, të vetmit persona të cilët z. Haradinaj ka kërkuar që
5 të përmendeshin, ishin zyrtarët që ai mendonte që kanë marrë
6 pjesë apo ishin përgjegjës për krime në Kosovë gjatë kohës së
7 konfliktit, zyrtarët serb dhe zyrtarët kosovarë serb të cilët
8 ai mendonte që duhet të dilnin përpara drejtësisë. Atyre po i
9 referohej ai, siç e thotë edhe vetë dhe e shohim këtë në
10 transkriptin 2737, rreshtat 19 deri në 21; 2751, rreshtat 18
11 deri në 24; 2752, rreshtat 14 deri në 25; 2775, rreshtat 19
12 deri në 25; 2776, rreshtat 1 deri në 3; 2784, rreshti 4 deri
13 në 18.

14 Dhe sa herë që është përmendur fjala "spiun" apo "spiun
15 të regjimit jugosllav", kjo ishte ajo të cilëve i është
16 referuar ai.

17 Në paragrafët 136 deri në 41 [sipas përkthimit] të dosjes
18 së saj, ZPS-ja paraqet se dëshmitarët e saj janë të besueshëm.
19 Në paragrafin 137 dhe 140, ZPS-ja thotë që dëshmitarët e saj
20 janë me eksperiencë të madhe të besueshme. Siç e kemi
21 parashtruar në dosjen tonë përfundimtare dhe siç e ka
22 përmendur z. Rees gjatë ditës së djeshme dhe gjysmës së sotme,
23 ky nuk është një qëndrim të cilin e pranojmë apo me të cilin
24 jemi dakord.

25 Në dosjen tonë ne kemi paraqitur shqetësime reale lidhur

1 me besueshmërinë dhe bazueshmerinë e dëshmitarëve që janë
2 thirrur për të dhënë dëshmi.

3 Në paragrafin 142 ZPS-ja thotë që i akuzuari ka përdorur
4 dëshminë për të avancuar agjendën e tij kundër DHSK-së, i cili
5 ka motivuar dhe sjelljen e tij penale. Kjo nuk është e
6 vërtetë. Z. Haradinaj në dëshminë e tij ka qenë i qartë kur ka
7 thënë që ka probleme me DHSK-në, por mesazhi i tij kryesor
8 ishte se nuk ishte kundër drejtësisë në qoftë se kjo drejtësi
9 administrohej për të tërë. Kjo është në transkriptin në faqen
10 2844, rreshti 19 deri në 25; 2865, rreshtat 11 deri në 17;
11 2874, rreshtat 12 deri në 17.

12 Dhe arsyeja për nxjerrjen që e ka bërë, ishte se mendon
13 se ishte në interes të publikut.

14 Në paragrafin 145 të dosjes së saj, ZPS-ja thotë që duhet
15 të tregohet kujdes sa herë që i akuzuari përpigjet të
16 distancohet nga deklaratat e tij publike. Z. Haradinaj nuk
17 është përpjekur që të distancohet nga deklaratat e tij
18 publike. Ai në fakt, sipas nesh, e ka shpjeguar qëndrimin e
19 tij, motivet dhe ka shpjeguar se çfarë ka bërë në atë kohë.

20 Në paragrafin 146 ZPS-ja thotë që z. Haradinaj nuk ka
21 treguar ndonjë pendesë për sa i përket nxjerrjes së
22 materialeve konfidenciale. Kjo është në kundërshtim dhe është
23 një keqpërfaqësim i asaj që ka thënë z. Haradinaj. Ai ka thënë
24 që është në favor të drejtësisë. Motivacioni i tij ka qenë
25 gjithnjë që t'i shërbente interesit të publikut.

1 Në paragrafët 166 deri në 169 të dosjes së tyre, ZPS-ja u
2 ankua lidhur me ankesat që janë bërë gjatë gjithë gjyqit nga
3 Mbrojtja e Haradinajt. Nuk dua t'i jap ZPS-së besueshmëri më
4 të madhe se ata mendojnë, por është një çështje që dua ta
5 theksoj gjithsesi.

6 Një nga shqetësimet kryesore, siç kemi kuptuar, është siç
7 e shpjegoi Gjykatësi Gaynor gjatë pyetjeve që i bëri të hënën,
8 që këto pako nuk janë testuar në mënyrën e duhur nga Mbrojtja,
9 nuk ka pasur mundësi që të bëjë pyetje mbi to. Është e
10 pamundur që të bësh pyetje kur ne si avokatë nuk e kemi parë
11 përmbajtjen e këtyre dokumenteve. Janë të panjohura se për
12 çfarë flasin. Ka një numër kontradiktash në këto dokumente apo
13 në zinxhirin e ruajtjes, apo pyetje të cilat duhen bërë.

14 Duhet të mbajmë parasysh të nderuar Gjykatës, se në rast
15 të sigurisë kombëtare, kur bëhet fjalë për materiale të
16 ndjeshmërisë së lartë, mund të caktohen avokatë krejtësisht të
17 pavarur dhe nuk janë marrë masa balancuese në këtë drejtim.

18 Është e pamundur që të thuhet që dokumentet janë sekrete
19 apo konfidenciale për shkak se kështu thotë ZPS-ja dhe në këtë
20 mënyrë nuk ka mundësi për të bërë pyetje mbi këtë dokument.

21 Dhe kjo e privon Mbrojtjen nga mundësia për të bërë pyetje
22 lidhur me materialet apo për të bërë pyetje mbi materialet të
23 cilat janë përfshirë në këto dokumente të pa nxjerra.

24 Janë dhe nja dy çështje të tjera të nderuar Gjykatës, të
25 cilat do të dëshiroja t'i ngrija. Do të doja të përfundoja në

1 këtë pikë nëse më lejoni ju mua. Nuk besoj që do të më duhet
2 më shumë se 30 minuta, pas drekës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pas drekës ju
4 doni edhe 30 minuta të tjera?

5 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni të
7 vazhdoni apo?

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Po kërkoj tani nëse mund të
9 përfundoj. Janë nja dy çështje të cilat dua t'i kontrolloj
10 përpara se të përfundoj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.
12 Pezullojmë seancën dhe kthehemi në orën 14.30.

13 Pezullohet seanca.

14 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.08

15 --- Seanca rifillon në orën 14:30

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju
17 lutem.

18 Zoti Cadman, mund të vazhdoni.

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju jam mirënjohës për kohën shtesë
20 që më keni dhënë. Janë edhe nja dy çështje që dua të
21 përfundoj.

22 Pika e parë, dua ta bëj të qartë në qoftë se nuk e bëra
23 të qartë në parashtrimin e mëparshëm. Kur bëhet fjalë për z.
24 Berisha, nuk desha të sugjeroja që të thosha që ai të ketë
25 bërë ndonjë vepër penale. Ne e kuptojmë tërësisht pozicionin,

1 apo qëndrimin e z. Rees dhe të miratuar edhe nga ZPS-ja që z.
2 Berisha nuk ka bërë asnjë vepër penale. Pra asgjë që thashë më
3 parë nuk duhet të kuptohet ndryshe.

4 Doja të flisja mbi çështjet që ka ngritur Prokuroria
5 lidhur me sugjerimin mbi burimin apo origjinën e nxjerrjes së
6 materialeve.

7 Shkurtimisht, ky është qëndrimi ynë në përgjithësi. ZPS-
8 ja nuk ka thënë që të akuzuarit janë përgjegjës për këtë
9 nxjerrje. Mbrojtja i përmbahet qëndrimit të ZPS-së se nuk ka
10 pasur masat e duhur të sigurisë dhe nuk duhet të hidhen sytë
11 nga të akuzuarit për të parë se si i mbron dokumentet e veta
12 një institucion. Nëse e ka pasur këtë mundësi ZPS-ja, është e
13 debatueshme, pasi po ta kishte pasur nuk do të ishim këtu sot.

14 Prokuroria e ka lejuar materialin që të nxirret edhe deri
15 në këtë ditë nuk dihet se si ka ndodhur apo pse.

16 Nuk ekziston ndonjë shpjegim logjik lidhur me teorinë që
17 dikush e ka bërë këtë për të ndihmuar të akuzuarit apo të
18 akuzuarit potencialë. Ne themi e kundërta është e vërtetë,
19 sepse nëse kjo është bërë nga, apo në emër të të akuzuarve, po
20 të donin ata do të donin ta mbanin këtë sekret. Do të mbanin
21 sekret faktin që kanë pasur qasje në dokumentet e materialeve
22 të Prokurorisë dhe jo të vepronin siç veproi z. Haradinaj. Nuk
23 ka një interpretim tjetër, se përse dokumentet u dërguan te
24 OVL-ja dhe nuk u dërguan për të ndihmuar të akuzuarit.

25 Ato janë marrë ose nga ZPS-ja vetë për të diskretitur

1 OVL-në mbi bazën e kritikave që ata kanë bërë përpara
2 shtatorit 2020, për t'ua mbyllur gojën të gjithë atyre që e
3 kritikonin mandatin e tyre apo ndonjë individ apo agjenci
4 tjetër që nuk ju do të mirën të akuzuarve të UÇK-së.

5 E dyta, pika e dytë është që të gjitha dëshmitë tregojnë
6 që ZPS-ja nuk i ka ruajtur si duhet sistemet e saj të provave,
7 me qëllim që të mos ketë shkelje të tyre. Nuk po sugjeroj që
8 ka ndonjë provë për këtë por nuk ka interes më të madh për
9 publikun se sa të dalë e vërteta mbi këtë proces.

10 Zyra e Prokurorisë e ka hapur çështjen e saj duke thënë
11 që të akuzuarit kanë ndërmarrë një numër veprimesh. Ne e kemi
12 ngritur këtë çështje në dosjen tonë përfundimtare duke
13 përmendur një agjenci e cila mund të ketë pasur qasje
14 potenciale në sistemet e ZPS-së. Dhe po e përmbledh në këtë
15 mënyrë.

16 Nuk janë shfaqur prova para Trupit Gjykses për të
17 sugjeruar se ajo që ka ndodhur është si rezultat i hyrjes apo
18 i shkeljes së sistemit kompjuteristik të ZPS-së. Por po të
19 kishte ndodhur, do të ishte logjike të mendohej që kjo hyrje
20 në sistemin e menaxhimit të provave të ZPS-së do të bëhej nga
21 një agjenci shtetërore e sofistikuar. Prokuroria nuk i ka
22 paraqitur prova palës Mbrojtëse apo Trupit Gjykses për të
23 treguar që ky ishte si rezultat i ndërhyrjes së një shteti --
24 agjencie të zbulimit të një shteti, që ngre çështjen: cili
25 shtet mund të ketë pasur mundësinë teknike apo motivin për ta

1 bërë një gjë të tillë? Për ta dëmtuar palën Mbrojtëse?

2 Ajo që mund të thuhet me siguri është që konkluzioni nga
3 faktet është që një agjenci shtetërore mund të ketë qenë
4 përgjegjëse për këtë shkelje flagrante të sigurisë. Po e
5 përmend edhe një herë këtë çështje. Nuk po sugjeroj që
6 ekzistojnë dëshmi që të ketë ndodhur një gjë e tillë, pasi nuk
7 janë paraqitur dëshmi para Trupit Gjykues për burimin e kësaj
8 nxjerrjeje apo se si është hyrë në sistem.

9 Ata nuk ju kanë paraqitur juve, Gjykatësve, asnjë provë
10 për ta hedhur poshtë këtë konkluzion. Përse do ta mbajnë
11 sekret rezultatin e hetimeve Prokurorët? Mënyrën se si ka
12 ndodhur një gjë e tillë? Kush mund të ketë qenë përgjegjës? Ai
13 tregon që z. Haradinaj ka pasur arsye që të shqetësohej që
14 diçka nuk shkon në këtë proces.

15 Po e ngre këtë çështje vetëm për shkak se ZPS-ja në
16 deklaratën e saj ka thënë që ky është një pohim i çuditshëm, i
17 habitshëm. Por është detyra ime si avokat mbrojtës që të
18 nxjerr të vërtetën në emër të klientit tim dhe është objektivi
19 i tij që ta gjejë të vërtetën në këtë kontekst dhe nuk do të
20 bëj koment tjetër për sa i përket kësaj çështjeje.

21 Tani më takon mua që të përfundoj deklaratën time
22 mbyllëse në emër të z. Haradinaj duke ju referuar dosjes
23 përfundimtare dhe parashtrimeve të tjera dhe gjashtë akuzave,
24 apo pikave të akuzës, me të cilat është ngarkuar.

25 Sipas mendimit tim, për secilën prej pikave të aktakuzës

1 nuk është paraqitur -- janë paraqitur prova të pamjaftueshme
2 për të vërtetuar elementët e veprës penale dhe ne ju kërkojmë
3 juve, Trupit Gjykses, që t'i shikoni dëshmitë me tërësi dhe me
4 kujdes dhe të arrini në përfundimin se ai është i pafajshëm
5 për secilën prej pikave të aktakuzës.

6 Z. Haradinaj, siç e thashë që në fillim, ka besim të madh
7 në aftësinë tuaj për ta bërë një gjë të tillë dhe unë kam
8 besim të madh që ju do t'i trajtoni të gjitha dëshmitë që janë
9 paraqitur edhe nga Prokuroria edhe nga Mbrojtja në mënyrë të
10 barabartë dhe në mënyrë pasionante.

11 U falënderoj për kohën tuaj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Do të fillojmë tani me pyetjet nga Trupi Gjykses.
14 Fillojnë me Gjykatësin Barthe. Pyetjet mund të jenë për një të
15 palë, palën tjetër, apo të dyja.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
17 Smith.

18 Kam disa pyetje për juve, z. Smith [sipas përkthimit],
19 lidhur me krimet e frikësimit dhe të hakmarrjes.

20 Pyetja ime e parë është pse mendoni se neni 387 i Kodit
21 Penal të Kosovës nuk mund të bëhet duke pasur synimin
22 eventual. Cilat janë arsyet ligjore që ju mendoni një gjë të
23 tillë, siç e thatë sot në mëngjes, kryerësi duhet ta detyrojë
24 një person tjetër që të mos bëjë një deklaratë e kështu me
25 radhë. A është kjo në dispozitë?

1 Z. REES: [Përkthim] Neni kërkon forcën për të detyruar
2 dikë dhe parashtrimi im është që formulimi e bën të qartë që
3 duhet të ekzistojë një qëllim specifik i përdorimit të forcës
4 me qëllim që të detyrohet një person tjetër. Të detyrohet, pra
5 një person tjetër. Dhe unë them që këtu bëhet fjalë për një
6 qëllim specifik të drejtpërdrejtë dhe jo eventual. Pra duhet
7 të ekzistojë dija e pasojës së një veprimi që një person, për
8 shembull, të mos bëjë një deklaratë apo të bëjë një deklaratë
9 të plotë apo të rreme nuk është e mjaftueshme, sepse veprimet
10 tuaja nuk kanë qenë për qëllimin e detyrimit.

11 Pra, sipas mendimit tim, neni 387(1) kërkon një qëllim
12 specifik.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

14 Tani, neni 388 i Kodit Penal të Kosovës që ka të bëjë me
15 hakmarrjen. Thatë që këtu kërkohet hakmarrje për sa i përket
16 informacionit të vërtetë.

17 Z. REES: [Përkthim] Po. Kështu është.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe sipas mendimit tuaj, a
19 do të ishte e mundur të argumentohet që ndryshimi i formulimit
20 të të dy dispozitave, domethënë nga njëra anë t'i kërkohet një
21 personi që të mos bëjë diçka, sipas nenit 387 të krimit [sipas
22 përkthimit], me qëllim që të hakmerret, apo nenit 388 të Kodit
23 që lejon interpretim të ndryshëm të dispozitës që ka të bëjë
24 me synimin.

25 Z. REES: [Përkthim] Po të ishte formuluar Kodi Penal me

1 qasje standarde, po. Por nuk është e qartë, sipas mendimit
2 tonë, Kodi i shikon në mënyrë sistematike këto çështje. Ne
3 mendojmë që duhet të shikojmë formulimin e secilës vepër
4 penale dhe nuk ka mënyrë për të krahasuar qasjet e ndryshme,
5 pasi ato nuk janë sistematike.

6 Po t'i hedhim një sy formulimit, hakmarrja --

7 Neni 3881 përdor fjalën "me synimin që". Neni 387 e bën
8 të qartë që ekziston i njëjti synim, duke ju referuar një
9 veprimi për të sjellë një veprim tjetër, që tregon një synim
10 specifik.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe pyetja ime e fundit për
12 juve, z. Rees, na thatë sot në mëngjes që klienti juaj donte
13 të ekspozonte gamën e bashkëpunimit midis ZPS-së nga njëra anë
14 dhe Serbisë nga ana tjetër. A nuk është ky një nga synimet që
15 z. Gucati mund të ketë pasur dhe nga pikëpamja e drejtësisë
16 penale, pse të mos çojë kjo në konkluzionin që ky klienti juaj
17 ka vepruar me synim specifik për të frikësuar një person i
18 cili dëshironte të jepte dëshmi apo të hakmerrej ndaj
19 personave, të cilët kanë dhënë dëshmi, siç ka argumentuar
20 Prokuroria?

21 Z. REES: [Përkthim] Prokuroria e ka barrën e provës. Ata
22 duhet të provojnë që ka ekzistuar qëllimi specifik, nuk ka të
23 dhëna të drejtpërdrejta të një synimi që Prokuroria të mund të
24 provojë që z. Gucati e ka bërë këtë, e ka pranuar një gjë të
25 tillë.

1 Ata duhet të shikojnë rrethanat apo provat rrethore dhe
2 për të dalë në përfundimin që këto janë ato që kanë çuar në
3 këtë konkluzion dhe në qoftë se ka më shumë se kaq si provë,
4 ata nuk e kanë arritur standardin që të provojnë përtej
5 dyshimit të arsyeshëm.

6 Mua nuk më kërkohet të them dhe nuk them që fjalët e z.
7 Gucati dhe synimi i tij për të ekspozuar bashkëpunimin midis
8 Serbisë dhe ZPS-së janë -- të çojnë në konkluzionin që kjo nuk
9 është mundësi. Nuk më kërkohet mua për një gjë të tillë. Është
10 Prokuroria që kërkohet që ta përjashtojë këtë fakt për të
11 provuar që ekzistojnë prova për të këtë çështje.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, në qoftë se ju kuptova
13 siç duhet, ju po vareni në dëshminë që është para nesh dhe jo
14 në parimet e përgjithshme të së drejtës? Rregullin 134.

15 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jo, unë nuk po
16 mbështetem në një gjë tjetër. Është thjesht prova, por kjo
17 është një çështje që tregon që nuk ka prova të drejtpërdrejta
18 që Prokuroria të provojë atë që dëshironin të bënin këtë. Ata
19 u përpoqën ta bënin këtë përmes dëshmive rrethore.

20 Ju më kërkua mua të përgjigjem lidhur me synimin e
21 deklaruar të z. Gucati dhe thamë se kjo e përjashton [e
22 pakuptueshme] e tjera dhe përgjigja ime është që nuk kërkohet
23 të bëhet një gjë e tillë. Fjalët e tija nuk kërkohen. Atij nuk
24 i takon të provojë një gjë të tillë. I takon Prokurorisë ta
25 provojë.

1 Në qoftë se synimi i tij ka qenë siç e ka thënë gjatë të
2 gjithë kohës, kjo nuk mjafton për të provuar asnjë prej
3 akuzave me të cilat është ngarkuar. Dhe në qoftë se u takon
4 atyre që ta përjashtojnë këtë mundësi dhe këtë nuk e kanë
5 bërë, nuk e kanë arritur ta bëjnë në një mënyrë të atillë që
6 të përjashtohet çdo dyshim i arsyeshëm i një synimi penal apo
7 kriminal.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
9 të tjera.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
11 Mettraux.

12 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Z. Rees, po e filloj me
13 juve dhe z. Cadman nëse dëshironi të jepni përgjegjësi, do t'u
14 jepet edhe juve mundësia.

15 Dua të kërkoj sqarim lidhur me parashtrimin që keni bërë
16 dje dhe sot. E para është që ju keni bërë dallimin midis
17 personave privatë dhe personave publikë dhe unë dua të jem i
18 sigurt që ju kam kuptuar siç duhet, se çfarë po kërkonit që ne
19 të dallojmë.

20 Në qoftë se ju sugjeroni që statusi i një individi, si
21 person publik apo zyrtar, nuk është i barabartë me [e
22 pakuptueshme] si dëshmitar, këtë po thoni?

23 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ky nuk është
24 dallimi që kam bërë unë, e ka bërë z. Berisha. Ai dha dëshmi,
25 kjo ishte një pjesë e dallimit që ai bëri. Dhe kur ne pamë

1 materialet e tij, për të parë se çfarë ka arritur të publikojë
2 apo jo dhe përgjigja ishte se për zyrtarët publikë, ata nuk
3 ishin konfidencialë. Ishte në interesin publik që të
4 botoheshin identitetet e zyrtarëve serbë që i pamë gjatë ditës
5 së djeshme, dhe këtë ai e ka bërë.

6 Unë jam dakord me ZPS-në se z. Berisha nuk ka bërë vepër
7 penale dhe këtë e paraqitëm në analizën që i bëra pikave 5 dhe
8 6 të aktakuzës. Faktin që Prokuroria nuk i ka përmbushur
9 detyrimet që, për shembull, të tregojë që i kishte pa
10 autorizim apo informacioni që është deklaruar se është sekret,
11 apo që informacioni që i është nxjerrë z. Gucati gjatë një
12 procedure zyrtare [sipas përkthimit]. Unë po them që këto janë
13 pjesë të vendosura apo të përcaktuara për z. Berisha kur është
14 thënë që nuk ka bërë vepër penale dhe z. Halling vetë e ka
15 thënë që pjesa e vlerësimit se përse ai nuk ka bërë vepër
16 penale është mënyra se si e ka gjetur këtë material. Dhe
17 pastaj këtu përfshihet edhe çështja e dallimit midis personave
18 publikë dhe privatë.

19 Ka edhe elementë të tjerë që mungojnë, për sa i përket z.
20 Berisha. Fakti që materiali nuk i ishte nxjerrë atij gjatë
21 procedurave zyrtare që nuk është provuar që të jetë deklaruar
22 sekret nga një gjykatë apo autoritete publik. Këto janë pika
23 të cilat i takojnë, por mund të aplikohen në rastin e z.
24 Gucati, si dhe në rastin e z. Berisha. Dhe mbi këtë bazë, z.
25 Berisha nuk ka bërë vepër penale, sipas pikës 5 dhe 6.

1 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta mund ta kisha
2 rifrazuar ndryshe.

3 Ju nuk po e paraqisni këtë si çështje ligjore ku do të
4 kishte një ndryshim midis një personi privat dhe një personi
5 publik. Pra ju nuk po e bëni këtë si një çështje juridike që
6 nënkupton që një zyrtar shtetëror nuk do të gëzonte mbrojtje
7 si dëshmitar?

8 Z. REES: [Përkthim] Sigurisht që çdo person në çfarëdo
9 lloj cilësie mund të jetë dëshmitar. E thashë edhe gjatë ditës
10 së djeshme edhe sot që përkufizimi i Prokurorisë për një
11 dëshmitar potencial e bën secilin prej nesh në këtë sallë
12 gjyqi, gjykatës, avokat apo oficer të sigurisë, të gjithë mund
13 të jenë dëshmitarë dhe mund të jenë --. Por ky përkufizim nuk
14 është pjesë e elementëve që na ndihmojnë për të vlerësuar nëse
15 janë realizuar pikat 5 dhe 6.

16 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Sqarimi i dytë që doja nga
17 ti është me qëllim që të bëj të mundur që e kam kuptuar siç
18 duhet. A e pranoni që gazetarët janë anëtarë të publikut apo
19 nuk jeni dakord me këtë?

20 Z. REES: [Përkthim] Gazetari është një profesionist i
21 cili ka detyrimet e tij, standardet etike që janë pjesë e
22 punës së tij profesionale, që i bën që të jenë të dallueshëm
23 nga pjesa tjetër e publikut, që nuk bën një gjë të tillë.

24 Mund ta shikojmë këtu por [e pakuptueshme] këtu, i
25 nderuar Gjykatës. Unë jam këtu në cilësinë profesionale si

1 avokat. Por jam edhe anëtar i publikut, por jam duke punuar në
2 cilësinë e avokatit, unë kam detyrimet si një avokat dhe nuk
3 ka sugjerim që nuk i kam këto. Gazetari është një profesionist
4 i cili ka detyrimet e veta profesionale dhe ata e dinë shumë
5 mirë se çfarë mund të botojnë e çfarë nuk duhet të botojnë,
6 çfarë mund të botojnë dhe çfarë është në interesin e publikut,
7 dhe në gjendje që ta vlerësojnë një gjë të tillë.

8 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Pra a mund të thuhet që
9 gazetarët janë anëtarë të publikut për sa i përket të drejtave
10 të publikut në përgjithësi?

11 Z. REES: [Përkthim] Janë anëtarë të publikut të cilët
12 kanë edhe disa detyrime të tjera shtesë profesionale, etike,
13 të cilat janë pjesë e punës së tyre si gazetarë.

14 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Ju keni bërë disa sugjerime
15 për sa i përket z. Tomë Gashi, sidomos për sa i përket detyrës
16 së tij si avokat i OVL UÇK-së dhe dua që ta kuptoj se çfarë po
17 thoni.

18 A po thoni ju që sjellja e klientit tuaj është e ndikuar
19 pasi ka marrë këshillën e z. Gashi përpara datës 17 shtator të
20 vitit 2020?

21 Z. REES: [Përkthim] Po.

22 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Dhe dëshmitë mbi të cilat
23 jeni mbështetur për këtë çështje janë ato që na keni
24 përmendur.

25 Z. ROCHE: [Përkthim] Z. Gucati fillimisht dha dëshmi ku

1 tha që z. Gashi është punësuar pas konferencës së parë të
2 shtypit dhe në fakt ai tha se ka pasur kontakte me z. Gashi
3 përpara dhe pas punësimit të tij si këshilltar ligjor. Në një
4 fazë të mëtejshme dhe unë e kuptoj, ka pasur një mospërputhje,
5 ku na sugjerohet që kjo ndodhi pas konferencës së dytë të
6 shtypit kur ishte duke u marrë në pyetje. Por do t'ju kërkoja,
7 të nderuar Gjykatës, të shqyrtonit procesverbalin e
8 konferencës së dytë të shtypit ku përmendet këshilla e tij.
9 Dhe në këtë mënyrë konfirmohet qëndrimi i tij fillestar në
10 këtë drejtim.

11 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Ju kujtohet që në kohën kur
12 dha znj. Myers dëshminë e saj, ajo ju pyeti [sipas përkthimit]
13 dhe ju në mënyrë elegante iu shmangët. Pyetja ime është nëse
14 ju po bënit -- siç po bën edhe z. Cadman, në faktin që po
15 mbronit një sinjalizues. Pra, a e keni pritur ju që të
16 mbështeteshit në dëshminë që ka dhënë znj. Myers për të bërë
17 argumentin tuaj të gjerësishëm.

18 Dhe po ju bëj pyetjen: a po i kërkonit Trupit Gjykses që
19 të arrijë në konstatime, po të vijë rasti, për sa i përket
20 klientit tuaj, me qëllim që ai të quhet sinjalizues?

21 Z. REES: [Përkthim] Dëshmitë që keni dëgjuar kanë të
22 bëjnë për të dy, për z. Gucati dhe për z. Haradinajn, dhe nuk
23 mund t'ju kërkoj që të përjashtoni dëshminë që keni dëgjuar në
24 shqyrtimet tuaja.

25 Ne e kemi ngritur gjatë gjithë kohës çështjen e interesit

1 publik. Unë nuk e kam ngritur këtë si një mënyrë të mbrojtjes
2 statutore, si të thuash. Pra e kemi thënë gjatë gjithë kohës
3 që luan një rol të detyrimeve të Prokurorisë për të provuar që
4 materialet janë nxjerrë pa autorizim dhe në mënyrë të
5 paligjshme.

6 Për sa i përket Dr. Myers, ajo na ka ndihmuar për sa i
7 përket nenit 10 të Konventës Evropiane si dhe dëshmime të
8 gjerësishme mbi interesin publik. dhe në këtë mënyrë kjo na ka
9 ndihmuar dhe e pranojmë një gjë të tillë, por këtë e shoh
10 brenda kuadrit të detyrimit që ka Prokuroria për të provuar
11 çështjen e saj dhe nuk po sugjeroj që ekziston një mbrojtje e
12 veçante statutore në këtë drejtim.

13 Shpresoj që ta kem shpjeguar më qartë se më parë, i
14 nderuar Gjykatës. Nëse jo, më thoni dhe përiqem sërish.

15 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Unë po konfirmoj që është
16 pak më qartë. E kam përgjigjen dhe ju kam mirënjohës, z. Rees.

17 Pyetja e fundit, edhe për ju z. Cadman, nëse dëshironi të
18 flisni.

19 Kur keni parashtruar gjatë ditës së sotme që neni 62 nuk
20 ishte i zbatuar apo nuk përbën bazë ligjore të pranueshme për
21 të thënë që materiali ishte i mbuluar nga konfidenciali [sipas
22 përkthimit].

23 Në qoftë se është e vërtetë, dua të di se cili është
24 mendimi juaj lidhur me bazën ligjore mbi të cilën ZPS-ja,
25 Prokuroria, pra, do të ishte bazuar që këtë material ta quante

1 konfidencial, apo nuk e kanë pasur fare këtë kompetencë për ta
2 bërë një gjë të tillë?

3 Z. REES: [Përkthim] Po të përqendrohem në pikat e
4 aktakuzës një nga një, e shikoni:

5 Pika 5 flet për informacionin sekret. Neni 392(1) i Kodit
6 Penal të Kosovës i vitit 2019 thotë që nxjerrja e materialeve
7 që janë nxjerrë gjatë procedurave, që i janë dhënë një personi
8 gjatë një procedure zyrtare dhe që është deklaruar që është
9 sekret nga një Gjykatë, apo autoritet kompetent, atëherë kjo
10 duhet dënuar. Nga pikëpamja juridike, në qoftë se ZPS-ja është
11 autoritet kompetent për ta deklaruar informacion sekret,
12 atëherë mund ta bëjë një gjë të tillë.

13 Por nuk e ka bërë një gjë të tillë ose të paktën
14 Prokuroria nuk ka provuar në këtë çështje që të kenë bërë një
15 deklaram të tillë, pra që të deklarojnë sekret një provë
16 materiale. Dhe fjala sekret është një term arti, si të thuash,
17 që ka të bëjë me ligjet e përgjithshme të klasifikimit të
18 sigurisë, i cili mbulon të gjitha organet publike në Kosovë.
19 Ai ka një tabelë të qartë të klasifikimit ku sekret dhe
20 rreptësisht sekret janë dy klasifikime të veçanta. Dhe
21 Prokuroria nuk ka paraqitur dëshmi, apo nuk ka thirrur
22 dëshmitarë këtu për të treguar nëse ka pasur ndonjë deklaratë
23 nga një Gjykatë, apo nga ndonjë autoritet kompetent, apo nga
24 ZPS-ja që të ketë pasur, pra, informacion që të jetë deklaruar
25 sekret.

1 Për sa i përket pikës 6, pika 6 e nenit 392(2), flasin me
2 të dhënat e identitetit dhe të dhënat personale të personave
3 të cilët gëzojnë mbrojtje gjatë procedurave penale, apo janë
4 pjesë i një programi të veçantë të mbrojtjes.

5 Kemi dëgjuar dëshmi të dëshmitarëve të mbrojtur të cilët
6 janë deklaruar të tillë pas një vendimi gjyqësor. Por ne do
7 t'ju kërkonim që të thoni që nuk e kemi dëgjuar që të ketë
8 pasur dëshmitarë të cilët të kenë kërkuar që të mbrohen apo të
9 ketë pasur një vendim gjykate.

10 Ka pasur kërkesa, ndonëse nuk janë miratuar në atë fazë,
11 ose të paktën në një rast edhe mund të ketë ndodhur që të jetë
12 lëshuar një urdhër mbrojtjeje, i cili të mos ishte bërë publik
13 dhe kjo është pjesë e nenit 392(2), ku sipas nesh, duhet të
14 ekzistojë një urdhër mbrojtjeje dhe kemi përmendur këtu
15 çështjen në M.Z., PAKR 336/16.

16 Edhe në këtë rast të veçantë, edhe po të kishte ekzistuar
17 një urdhër gjykate për t'i dhënë mbrojtje këtij dëshmitari,
18 dhe ky urdhër nuk ishte bërë publik, që z. Gucati nuk të ketë
19 pasur dijeni [sipas përkthimit], atëherë sipas mendimit tim,
20 nuk është plotësuar kërkesa për të provuar vepër penale.

21 Të nderuar Gjykatës, fushëveprimi i ZPS-së i takon atyre
22 se sa kompetenca kanë, si dhe provimi i kësaj çështjeje dhe ne
23 themi që përpjekja e tyre për t'u mbështetur thjesht në
24 pohimin se të gjitha dokumentet që ata posedojnë duhet të jenë
25 konfidenciale dhe të gjitha informacionet e tyre janë

1 konfidenciale, është shumë poshtë përmbushjes -- sepse
2 plotësimi të standardit [sipas përkthimit] të kërkesave të
3 pikës 5 dhe 6 për t'i provuar ato tej një dyshimi të
4 arsyeshëm, dhe kjo është arsyeja përse kemi këtë gjyq penal
5 këtu.

6 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Dy pyetje të tjera janë për
7 ju z. Cadman, siç thashë edhe për z. Cadman edhe ju z. Rees,
8 në qoftë se doni edhe ju të shpreheni, ju lutem ndihuni të
9 lirë ta merrni fjalën.

10 Z. Cadman, çështja e parë që do të dëshiroja të kisha më
11 shumë sqarime, ka të bëjë me paragrafin 94 të dosjes suaj
12 përfundimtare dhe ju thoni që:

13 "Ky pozicion në fakt shkon edhe më tej sepse ne mendojmë
14 që ZPS-ja është përfshirë dhe ka kërkuar ndihmë nga individë
15 të cilët janë deklaruar si persona në kërkim për kryerjen e
16 krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në Kosovë dhe
17 edhe ju në fakt e dinit për këtë gjë, domethënë ZPS-ja e dinte
18 për këtë gjë dhe nuk e ka informuar Interpol-in për
19 vendndodhjen e këtyre personave".

20 Në fakt këto parashtime i keni përmendur edhe sot, në
21 faqen 54 të transkriptimit.

22 Ka disa gjëra që duhet t'ju pyes, z. Cadman. Gjëja e parë
23 është kjo: mënyra se si i kuptoj unë këto parashtime është që
24 rëndësia e tyre është për të vërtetuar veprimet e parregullta
25 nga ZPS-ja. A është kështu, apo jo?

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, kështu është.

2 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në qoftë se është
3 kështu, çfarë thoni ka lidhur me dëshmitë e dëshmitarit tuaj,
4 ekspertit të Mbrojtjes, z. Reid, i cili, me sa kujtoj,
5 sugjeronte që së pari, pra një organ hetimor mund të mblidhte
6 informacion nga persona ose janë të dyshuar për kryerjen e një
7 krimi. Ky është 1-shi dhe së dyti që ai konfirmoi që disa prej
8 individëve me të cilët ai kishte punuar ose me të cilët ishte
9 marrë zyre e tij në fakt ishin të njëjtët individë që ju thoni
10 që ZPS-ja duhej të kishte qëndruar larg prej tyre. Dhe
11 sigurisht sipas jush këto janë veprime të parregullta.

12 Kështu që çfarë do të thoshit ju në përgjigje të dëshmisë
13 së dëshmitarit në lidhje me këto dy pika?

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Besoj që ka dy pjesë për sa i takon
15 këtij pohimi. Pjesa e parë është, duke qenë që kam harxhuar
16 goxha kohë në tribunalet ndërkombëtare dhe kombëtare, së pari
17 nuk është e pazakontë që të përdoren dëshmitarë të brendshëm
18 për formulimin e çështjeve penale. Nuk është e pazakontë që të
19 bëhen marrëveshje ose të ofrohen imunitete për të mbledhur
20 informacionin me interes, gjë të cilën e ceku edhe z. Rees
21 dje.

22 Megjithatë, siç u shpjegua edhe dje, ka një dallim sepse,
23 domethënë, në rastin kur kemi me një person [sipas përkthimit]
24 të brendshëm që jep informacion lidhur me një çështje për të
25 cilën ata janë të akuzuar dhe individëve që japin informacion

1 siç është rasti në çështjen aktuale, ose dhëniet e
2 informacioneve për individë në çështje të tjera për të cilat
3 ata nuk kanë lidhje.

4 Individët, të cilët janë cituar që nuk kanë dhënë
5 informacione ZPS-së për të zbuluar krime në të cilat ata kanë
6 qenë të përfshirë, apo ku mund të kenë marrë pjesë, dhe
7 parashtrimi im në këtë pikë është që ka një dallim, pra ka
8 dallim ndërmjet këtyre dy grupeve të rrethanave.

9 Kjo është gjëja e parë dhe çështja tjetër, në fakt është
10 bërë një pyetje lidhur me këtë, i është drejtuar znj. Pumper
11 sa i takon kontrolleve që janë bërë për të identifikuar në
12 qoftë se ka pasur individë të cilët kanë qenë pjesë e listave
13 të personave në kërkim ose kanë qenë të kërkuar nga
14 juridiksione të tjera.

15 Pra çështja e ngritur është që ky është dështim nga ana e
16 ZPS-së, pra që të bëjnë kërkime të tilla. Mendoj që situata
17 është paksa e ndryshme, krahasimisht me përdorimin e
18 dëshmitarëve të brendshëm dhe sigurisht ajo çfarë na tha z.
19 Rees nga përvoja e vet, lidhej me dëshmitarë të brendshëm që
20 jepnin informacion lidhur me çështjet që ishin nën hetim.

21 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] çfarë mund të na thoni
22 lidhur me faktin që ai trajtoi të njëjtët zyrtarë. A do të
23 ishte me shqetësim kjo për ju, domethënë, a do ta theksonit
24 edhe një herë se pse ju thoni që veprimet e parregullta janë
25 të lidhura me bashkëpunimin e ZPS-së me disa nga individët, të

1 paktën. Do të vazhdoni me këtë temë apo jo?

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Argumenti i ngritur dhe në fakt një
3 individ që ne jemi lejuar t'i referohemi në Gjykatë, ish-
4 Prokurori i krimeve të luftës në Beograd, ky është elementi i
5 parë dhe së dyti është çështja e bashkëpunimit ndërmjet ZPS-së
6 dhe këtij individi.

7 Ndërkohë individët e tjerë që kanë bashkëpunuar me ZPS-në
8 janë ata individë, me të cilët z. Haradinaj ka probleme. Në
9 kuptimin që është i shqetësuar për ta, në kuptimin që ata kanë
10 qenë të përfshirë në çështjet në Kosovë dhe sigurisht,
11 domethënë, këto masakra janë lexuar dhe i janë vënë në
12 dispozicion z. Haradinaj. Dhe mbështetja te këta dëshmitarë
13 është problematike nga pikëpamja e tij dhe çonte në veprime të
14 parregullta për Prokurorinë.

15 Në parashtrimet e mia, dhe i qëndroj këtij pozicioni
16 ende, që kemi të bëjmë me veprime të parregullta [sipas
17 përkthimit]. Por megjithatë, argumenti është se cila është
18 gjendja e mendjes ose cila është, le të themi, kuadri mendor i
19 z. Haradinajt kur ai ka bërë ato hapa që ka bërë. Domethënë,
20 çfarë pozicioni kishte ai sa i takon këtyre individëve të
21 cilët janë shprehur goxha lidhur me situatën në Kosovë. Dhe të
22 paktën ka një -- flitet për përfshirjen e tyre në të njëjtat
23 materiale -- në të njëjtat masakra në Kosovë. Domethënë kjo
24 është çështja që është ngritur.

25 Nuk kemi thënë që është e parregullt në të gjitha

1 rrethanat që të bashkëpunohet me autoritetet e një shteti
2 tjetër.

3 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi dakord. Siç
4 e bëmë të qartë edhe dje, z. Reid po fliste për një sistem i
5 cili hetonte në mënyrë të paanshme dhe të drejtë dhe ai na
6 shpjegoi situatën kur kishte persona të cilët përdoreshin nga
7 një grup hetuesish ose viktimat dhe në të njëjtën kohë,
8 hetoheshin apo ndiqeshin penalisht për krime, ndërkohë që
9 situata në të cilën jemi ne është ndryshme.

10 Sepse ZPS-ja nuk është në këtë pozitë, pra nuk mund të
11 bëjë këtë -- nuk mund të përqafojë këtë qasje të drejtë dhe të
12 balancuar dhe ky është dallimi kryesor ndërmjet pozicionit të
13 z. Reid për këtë opinion dhe Zyrës së Prokurorisë së
14 Specializuar. Domethënë, është kjo mungesë drejtësie, ky është
15 dallimi kryesor që qëndron në zemër të ankesës së shprehur nga
16 z. Gucati dhe nga z. Haradinaj dhe nga shumë persona të tjerë
17 në Kosovë, përfshirë këtu edhe shtypin.

18 Unë jam gjithashtu dakord me z. Cadman se prova që është
19 përmendur në paragrafin 94 dhe provat e tjera të cilat i kemi
20 dëgjuar gjatë gjykimit që kanë natyrë të ngjashme, ku shtypi
21 ka botuar akuzua të rënda, serioze për përfshirje në krime
22 lufte të natyrës më të ashpër të mundshme kundër individëve të
23 identifikuar nga shtypi.

24 Dhe kjo në fakt ka ndikim mbi gjendjen mendore të të
25 pandehurve, të z. Gucati, për shembull. Dhe në fakt në këtë

1 nen për të cilin po flisnim, ku individët ishin të kërkuar,
2 ose të shpallur të kërkuar nga Interpoli, sipas artikullit të
3 paktën, këta persona thuhej që bashkëpunonin me ZPS-në dhe
4 këta individë në fakt janë individët të cilët ne i kemi edhe
5 në marrjen tonë në pyetje të dëshmitarit, ku z. Gucati po
6 fliste për armiq të Kosovës. Dhe këtë e kemi të reflektuar
7 edhe në transkriptim. Edhe në qoftë se, për shembull, po t'i
8 referohemi transkriptimeve që unë përmenda gjatë paradites,
9 ose disa faqe më pas, pra nuk dua të përmend emrin e
10 individit, por bëhet fjalë për një individ i cili akoma edhe
11 sot e kësaj dite është person i deklaruar në kërkim nga
12 Interpoli.

13 Dhe bëhet fjalë për këta lloj individësh, për të cilët
14 ishte në dijeni z. Gucati. Dhe kjo lidhet me atë çfarë po
15 pyesnit juve, lidhur me provat, me dëshminë e z. [sipas
16 përkthimit] Myers. Pjesë e detyrës së tyre ishte për të
17 përshkruar që për sinjalizuesit nuk mund t'u kërkosh
18 sinjalizuesve që të kenë një kuptim të plotë, të plotfuqishëm
19 të pozicionit të tyre, por mjafton që të ekzistojë besimi i
20 arsyeshëm.

21 Dhe z. Gucati është mbështetur në këto artikuj të shtypit
22 që thonë që ZPS-ja ka bashkëpunuar me persona që janë
23 deklaruar si persona në kërkim nga ZPS-ja [sipas përkthimit].
24 Dhe në rrethanat përkatëse i takon që këta të ishin persona
25 armiq të Kosovës, por nuk do të thotë që të gjithë personat

1 dhe bashkëpunimi me të gjithë mund të kualifikohet si i tillë.

2 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Do ju kërkoj që të
3 vazhdonit të qëndronit në këmbë, z. Rees, se do t'ju bëj një
4 pyetje tjetër.

5 A e kam kuptuar drejtë nga parashtrimi që sapo bëtë që ju
6 nuk po mbështetni në këto artikuj të shtypit për sa i takon
7 vërtetësisë së përmbajtjes së tyre, domethënë, ju nuk
8 pretendoni se ekziston një listë e personave në kërkim me ato
9 emrat që janë aty, por juve mbështeteni në këtë artikull që
10 ishte në domainin publik. Dhe në qoftë se përgjigja ndaj kësaj
11 pyetjeje është "jo" dhe në qoftë se juve kërkoni të
12 mbështeteni te vërtetësia e përmbajtjes së këtyre artikujve,
13 apo thoni që ju mbështeteni në këto artikuj lidhur me
14 vërtetësinë e përmbajtjes së tyre. Dhe në qoftë se "po", cilat
15 janë provat që ekzistojnë në këto artikuj lidhur me
16 ekzistencën apo mundësinë reale të listave në kërkim të
17 Interpolit? Pra ku mbështeteni?

18 Dhe, apo thjesht mbështeteni te këto artikuj duke thënë
19 që klienti juaj beson që këto lista të Interpolit ekzistojnë?

20 Z. REES: [Përkthim] Mbështetem tek e fundit. Mbështetem
21 në faktin që ka arsye absolutisht të mira për z. Gucatin dhe
22 persona të tjerë për të besuar që këta janë persona të cilët
23 janë botuar nga profesionistë. Pra të besoj vërtetësinë e
24 këtyre artikujve. Jam i sigurt që nuk është vetëm z. Gucati që
25 e beson këtë gjë.

1 Lidhur me pjesën e parë të përgjigjes suaj, lidhur me
2 vërtetësinë e përmbajtjes së artikujve, përgjigja në fakt ka
3 të bëjë me barrën e provës, sepse ZPS-ja duhet të provojë
4 çështjen e tyre përtej dyshimit të arsyeshëm. Parashtrimi im
5 për ju, të nderuar Gjykatës, është që pika 5 dhe 6 dhe
6 detyrimi i Prokurorisë lidhur me këto pika është tërësisht që
7 Prokuroria të provojë që çdo klasifikim i informacionit si
8 informacion sekret që në themi që kërkohet mbi bazën e pikës
9 5, apo pikë 6 lidhur me dëshmitarët e mbrojtur dhe të cilët
10 janë pjesë e programeve të mbrojtjes dhe mungesën e
11 autorizimit.

12 Pra, me fjalë të tjera, i takon Prokurorisë që të provojë
13 që çështjet që ata thonë që janë nxjerrë, janë shqyrtuar në
14 mënyrë të ligjshme dhe janë kategorizuar në mënyrë të drejtë
15 dhe të ligjshme ose si sekret, ose bëhet fjalë për dëshmitarë
16 të mbrojtur, apo nën programe speciale të mbrojtjes. Kështu që
17 nuk e pranoj që shpjegimet janë të mjaftueshme nga ZPS-ja.

18 Dhe nuk e pranoj që këto dokumente nuk duhej të
19 nxirreshin për shkak të sensibilitetit të tyre. Pra për këtë
20 arsye ZPS-ja, si pjesë e kësaj çështjeje, i kanë ofruar këto
21 nene, këto janë prova materiale që janë parashtrua nga ZPS-ja,
22 nuk është se i kemi paraqitur ne. Janë prova të cilat janë
23 ofruar nga Prokuroria.

24 Dhe ndërkohë që kanë ofruar këto prova, ZPS-ja ka ngritur
25 pyetje apo shqetësime të caktuara, shqetësime të cilat z.

1 Guçati i ndau me juve gjatë kohës së aktakuzës. Nuk ka dyshim
2 që ka shumë persona të tjerë të cilët kanë të njëjtin qëndrim
3 në Kosovë dhe mendoj që këto janë shqetësime të cilat
4 gjithashtu kanë dalë gjatë këtij gjykimi, që Prokuroria nuk ka
5 trajtuar -- mund t'i kishte trajtuar - e theksoj, mund t'i
6 kishte trajtuar, apo mund të kishte paraqitur prova që kanë të
7 bëjnë më këtë pikë. Ata mund të kishin paraqitur e parashtruar
8 prova që të thoshin që këto nuk janë të vërteta që këta
9 persona të cilët janë pjesë e listës, nuk janë persona të
10 kërkuar nga Interpoli. Ose mund të na kishin parashtruar prova
11 që thonë që këta janë persona që kërkohen nga Interpoli. Nuk
12 është se po i mbrojmë këta persona nga Interpoli. Ne ua kemi
13 kaluar informacionet Interpolit që këta persona janë këtu dhe
14 aty. Kemi marrë informacion nga këta persona. Por duhet të
15 bënin punën e duhur sepse të njëjtën gjë do të kishte bërë z.
16 Rees, për shembull kur ka shërbyer në TPNJ, pra për t'u
17 siguruar që këta persona do të hetoheshin siç duhet. Dhe në
18 qoftë se, në fakt, provat dëshmonin që ata ishin të përfshirë,
19 për shembull, në vrasjen e 362 grave dhe fëmijëve, të
20 siguroheshin që ata do të ndiqeshin penalisht dhe do të vuanin
21 pasojat, edhe pse ata do të mbështeteshin te këta, ose për
22 dhënien e informacionit inteligjent, ose për prova.

23 Kështu që sërish i kthehem argumentit të barrës së
24 provës. Unë mbështetem në këto artikuj, sepse ata ngrenë
25 çështje provuese lidhur me sjelljen e ligjshme ose jo të ZPS-

1 së dhe këto nuk janë çështje të cilat janë trajtuar nga ZPS-ja
2 në parashtrimet e tyre.

3 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

4 Pyetja e fundit është për ju, z. Cadman.

5 Është pyetja që ka të bëjë me paragrafin 20 të dosjes
6 tuaj. Ju thoni si më poshtë:

7 "Prokuroria ka premtuar një mjedis të sigurt dhe ka
8 premtuar gjithashtu ofrimin e integritetit fizik të
9 dëshmitarëve të saj. Ja ka premtuar këtë gjë donatorëve dhe
10 njerëzve në Kosovë. Dhe ajo ka dështuar në bërjen e kësaj
11 gjëje".

12 Ky është parashtrimi në paragrafin përkatës, paragrafin
13 20 të dosjes tuaj. Dua t'ju pyes, a duhet ta lexojmë këtë
14 paragraf në mënyrë të tillë që rrjedhja e informacionit ka
15 krijuar një mjedis të pasigurt. Ky është përfundimi? K është
16 konkluzioni që duhet të nxjerrim ne nga kjo pjesë e
17 parashtrimit tuaj?

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Në qoftë se mbani mend gjatë
19 dëshmisë së z. Haradinaj dhe në deklaratën e tij, ai nuk ishte
20 në dijeni, nuk kishte informacion se deri në çfarë përmase
21 kishte arritur rrjedhja e informacionit, nuk e dinte se sa
22 persona të tjerë kishin qasje në këtë informacion dhe kjo
23 ishte një prej hapave -- një ndër arsyet e hapave që ai mori
24 dhe hapat ishin që të ekspozonte dy çështje të krijuara nga
25 ZPS-ja.

1 Nuk po sugjerojmë që përmes veprimeve të z. Haradinaj
2 është krijuar situata që ju deklaruat duke lexuar atë
3 paragraf, sepse e ka thënë vetë me fjalët e veta z. Haradinaj,
4 që këto ishin shqetësime që ai i ka thënë vetë. Domethënë, që
5 ZPS-ja është përgjegjëse për rrjedhjen e informacionit masiv.
6 Dhe këtë gjë ai e ka bërë publike. E ka bërë publike përmes
7 veprimeve të tij.

8 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është pak më e
9 gjerë se sa kaq. Pra këto janë parashtrime për veprimet e ZPS-
10 së, ju sapo na thatë. Por megjithatë paragrafi që unë lexova
11 kishte të bënte me krijimin e një klime të sigurt për
12 dëshmitarët.

13 Pyetja që ju bëra unë është në qoftë se ju e pranoni që
14 mjedisi ku kanë ndodhur këto ngjarje ka qenë i pasigurt apo
15 është një keqlexim prej meje i parashtrimit tuaj?

16 Z. CADMAN: [Përkthim] mbase mund të jetë një zgjedhje jo
17 e duhur e fjalëve. Sigurisht që ne nuk kemi sugjeruar që një
18 akt i z. Haradinaj ka krijuar një mjedis të pasigurt.
19 Absolutisht jo.

20 Domethënë, ai e ka thënë vetë, siç e thashë edhe më
21 përpara, duke theksuar se çfarë kishte ndodhur dhe ai e ka
22 shprehur që nuk qenë në asnjë mënyrë i përfshirë me rrjedhjen
23 e këtyre të dhënave. Ai ka qenë shumë i qartë në dëshminë e
24 vet lidhur me paralajmërimet ose njoftimeve që ju ka dhënë
25 personave, ose hollësive të ndryshme të cilat janë vënë në

1 dispozicion mediave të tjera për të mos ekspozuar dëshmitarët.

2 GJYQTARI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam
3 pyetje të tjera.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
5 Gjykatësi Gaynor.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam disa pyetje por mund t'i
7 përgjigjen të dy mbrojtësit.

8 Atëherë, së pari kam pyetjen për interesin publik dhe
9 barrën e provës.

10 Në paragrafin 104 të parashtrimit të z. Gucati dhe sot
11 gjatë deklaratave këtu, juve thatë që i takon ZPS-së që të
12 ketë dhe të dëshmojë përtej dyshimit të arsyeshëm që materiali
13 i nxjerrë nuk ka të bëjë me veprime të parregullta, lidhur me
14 bashkëpunimin ndërmjet ZPS-së dhe TFHS-së dhe Serbisë.

15 Jam i interesuar të di se pse barra e provës i takon ZPS-
16 së. Konkretisht ne e dimë që ZPS-ja ka detyrë në vijim e sipër
17 që të nxjerrë informacion apo prova shfajësuese, sipas
18 rregullit 103, por kjo mungesë e veprimeve të parregullta
19 sigurisht që nuk është element i veprës penale.

20 Kështu që ju lutem, a mund të na shpjegoni se pse nuk
21 është barrë e Mbrojtjes që të dëshmojë përtej dyshimit të
22 arsyeshëm për të vlerësuar këtë gjë dhe kjo barrë i takon
23 Prokurorisë.

24 Z. REES: [Përkthim] Përgjigja ime lidhet me pikën 5 dhe
25 pikën 6.

1 Pika 5, i kërkon Prokurorisë të provojë që nxjerrja e
2 informacioni është bërë pa autorizim dhe, edhe pse unë nuk e
3 pranoj që kjo në fakt zbatohet në këtë rast, një bazë tjetër
4 ligjore është neni 392(1), që baza alternative e informacionit
5 do të duhet të nxirret sipas ligjit. Ose që këto informacione
6 të jenë deklaruar sekrete, përmes një vendimi të Gjykatës ose
7 një autoriteti tjetër kompetent.

8 Atëherë unë do të përqendrohem te pika 5, po e njëjta
9 logjikë, i njëjti shpjegim është i vlefshëm edhe për pikën 6.
10 Nuk ka pikë dyshimi që Prokuroria duhet të provojë
11 informacionet, pra duhet të provojë që bëhet fjalë për
12 informacione të cilat janë sekrete ose të cilët janë deklaruar
13 si të tilla nga një Gjykatë ose një organ i ngjashëm ligjor.

14 Dhe si pjesë e kësaj rezulton që formulimi që nuk duhet
15 të nxirret, në qoftë se nuk parashikohet në ligj, është e
16 vetëshprehur. Pra nuk duhet të nxirret në mënyrë të ligjshme,
17 në mënyrë të ndryshme që është parashikuar në ligj, çfarë do
18 të thotë që në qofte se kufizimi është i paligjshëm, atëherë
19 nuk është në përputhje me ligjin.

20 Dhe nuk mund të ketë asnjë lloj dyshimi, për shembull, që
21 informacioni që thjesht e vë në siklet ose e turpëron një
22 autoritet kompetent ose për shembull, një informacion i cili
23 zbulon një sjellje të paligjshme ose nxjerr në pah që ky organ
24 kompetent ka abuzuar me pushtetin e vet, me kompetencat e
25 veta, nuk mund të kufizohet në mënyrë të ligjshme. Dhe unë

1 them që kjo do të ishte absurde në qoftë se nuk do të lejohej.

2 Kështu që do të guxoja, do t'i bëja thirrje, do t'i
3 thosha ZPS-së që të marrë, për shembull, pozicionin e kundërt.
4 Për shembull, do të sugjeroja që të fshihte material që të
5 demonstroi që autoriteti i tyre, për shembull ishte i
6 paligjshëm apo abuzues.

7 Nuk mund të jetë kështu sepse ligji nuk funksionon
8 kështu. Dhe në fakt duhet ta themi këtë, se është e vërtetë që
9 në dosjen përfundimtare, ZPS-ja thotë që sinjalizuesi ka një
10 rol të rëndësishëm për të luajtur në shoqëri. Pra ata e dinin
11 që bëhej fjalë për elementë të interesit publik, që do të
12 dilte në pah kur shqyrtonin, për shembull, në qoftë se
13 nxjerrja e ndonjë informacioni ishte i paautorizuar. Ose ishte
14 kundër ligjit, binte ndesh me ligjin.

15 Pra, parashtimi im është që materiali që kërkohet të
16 nxirret për shkak të interesit publik, sepse interesi i
17 publikut të përgjithshëm ose mirëqenia e interesit publik për
18 nxjerrjen e informacionit është më e madhe se sa interesi i mos
19 xjerrjes së informacionit për një individ ose disa individë.
20 Ligji duhet të thotë shprehimisht, apo jo, që ky informacion
21 nuk mund të nxirret. Unë nuk mund të përdor ligjin në vetvete
22 për të parandaluar nxjerrjen e materialit që është në dobi të
23 publikut të përgjithshëm, sepse kjo është më e madhe se sa
24 interesi i individit për të mos nxjerrë të njëjtin
25 informacion. Kështu që ligji në vetvete nuk mund të ndalojë

1 mosnxjerrjen e këtij informacioni.

2 Kur kalojmë pastaj te barra e provës, siç përcaktohet nën
3 pikën 5, në mënyrë që Prokuroria të provojë që nxjerrja e
4 informacionit ishte e paautorizuar ose që përbëhej nga
5 material që ishte i deklaruar në mënyrë të ligjshme si sekret
6 ose i deklaruar në mënyrë të ligjshme nga një Gjykatë ose
7 organ tjetër kompetent si dokument i cili nuk duhej të
8 nxirrej. Kështu që në rrethana të tilla duhej që ZPS-ja të
9 kishte vërtetuar që ky material ose materiali në fjalë, ishte
10 deklaruar siç duhet ose në mënyrë të ligjshme, që nuk duhej të
11 nxirret ose që ishte material sekret. Dhe për këtë arsye unë
12 them që barra e provës i takon Prokurorisë. Prokuroria duhet
13 të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm që në fakt interesi
14 publik nuk është më i lartë se sa interesi i individit për
15 mosnxjerrjen e informacionit.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

17 Pyetja e dytë ka të bëjë me synimin e eventual dhe
18 synimin specifik, konkret.

19 A është qëndrimi juaj që synimi eventual nuk mund të
20 zbatohet në një krim me synim konkret, specifik.

21 Z. REES: [Përkthim] Po.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni ndonjë vendim, për
23 shembull, të ndonjë gjykate të Kosovës ose të ndonjë gjykate
24 tjetër, që e mbështet këtë qëndrim tuajin?

25 Z. REES: [Përkthim] Jo, është parashtrimi im, që një

1 synim konkret, ndoshta ta formuloj pak ndryshe.

2 Në qoftë se mjafton synimi eventual, varet nga pasojat
3 dhe natyra e aktit. Kur flasim për pikën 3 dhe 4, veprat
4 penale të cilat kërkojnë synimin konkret për të përdorur
5 forcën ose kanosjen serioze për të nxitur një person tjetër,
6 pra "cilat do të jenë pasojat?". Pasojat që të bëjnë të
7 mjaftueshëm synimin eventual?

8 Pra, pasojat duhet të jenë të një natyre ndaluese dhe
9 mund të bërje të një deklarate të caktuar [sipas përkthimit]
10 ose bërjes së një deklarate të rremë, etj. Pra është e
11 rëndësishme që të theksohet elementi i nxitjes së një personi
12 për të mos bërë një deklaratë, për të bërë një deklaratë të
13 rreme ose për të mos dhënë në një mënyrë tjetër informacionin
14 e vërtetë për policinë.

15 Kështu që lidhur me pikën 5, unë mendoj që kemi të bëjmë
16 me një synim konkret dhe synimi eventual nuk mjafton, sepse
17 nuk është e mbështetur kjo në bazën ligjore të përmendur.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në nenin 21. Neni 21,
19 paragrafi 1 duket sikur është i qartë. Thotë që veprat penale
20 mund të kryhen me synimin e drejtpërdrejtë ose eventual.
21 Krimet me synim specifik nuk trajtohen në mënyrë të shprehur
22 në kodin penal të Kosovës.

23 Dhe, në qoftë se Trupi Gjykses vendos, për shembull, që
24 është e detyrueshme të zbatohet neni 21 për të gjitha krimet,
25 a shikoni ndonjë pengesë ligjore lidhur me zbatimin e tij?

1 Domethënë, përveç argumenteve të logjikës të cilat sapo na i
2 thatë, a mendoni se ka ndonjë pengesë ligjore për zbatimin e
3 synimit eventual për të gjitha krimet e akuzuara?

4 Z. REES: [Përkthim] Neni 21(2) përcakton se çfarë është
5 veprimi me dashje direkt apo me synim të drejtpërdrejtë. Pra
6 kur ke një synim konkret, domethënë një vepër penale që është
7 bërë me synim konkret, qëllimi është që të shtyhet një person
8 tjetër, të nxitet që të mos bëjë deklaratë apo që të bëhet
9 hakmarrje në lidhje me dhënien e një informacioni të vërtetë.
10 Neni 21(3) ka përkufizimin e synimit eventual apo dashjes
11 eventuale. Kjo të çon te qëllimi specifik që mban vepra
12 penale.

13 Sepse po i bëni këtë pyetje vetes se, në lidhje me
14 synimin eventual. Ky person a e di që po vepron për një synim
15 specifik? Në qoftë se po, atëherë përfshin 21(2).

16 Ndërsa jo, atëherë zbatohet 21(3) por kjo nuk ju zgjidh
17 ndonjë problem sepse kërkohet synim specifik nga faktet.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të më sqaroni nëse
19 veprat penale nën nenin 387 dhe 388, a janë të dy synime
20 specifike?

21 Z. REES: [Përkthim] Po. Megjithëse hakmarrja ka fjalët
22 specifike "me synimin që", "me qëllim që", kurse neni 387 e
23 jep synimin specifik, sepse kërkon përdorimin e forcës ose të
24 kërcënimit serioz për të shtyrë një person tjetër. Kuptimi
25 është i njëjtë.

1 Në qoftë se përdor forcë apo kërcënim "me synim që", apo
2 "për të" shtyrë dikë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të bëj një pyetje në
4 lidhje me informacionin e vërtetë dhe nenin 388.

5 Ju në faqen 14 sot thatë që neni 388(1) nuk zbatohet për
6 të pandehurit që veprojnë me besimin që një person ka dhënë
7 informacion të pavërtetë, dhe z. Guçati për shembull, thatë
8 ju, ka thënë që:

9 "Unë nuk e kam problem kur një person i thotë të vërtetën
10 ZPS-së. Në qoftë se ai person është keqtrajtuar nga UÇK-ja,
11 atëherë unë s'kam problem që t'i jap dëshmi ZPS-së. Por në
12 qoftë se dikush flet me ZPS-në dhe i jep një histori të
13 rreshme në mënyrë që të zhvendoset me vendbanim nga ZPS-ja,
14 dhe besoj që mund të ketë ndodhur kjo, ata i konsideroj si
15 gënjeshtarë".

16 Pra unë dua t'ju pyes, është paksa abstrakte, domethënë
17 ku aplikohet neni 388. Ndoshta unë mund ta paraqes një situatë
18 hipotetike dhe pastaj mund të më jepni përgjigje. Një person
19 parqet informacion konfidencial në lidhje me kryerjen apo me
20 kryerjen e mundshme të krimeve në -- ja bën të ditura publikut
21 [sipas përkthimit]. Ai pranon se mund të ketë një pjesë të
22 atij informacioni që është i vërtetë. Ai nuk bën përpjekje që
23 të bëjë dallimin midis informacionit të vërtetë nga ai i
24 pavërtetë. Ai bën deklaratë armiqësore ndaj dëshmitarëve që
25 kanë bashkëpunuar me Prokurorinë apo me policinë.

1 Duke e bërë këtë, ai e di dhe e pranon se kjo mund të
2 çojë në veprime të dëmshme ndaj disa prej dëshmitarëve. Për
3 shembull, disa prej tyre mund të humbin vendin e punës. Në
4 këto rrethana është përcaktuar, a vërtetohet vepra penale e
5 hakmarrjes. Në qoftë se jo, pse jo?

6 Z. REES: [Përkthim] Jo, sepse synimi specifik sipas nenit
7 381 [sipas përkthimit] është qëllimi për të marrë hak për
8 dhënien e informacionit të vërtetë, kurse në rastin tuaj do të
9 ishte një synim për të marrë hak për dhënien e informacionin
10 në lidhje me kryerjen e mendshme apo kryerjen e vërtetë të një
11 krimi.

12 Unë tani nuk mund të bëj ndonjë vëzhgim në lidhje me
13 shkaktimin e dëmit apo jo në atë skenarin hipotetik që bëtë ju
14 dhe nuk e di nëse mund të ketë vepra penale të tjera në Kodin
15 Penal të Kosovës të cilat mund ta mbulojnë këtë lloj skenari.

16 Por unë parashtroj që, duke parë nenin 388, pika 1, vepra
17 penale e hakmarrjes nuk vërtetohet sepse kërkohet synimi
18 konkret për marrjen e hakut për dhënien e informacionit të
19 vërtetë.

20 Nëse informacioni është i vërtetë apo jo, nuk plotëson
21 kushtin e synimit konkret sepse fjalët e përdorura aty,
22 formulimi është "me qëllim që të merret hak për dhënien e
23 informacionit që mund të jetë i vërtetë ose nuk është i
24 vërtetë". Pra nuk është ky formulim, është formulimi që është
25 për dhënien e informacionit të vërtetë.

1 Pra, nuk është detyrë e këtij Trupi Gjykues që të gjejë
2 defektet apo boshllëqet e Kodit Penal të Kosovës, siç tha z.
3 Halling dhe ne nuk kemi bërë një analizë tërësore të të gjithë
4 Kodit Penal të Kosovës, por neni 388(1) nuk është neni që e
5 mbulon këtë lloj sjelljeje.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Por ju e pranoni që neni
7 388(1) mbulon atë person që ka dhënë informacion të vërtetë
8 dhe të pavërtetë apo thjesht të jetë njëqind për qind i
9 vërtetë ai informacion i dhënë?

10 Z. REES: [Përkthim] Ju herën e parë thoni, i nderuar
11 Gjykatës, që situata juaj ka të bëjë me informacionin që të
12 jetë objektivisht i vërtetë. Por t'i kthehemi natyrës së
13 synimit konkret. Synimi për të marrë hak për dhënien e
14 informacionit të vërtetë është pikërisht kjo që thuhet, me
15 këto fjalë. Prokuroria duhet të vërtetojë përtej dyshimit të
16 arsyeshëm se kryerësi i veprës penale sipas nenit 388 ka
17 synimin për të marrë hak për dhënien e informacionit të
18 vërtetë. Në qoftë se kjo kërkon nga Prokuroria në një situatë
19 hipotetike që të vërtetojë që i pandehuri besonte se çdo gjë
20 tek informacioni ishte i vërtetë, kjo nuk është bërë. Por ata
21 duhet të vërtetojnë se ekzistonte synimi për të marrë hak për
22 dhënien e informacionit të vërtetë.

23 Pra atë që kanë vënë ata në dosjen e tyre nuk është që
24 kanë sugjeruar se ka synim, por nuk e kanë vënë standardin më
25 lartë se bindja që kishte z. Gucati se ky informacion ishte i

1 vërtetë apo jo. Dhe ata e formuluan në këtë mënyrë sepse z.
2 Gucati është skeptik për keqbërjet që thuhet që ka bërë UÇK-
3 ja. Pra ky është ndikimi i përgjithshëm i provave dhe i
4 dëshmisë.

5 Pra nuk mund të vihet standardi i provimit të kësaj më
6 lart se sa synimi për të marr hak.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman. Ju
8 mund t'i përgjigjeni ndonjë nga pyetjeve, nëse keni dëshirë?

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk ka gjë tjetër për të shtuar
10 përveç asaj që tha z. Rees.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,
13 duket sikur ju jeni gati por ne tani nuk kemi kohë për të
14 dëgjuar përgjigjet tuaja dhe do ta shtymë dhënien e
15 përgjigjeve tuaja ndaj Mbrojtjes nesër. Besoj që keni
16 përgjigje, apo jo?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Po, do të kemi përgjigje,
18 sigurisht dhe shpresojmë që të marrim 30 deri në 45 minuta.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
20 do të rifillojmë përsëri nesër. Faleminderit të gjithëve për
21 bashkëpunimin dhe do të takohemi përsëri nesër në mëngjes.

22 --- Seanca mbyllet në orën 15:39.

23

24

25